



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.2023

VENDIM

Nr. 118, datë 15.03.2023

PËR

**VLERËSIMIN ETIK DHE PROFESIONAL TË GJYQTARES {...} PËR PERIUDHËN
2017 - 2019**

Këshilli i Lartë Gjyqësor, bazuar në nenet 85, 89 dhe 95, të Ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në Vendimet e Këshillit të Lartë Gjyqësor, nr. 263, datë 21.11.2019 “Për miratimin e rregullave plotësuese të vlerësimit të gjyqtarëve” dhe nr. 264, datë 21.11.2019, “Metodologjia e pikëzimit me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit të gjyqtarit”, pasi shqyrtoi “Projektraportin e vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtares {...}, për periudhën 2017- 2019”, i hartuar nga relatores znj. Irena Plaku,

V E N D O S I :

1. Miratimin e “Raporti i vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtares {...}, për periudhën 2017- 2019”, duke e vlerësuar atë si më poshtë:
 - A. Aftësitë profesionale – “Shumë mirë”;
 - B. Aftësitë organizative – “Shkëlqyeshëm”;
 - C. Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale – “Shkëlqyeshëm”;
 - D. Aftësitë personale dhe angazhimi profesional – “Shkëlqyeshëm”.
Niveli i përgjithshëm i vlerësimit – “Shumë mirë”.
2. Raporti i vlerësimit i miratuar sipas pikës 1, i bashkëngjitet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit, brenda 15 ditëve nga e nesërmja e njoftimit të vendimit të arsyetuar.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe ekstrakti i tij publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor në përputhje me nenin 95 pika 9 të Ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR

ANALIZA E TË DHËNAVE TË MARRA NGA BURIMET E VLERËSIMIT DHE PËRCAKTIMI I NIVELIT TË VLERËSIMIT PËR ÇDO KRITER VLERËSIMI

1. AFTËSITË PROFESIONALE TË GJYQTARIT

Për të vlerësuar dhe pikëzuar aftësinë e gjyqtarës {...} në drejtim të aspekteve të njohurive ligjore dhe arsytimit të vendimit, vlerësuesi përqendrohet në metodologjinë e përgjithshme të punës së gjyqtarës bazuar në dosjet e përzgjedhura dhe nuk vlerëson meritat ligjore të vendimeve individuale, të cilat përcaktohen vetëm në kuadër të një procesi ankimi. Aftësia profesionale e gjyqtarës pikëzohet sipas dy aspekteve, njohuritë ligjore dhe arsytimi ligjor, të cilët ndahen në disa nën tregues.

1.A NJOHURITË LIGJORE.

1.A.a Aftësia për të identifikuar natyrën e çështjes, ligjin e zbatueshëm dhe/ose konfliktin e normave.

Roli i gjykatës në identifikimin e natyrës së çështjes dhe ligjin e zbatueshëm paraqet rëndësi thelbësore për një sërë çështjesh eventuale, që do të duhet të zgjidhë gjykata në përfundim të gjykimit, që në kontekstin e të tërës përkthehet me aksiomën juridike “*Iura novit curia*” – “*Gjykata e njeh ligjin*”. Në këtë kontekst, gjykatës i duhet të përcaktojë drejt faktet e çështjes, natyrën juridike të saj dhe referencën relevante që gjen zbatim në zgjidhjen e çështjes.

Nga analiza e burimeve të vlerësimit për këtë tregues rezulton se:

- Në lidhje me përshkrimin e fakteve të çështjes

Referuar objektit të mosmarrëveshjes dhe natyrës së çështjes (*civile themeli, familjare, kërkesë civile, gjykim penal themeli, kërkesë e seancës paraprake ose kërkesë penale në fazën e hetimit paraprak*) apo llojit të gjykimit të zhvilluar në çështjet penale (*gjykim i zakonshëm ose i shkurtuar*), gjyqtarja i kushton rëndësi përshkrimit dhe analizës së fakteve të çështjes, si të atyre me natyrë procedurale, ashtu edhe të fakteve që lidhen me themelin, duke i parashtruar ato respektivisht në pjesën e parë dhe të dytë të arsytimit të vendimit.

Paraqitja e rrethanave procedurale, kryesisht në vendimet civile të themelit dhe vendimet penale që lidhen me fazën e seancës paraprake ose të themelit, përshkruhen dhe po ashtu analizohen në një nënndarje që përbën pjesën hyrëse të arsytimit, të titulluar “procedura”, në të cilën parashtrohet, përveç vlerësimit të gjykatës në lidhje me juridiksionin gjyqësor, kompetencën lëndore dhe tokësore, përbërjen e trupit gjykues, aspektet procedurale të caktimit të seancës, njoftimit dhe pjesëmarrjes së palëve në seancë, sipas parashikimeve të K.Pr.Penale, si dhe të drejtave procedurale të tyre, për të vijuar me pas, sipas rastit, me ecurinë procedurale të çështjes lidhur me (i) thirrjen dhe pjesëmarrjen në gjykim të Avokaturës së Shtetit¹, (ii) paraqitjen dhe shqyrtimin e kërkesës për procedim me gjykim të shkurtuar², etj. Në një nga çështjet civile, referuar natyrës së vendimit, gjyqtarja është ndalur vetëm në pasqyrimin dhe analizën e fakteve me natyrë procedurale, kryesisht të atyre lidhur

¹ Vendimi nr. 52, datë 07.02.2018 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë

² Vendimi nr. 247, datë 25.09.2017, vendimi nr. 90, datë 16.04.2018, vendimi nr. 102, datë 18.03.2019, vendimi nr. 117, datë 25.04.2017, vendimi nr. 224, datë 19.07.2017 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë

me njoftimin dhe pjesëmarrjen e palëve në gjykim si dhe pasojat e mosparaqitjes së palës paditëse, në funksion të analizës dhe vendimmarrjes në lidhje me pushimin e gjykimit të çështjes, për shkak të mosparaqitjes së palës paditëse pa shkak të përligjur.

Në këto vendime gjyqësore ku rrethana procedurale që lidhen me shqyrtimin e kërkesave të palëve apo çështjeve të ngritura kryesisht për vlerësim nga gjykata, përshkrimi i fakteve me natyrë procedurale, shoqërohet me vlerësimin dhe analizën ligjore lidhur me këto elementë, posaçërisht në rastet kur ato konsistojnë në shqyrtimin e kërkesave procedurale të palëve, duke i dhënë qartësi vendimit dhe duke orientuar lidhur me elementë të tillë si: ndërgjyqësia, procedura e gjykimit (*gjykim i shkurtuar në çështjet penale apo riti i shqyrtimit në seancë paraprake*), zhvillimin e gjykimit në prezencë ose mungesë të palëve, njoftimin, pjesëmarrjen dhe përfaqësimin e tyre në gjykim, legjitimitetin aktiv të palës paditëse në raport me shkakun ligjor dhe objektin e padisë, etj.

Menjëherë pas paraqitjes dhe vlerësimit në lidhje me rrethanat me karakter procedural, gjyqtarja parashtron faktet e çështjes objekt gjykimi, në një nënndarje të titulluar “Rrethanat e faktit”³, “Faktet dhe provat”⁴, “Faktet dhe pretendimet e palëve”⁵ apo “Faktet”⁶ si në çështjet penale, ashtu edhe në çështjet civile, duke i parashtruar ato në mënyrë të qartë, në një rend logjik dhe kronologjik, dhe duke integruar në përmbajtje të faktit, provat përkatëse të analizuar në raport me njëra tjetrën. Faktet e çështjes janë përshkruar dhe analizuar në mënyrë koncize dhe të plotë, duke u shoqëruar me evidentimin, referimin dhe analizën e provave të administruara në gjykim, për të mbështetur konkluzionet lidhur me provueshmërinë e fakteve thelbësore të çështjes, sidomos në çështjet civile, ndërsa në çështjet penale, gjyqtarja pas pasqyrimin në mënyrë të përmbledhur të fakteve, liston provat që kanë shërbyer për të provuar fakte. Vetëm në një⁷ vendim, ku është vendosur pushimi i gjykimit (me kërkesë të paditësit në seancë përgatitore) nuk është bërë një paraqitje e fakteve, për shkak se gjykata ka disponuar për pushimin e gjykimit për shkaqe procedurale.

- Lidhur me identifikimin e natyrës së çështjes.

Nga identifikimi dhe përshkrimi i saktë i fakteve të çështjes, gjyqtarja përcakton natyrën e marrëdhënies juridike për shkak të së cilës ka lindur mosmarrëveshja midis palëve, nëse natyra juridike e çështjes është civile, familjare apo penale. Thuajse të gjitha vendimet civile burim vlerësimi, gjyqtarja identifikon dhe përcakton qartë dhe në mënyrë të shprehur natyrën e çështjes objekt shqyrtimi, menjëherë pas paraqitjes së rrethanave procedurale dhe analizës së faktit, duke ndalur, kur ka qenë e nevojshme, edhe në analizën ligjore të legjitimitetit aktiv dhe pasiv të palëve ndërgjyqëse⁸. Në çështjet penale, natyra e çështjes rezulton e qartë nga objekti i çështjes dhe identifikohet në pjesën e parë të arsytimit të vendimit, referuar specifikave të çështjeve konkrete, siç janë rastet e çështjeve të seancës paraprake, në të cilat objekti i shqyrtimit rezulton të përcaktohet që në pjesën hyrëse të arsytimit, duke orientuar edhe natyrën e procedimit të zhvilluar, si dhe faktet që do të jenë objekt vlerësimi në vijim të arsytimit. Po ashtu në çështjet penale, identifikimi i natyrës së çështjes objekt shqyrtimi i shërben orientimit të arsytimit të vendimit, duke reflektuar specifikat e çështjeve penale të

³ Në pjesën më të madhe të vendimeve

⁴ Vendimi nr. 226, datë 22.06.2018 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë

⁵ Vendimi nr. 162, datë 24.04.2019, vendimi nr. 508, datë 28.10.2019, vendimi nr. 72, datë 18.10.2019, vendimi nr. 578, datë 25.09.2018, vendim nr. 313, datë 14.05.2019 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë

⁶ Vendimi nr. 145, datë 12.07.2019 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë

⁷ Vendimi nr. 174, datë 03.04.2018 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë

⁸ Vendimi nr.313, datë 15.05.2019 dhe vendim nr.578, datë 25.09.2018 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë

themelit dhe atyre të seancës paraprahe, në funksion të organizimit të analizës ligjore të çështjes.

- Në drejtim të përcaktimit të ligjit të zbatueshëm

Përcaktimi i saktë natyrës së çështjes nuk ka lidhje të drejtpërdrejtë vetëm me kompetencën lëndore dhe funksionale të gjykatës për shqyrtimin e çështjeve, por gjithashtu lidhet me identifikimin e ligjit të zbatueshëm në zgjidhjen e mosmarrëveshjes. Në këtë aspekt, referuar burimeve të vlerësimit, rezulton gjyqtarja përgjithësisht ka identifikuar qartë ligjin e zbatueshëm, duke cituar në përmbajtjen e vendimit dispozitat e ligjit procedural dhe material, të cilat merren në analizë në lidhje me zgjidhjen e çështjeve të karakterit procedural si dhe zgjidhjen në themel të çështjes. Thuajse në çdo vendim ka një nënndarje të titulluar “Ligji i zbatueshëm”. Megjithatë në vendimin e zgjedhur prej saj, me nr.52, datë 07.02.2018, konstatohet se gjyqtarja ka cituar si ligj të zbatueshëm ligjin nr.9253, datë 29.07.2004 “Për kthimin dhe kompesiimin e pronës”, dhe ligjin nr.133/2015 “Për trajtimin e pronës dhe përfundimin e procesit të kompesimit të pronave”, por pa cituar dispozitat konkrete të ligjit që gjejnë zbatim në rastin konkret.

Sa i përket ligjit procedural:

Në çështjet civile, gjyqtarja identifikon dhe referon në pjesën arsyetuese të vendimit, dispozitat procedurale, si më poshtë:

- nenet 35, 35/3, 36/1, 41, 42, 43, 47, 51, 54, 61/2⁹, 511/ç¹⁰ dhe 609¹¹ të K.Pr.Civile, lidhur me përbërjen e gjykatës, përcaktimin e juridiksionit gjyqësor, kompetencës lëndore dhe tokësore të gjykatës në shqyrtimin e mosmarrëveshjeve, referuar objektit të tyre (*çështje me objekt zgjidhje martese, kundërshtim i ekzekutimit të vendimit dhe pavlefshmëri titulli ekzekutiv, njohje pronar, pavërtetësi dokumenti, shpërblim dëmi, etj.*). Në lidhje me çështje të kompetencës lëndore dhe tokësore, gjyqtarja ka referuar edhe në ligje të posaçme, nenin 7 të ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”¹²;
- nenet 71, 72, 73 të K.Pr.Civile lidhur me shkaqet e papajtueshmërisë, përjashtimit apo heqjes dorë të gjyqtarit¹³;
- nenet 171/a dhe 188 të K.Pr.Civile lidhur me të drejtat e gjykatës për zhvillimin e procesit gjyqësor dhe njoftimin e veprimtarisë procedurale¹⁴;
- nenet 185¹⁵, 199/2 dhe dhe 79/a të K.Pr.Civile në lidhje me ndryshimin e objektit të padisë, kalimin procedural të palëve dhe thirrjen e Avokaturës së Shtetit¹⁶;
- nenet 31, 32¹⁷, 32/b/c dhe 388 të K.Pr.Civile në lidhje me padinë, rastet e ngritjes së padisë apo kërkesës për vërtetimin e fakteve apo marrëdhënies juridike¹⁸;
- nenet 201/1 dhe 299/b në lidhje me të drejtën e paditësit për të hequr dorë nga gjykimi i padisë dhe detyrimin e gjykatës të pushojë gjykimin në rastin e kësaj kërkesë¹⁹;

⁹ Vendimi nr. 469, datë 17.07.2018 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë

¹⁰ Vendimi nr.297, datë 13.04.2017 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë

¹¹ Vendimi nr. 115, datë 02.03.2018 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë

¹² Vendimi nr. 313, datë 14.05.2019, vendim nr. 578, datë 25.09.2018 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë

¹³ Vendim nr. 220, datë 07.04.201, vendimi nr.256, datë 25.04.2017, vendim nr. 115, datë 02.03.2018,

vendimi nr. 52, datë 07.02.2018 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë

¹⁴ Vendimi nr. 115, datë 02.03.2018 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë

¹⁵ Vendimi nr. 375, datë 10.06.2019 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë

¹⁶ Vendimi nr.52, datë 07.02.2018 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë

¹⁷ Vendimi nr. 52, datë 07.02.2018 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë

¹⁸ Vendimi nr. 313, datë 14.05.2019, vendim nr. 578, datë 25.09.2018 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë

- nenin 609, 610²⁰ dhe 616 të K.Pr.Civile në lidhje me pavlefshmërinë e titullit ekzekutiv si dhe kundërshtimin e veprimeve përmbartimore dhe rastet e pushimit të ekzekutimit²¹;
- nenin 161/c të K.Pr.Civile në lidhje me bashkëgjyqësinë, shtrirjen e kërimit edhe ndaj një personi tjetër²²;
- nenet 134 të K.Familjes dhe 25, 158/b të K.Pr.C në lidhje me seancën e pajtimit²³;
- nenin 12 të K.Pr. Civile në lidhje me barrën e provës, të detyrimit e palës që pretendon një të drejtë që ta provojë faktet ku mbështetet²⁴;
- nenet 510 dhe 511 të K.Pr.C në lidhje me urdhrin e ekzekutimit dhe evidentimin e kushteve që duhet të rezultojnë për të cilësuar një akt si titull si dhe për lëshimin e urdhrin të ekzekutimit, duke iu referuar në këtë rast edhe nenit 1 të ligjit nr. 8662, datë 18.09.2000 “Për trajtimin si titull ekzekutiv të faturës së konsumit të energjisë elektrike”, i ndryshuar²⁵;
- neni 106 i K.Pr.C në lidhje me shpenzimet gjyqësore²⁶.

Në çështjet penale, referuar natyrës së çështjes (*çështje penale e fazës së hetimit paraprak, seancës paraprake apo gjykim themeli*), apo rritit të gjyqimit (*gjykim i zakonshëm ose i shkurtuar*), gjyqtarja identifikon dispozitat procedurale, si më poshtë:

- nenet 13/3, 69/1, 74, 76 të K.Pr.Penale në drejtim të formimit dhe përbërjes së trupit gjykues, vlerësimit të çështjeve të juridiksionit, kompetencës lëndore dhe tokësore të gjykatës në shqyrtimin e çështjes, në gjykimet e kërkesave penale dhe penale të themelit;²⁷ nenet 71, 72 të ligjit nr. 8328, datë 16.04.1998 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve” i ndryshuar në lidhje me përbërjen e trupit gjykues dhe kompetencën e gjyqtarit për t’u shprehur aq sa i është kërkuar në seancë gjyqësore²⁸ si edhe nenet 477 të K.Pr.P dhe 31/6 të ligjit nr. 8331, datë 21.04.1998 “Për ekzekutimin e vendimeve penale”²⁹; nenet 83/2, 84/1 dhe 87 të K.Pr.Penale në lidhje me kundërshtimin e moskompetencës tokësore para shqyrtimit gjyqësor, gjatë hetimeve paraprake dhe vlefshmërinë e provave të marra nga një gjykatë jokompetente³⁰.
- nenet 328³¹, 328/1/dh, 329/a, 329/b/1 të K.Pr.Penale në lidhje me pushimin e akuzës apo çështjes, kërkesës për pushimin e akuzës apo çështjes dhe shqyrtimi i saj, neni 24 të K.Pr.Penale në lidhje me funksionet e prokurorit³²;
- nenet 37, 296³³ të K.Pr.P në lidhje me deklaratimet që tregojnë vetëpërgjegjësi si dhe marrjen e të dhënave të personit në hetim si dhe nenet 278, 290/1/ç, 291, 291/b dhe 329 të K.Pr.Penale

¹⁹ Vendimi nr. 174, datë 03.04.2018, vendim nr. 375, datë 10.06.2019 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë

²⁰ Vendimi penal nr.145, datë 12.07.2019 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë

²¹ Vendim nr. 115, datë 02.03.2018 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë

²² Vendimi nr. 256, datë 25.04.2017 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë

²³ Nenet në lidhje me zhvillimin e seancës së pajtimit referohen në çdo vendim me objekt “zgjidhje martesë” burim vlerësimi dhe konkretisht në vendimin nr. 212, datë 12.04.2018, vendimin nr. 688, datë 31.10.2019, vendimin nr. 469, datë 17.07.2018 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë

²⁴ Vendimi nr. 688, datë 31.10.2019 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë

²⁵ Vendimi nr. 297, datë 13.04.2017 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë

²⁶ Vendimi nr. 144, datë 05.03.2019, vendimi nr. 212, datë 12.04.2018, vendimi nr. 688, datë 31.10.2019, vendim nr. 469, datë 17.07.2018 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë

²⁷ Vendimi nr. 224, datë 19.07.2017, vendimi nr.117, datë 05.04.2017, vendimi nr. 102, datë 18.03.2019, vendimi nr. 90, datë 16.04.2018, vendimi nr. 247, datë 25.09.2017, vendimi nr. 414, datë 22.10.2019, vendimi nr. 32, datë 04.12.2017, vendimi nr. 135, datë 07.03.2018, vendimi nr. 135, datë 07.03.2018 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë

²⁸ Vendimi nr. 226, datë 22.06.2018 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë

²⁹ Vendimi nr. 72, datë 18.10.2019 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë

³⁰ Vendimi nr. 145, datë 12.07.2019 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë

³¹ Vendimi nr. 135, datë 07.03.2018, vendim nr. 32, datë 04.12.2017 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë

³² Vendim nr. 162, datë 24.04.2019, vendim nr. 508, datë 28.10.2019 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë

³³ Vendimi nr. 135, datë 07.03.2018 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë

- në lidhje me kompetencën e gjykatës gjatë hetimeve paraprake, vendimin për mosfillimin e hetimeve dhe ankimin kundër këtij vendimi³⁴;
- nenet 208, 212 dhe 213 të K.Pr.Penale në lidhje me objektin e sequestrimit, kundërshtimin e vendimit të sequestrimit dhe kopjet e dokumentave të sequestruara³⁵;
 - nenet 278, 290, 290/ç, 291 të K.Pr.P lidhur me rrethanat që nuk lejojnë fillimin apo vazhdimin e procedimit penal³⁶;
 - nenin 331, 332 e vijues të K.Pr.Penale dhe nenin 380 të K.Pr.P në lidhje me përdorimin vetëm të provave të marra gjatë shqyrtimit gjyqësor në marrjen e vendimit që rregullon seancën paraprake³⁷;
 - nenet 38 dhe 39 të K.Pr.Penale në lidhje me rregullat e marrjes në pyetje të të pandehurit.³⁸;
 - nenet 128, 403, 404 dhe 405, 406/1 të K.Pr.P në lidhje me pavlefshmërinë e akteve procedurale dhe në lidhje me institutin e gjykimit të shkurtuar, kushtet procedurale dhe thelbësore të aplikimit të tij³⁹ dhe nenin 354 të K.Pr.Penale në lidhje me kërkesat paraprake⁴⁰;
 - nenin 390 në lidhje me përcaktimin e llojit dhe masës së dënimit në vendimin e dënimit⁴¹;
 - nenet 362, 369, 370 të K.Pr.Penale në lidhje me rastet përjashtimore kur aktet e përfshira në fashikullin e prokurorisë mund të lexohen e mund të përdoren nga gjyqtari i themelit në marrjen e vendimit dhe nenet 323 e vijues të K.Pr.P në lidhje me afatet e hetimit paraprak⁴²;
 - nenet 202, 206, 298/3 të K.Pr.P në lidhje me kushtet e kryerjes së kontrolleve, kontrollin e banesave, kontrollet e mëtejshme të të dhënave kompjuterike dhe nenin 151/3 të K.Pr.P në lidhje me papërdorshmërinë e provave të marrë në shkelje të ndalimeve të parashikuara nga ligji⁴³;
 - 393/1 dhe 485 të K.Pr.P në lidhje me shpenzimet gjyqësore në gjykimin penal⁴⁴.

Sa i përket ligjit material të zbatueshëm, referuar burimeve të vlerësimit në tërësinë e tyre, rezulton se përgjithësisht gjyqtarja identifikon dhe/ose citon dispozitat materiale të cilat gjejnë zbatim në zgjidhjen e çështjes objekt shqyrtimi. Duke i ndarë vendimet gjyqësore objekt vlerësimi në dy kategori:(i) vendime civile/familjare dhe (ii) vendime penale, në lidhje me identifikimin e ligjit të zbatueshëm material, konstatohet se:

Në vendimet civile, gjyqtarja identifikon ligjin material të zbatueshëm në zgjidhjen e çështjes, duke iu referuar si dispozitave materiale të Kodit Civil dhe Kodit të Familjes, ashtu edhe ligjeve të posaçme apo akteve ndërkombëtare që përbëjnë burim të së drejtës, lidhur me:

- *Zgjidhjen e martesës dhe pasojat që rrjedhin prej saj*, gjyqtarja identifikon dhe citon dispozitat ligjore familjare (nenet 1, 6, 50, 55, 129, 125-132, 133, 143, 146, 147-153, 154-162, 192-214, 226 të Kodit të Familjes) lidhur me institutin e martesës, të drejtat dhe detyrimet midis

³⁴ Vendimi nr. 508, datë 28.10.2019, Vendim nr. 145, datë 12.07.2019 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësore Lezhë

³⁵ Vendimi nr. 145, datë 12.07.2019 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësore Lezhë

³⁶ Vendimi nr. 145, datë 12.07.2019 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësore Lezhë.

³⁷ Vendimi nr. 32, datë 04.12.2017, vendim nr. 414, datë 22.10.2019, vendim nr. 135, datë 07.03.2018 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësore Lezhë.

³⁸ Vendimi nr. 135, datë 07.03.2018 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësore Lezhë..

³⁹ Vendimi nr. 247, datë 25.09.2017, vendimi nr. 90, datë 16.04.2018, vendimi nr. 102, datë 18.03.2019, vendimi nr. 117, datë 05.04.2017, vendim nr. 224, datë 19.07.2017, vendim nr. 247, datë 25.09.2017 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësore Lezhë.

⁴⁰ Vendimi nr.224, datë 19.07.2017, vendim nr. 117, datë 05.04.2017 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësore Lezhë.

⁴¹ Vendimi nr.224, datë19.07.2017, vendim nr. 90, datë 16.04.2018, vendim nr.102, datë 18.03.2019, vendim nr. 247, datë 25.09.2017 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësore Lezhë.

⁴² Vendimi nr. 414, datë 22.10.2019 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësore Lezhë.

⁴³ Vendimi nr.117, datë 05.04.2017 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësore Lezhë.

⁴⁴ Vendimi nr. 224, datë 19.07.2017, vendim nr.117, datë 05.04.2017, vendim nr.102, datë 18.03.2019, vendim nr. 247, datë 25.09.2017 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësore Lezhë.

bashkëshortëve, shkaqet e zgjidhjes së martesës, përcaktimin e fajësisë në zgjidhjen e martesës, zgjidhjen e pasojave që rrjedhin prej saj në lidhje me bashkëshortët dhe fëmijët e mitur, parimin e interesit më të lartë të fëmijës, përcaktimin e detyrimit për ushqim dhe mënyrën e ushtrimit të përgjegjësisë prindërore pas zgjidhjes së martesës, etj.⁴⁵;

- *Pavlefshmëri titulli ekzekutiv, vendimi gjyqësor*, ku gjyqtarja identifikon dispozitat ligjore me karakter procedural (*nenet 609, 610, 616 të K.Pr.Civile*) në lidhje me normën ligjore të zbatueshme për pavlefshmërinë e titullit ekzekutiv, vendimi gjyqësor, kundërshtimin e veprimeve përmbartimore⁴⁶;
- *Shpërblimin e dëmit pasuror*, ku gjyqtarja identifikon nenet 608, 609, 614 të K.Civil lidhur me përgjegjësinë në shkaktimin e dëmit dhe përgjegjësinë e të miturit në shkaktimin e tij⁴⁷, nenin 115 dhe 131 të K.Civil në lidhje me afatin e parashkrimit të padisë për shpërblimin e dëmit jokontraktor dhe rastet kur ndërpritet parashkrimi, por pa arsyetuar se kur fillon të llogaritet afati i ri, apo në rastet kur parashkrimi nuk quhet i ndërprerë⁴⁸;
- *Përmbushje detyrimi kontraktor*, gjyqtarja identifikon nenet 419, 420, 463, 690, 698, 772, 775 të K.Civil në lidhje me kuptimin e detyrimit, mënyrën e lindjes së tij, afatet e ekzekutimit të detyrimit, kontratën, detyrimet kontraktore, kontratën e furnizimit dhe karakterin periodik të saj.⁴⁹;
- *Njohjen e vjetërsisë së punës*, gjyqtarja identifikon si ligj të zbatueshëm, dispozitën ligjore me karakter procedural (neni 32 i K.Pr.Civile) në lidhje me arsyet për të cilat mund të ngrihet një padi⁵⁰.
- *Në çështjen me objekt kundërshtimin e vendimit të AKK⁵¹*, gjyqtarja identifikon dhe citon ligjin nr.9235, datë 29.07.2004 “*Për kthimin dhe Kompesimi e pronës*” i ndryshuar, dhe ligjin nr.133/2015 “*Për trajtimin e pronës dhe përfundimin e procesit të kompesimit të pronave*”, por pa cituar dispozitat konkrete të këtij ligji të cilat gjejnë zbatim në rastin konkret, apo për të analizuar pse vendimi i AKKP objekt ankimi është marrë në kundërshtim me ligjin.

Krahas dispozitave të Kodit Civil, Kodit të Familjes gjyqtarja referon në ligje të posaçme të cilat gjejnë zbatim në zgjidhjen e çështjes dhe në një sërë dispozitash të Kushtetutës dhe akteve ndërkombëtare që përbëjnë burim të së drejtës, duke identifikuar konkretisht:

- nenin 53 të Kushtetutës, nenin 8 të KEDNJ, dispozita të Konventës dhe Deklaratën për të Drejtat e Fëmijës,⁵² dhe Konventën për të Drejtat e Fëmijëve, në çështjen me objekt zgjidhje martese, në lidhje me të drejtën për të krijuar familje dhe për të drejtën e jetës private dhe familjare, si dhe parimin e interesit më të lartë të fëmijës,⁵³
- nenin 1, 3, 10, 12/1, 15/1 dhe 20 të ligjit nr. 9669, datë 18.12.2006 “*Për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare*” i ndryshuar, në lidhje me qëllimin e ligjit, kuptimin e termave të përdorur nga ligji, mënyrën se si sigurohet mbrojtja nga dhuna në familje, organet kompetente për lëshimin e urdhrave të mbrojtjes, provat që duhet t’i paraqiten gjykatës dhe procedurën e ndjekur nga gjykata për lëshimin ose jo të urdhërit të menjëhershëm të mbrojtjes;⁵⁴

⁴⁵Vendimi nr. 212, datë 12.04.2018, vendimi nr. 1150, datë 11.12.2019, vendimi nr. 881, datë 03.10.2019.

⁴⁶ Vendimi nr. 115, datë 02.03.2018 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë.

⁴⁷ Vendim nr.256, datë 25.04.2017 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë.

⁴⁸ Vendimi 220, datë 07.04.2017 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë.

⁴⁹ Vendimi nr. 144, datë 05.03.2019 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë.

⁵⁰ Vendim nr. 578, datë 25.09.2018, vendim nr.313, datë 14.05.2019 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë.

⁵¹ Vendimi nr.52, datë 07.02.2018 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë.

⁵²Miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e Organizatës së Kombeve të Bashkuara në 20 nëntor 1989.

⁵³Vendimi nr. 212, datë 12.04.2018, vendimi nr. 1150, datë 11.12.2019, vendimi nr. 881, datë 03.10.2019.

⁵⁴ Vendim nr. 17, datë 06.03.2017 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë.

- nenin 42 të Kushtetutës dhe nenin 1 Protokollit 1 i KEDNJ në lidhje me të drejtën e pronës dhe mbrojtjen e saj⁵⁵;
- nenin 52 të Kushtetutës në lidhje me të drejtën e pensionit të pleqërisë⁵⁶;
- ligjin nr. 8662, datë 18.09.2000 “Për trajtimin si titull ekzekutiv të faturës së konsumit të energjisë elektrike” i ndryshuar, në kuadër të vlerësimit të cilësisë së aktit për të cilin kërkohet lëshimi i urdhrin të ekzekutimit, si titull ekzekutiv⁵⁷;

Në vendimet penale, gjyqtarja identifikon dispozitat materiale penale të sanksionuara në pjesën e posaçme të Kodit Penal, në funksion të analizimit dhe vlerësimit që i bëhet cilësimit juridik të faktit penal që i atribuohet të pandehurit, si edhe dispozitave të përgjithshme të Kodit Penal në funksion të analizës së instituteve dhe parimeve të zbatueshme, si më poshtë:

- identifikon në funksion të vlerësimit lidhur me cilësimin juridik të faktit penal objekt akuze: nenin 324/a të K.Penal në lidhje me përcaktimin e veprës penale “Futja ose mbajtja e sendeve të ndaluara në institucionin e ekzekutimit të vendimeve me burgim” si edhe nenet 1/c, 12 dhe 47, 49, 50/ç të K.Penal në lidhje me parimet ku bazohet Kodi Penal, moshën për përgjegjësi penale, kriteret për përcaktimin e dënimit, rrethanat lehtësuese dhe rënduese⁵⁸;
- nenin 283/1 të K.Penal në lidhje me përcaktimin e veprës penale të “Prodhim dhe shitje e narkotikëve”⁵⁹ si edhe nenet 1/c, 12 dhe 47, 49, 59, 63 të K.Penal në lidhje me parimet ku bazohet Kodi Penal, moshën për përgjegjësi penale, kriteret për përcaktimin e dënimit dhe pezullimi e ekzekutimit të vendimit me burgim dhe vënien në provë⁶⁰ ;
- nenin 291 të K.Penal në lidhje me përcaktimin e veprës penale ‘Drejtimi i automjeteve në mënyrë të parregullt’⁶¹ ;
- nenin 332 e në vijim të K.Pr.Penale (në lidhje me seancën paraprake ku bën një parashtrim të gjatë të procedurës së ndjekur) si dispozitë ligjore me karakter procedural në lidhje me normën ligjore të zbatueshme në rastin e kërkesave penale për dërgimin e çështjes në gjyq ndaj të akuzuarve për veprën penale të «Drejtimi i automjetit në mënyrë të parregullt » parashikuar nga neni 291 i K.Penal dhe për veprën penale të « Ndërtim i paligjshëm » dhe «Pushtimi i tokës » parashikuar nga neni 199/a/2 dhe 200 të K.Penal⁶²
- nenet 328, 329/a, 329/b të K.Pr.Penale si dispozitë ligjore me karakter procedural në lidhje me normën ligjore të zbatueshme në lidhje me kërkesat për pushimin e hetimeve per procedimet penale ndaj të dyshuarve për kryerjen e veprës penale “Goditje për shkak të detyrës” parashikuar nga neni 237 i K.Penal dhe “Pastrim i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale” parashikuar nga neni 287 i K.Penal⁶³;
- nenin 64 të K.Penal në lidhje me kriteret që duhet të plotësojë i dënuari për t’u liruar me kusht⁶⁴;
- nenin 291 të K.Pr.Penale si dispozitë ligjore me karakter procedural në lidhje me normën ligjore të zbatueshme në lidhje me ankimin penal për mosfillimin e procedimit penal si dhe nenin 248 të K.Penal në lidhje me shërdorimin e detyrës⁶⁵;

⁵⁵Vendimi nr. 52, datë 07.02.2018 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë.

⁵⁶ Vendim nr. 578, datë 25.09.2018, vendim nr.313, datë 14.05.2019.

⁵⁷ Vendimi nr. 297, datë 13.04.2017 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë.

⁵⁸ Vendim nr. 102, datë 18.03.2019 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë.

⁵⁹ Vendim nr. 117, datë 05.04.2017, vendim nr.224, datë 19.07.2017 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë.

⁶⁰ Vendim nr. 224, datë 19.07.2017, vendim nr. 90, datë 16.04.2018, Vendim nr. 247, datë 25.09.2017 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë.

⁶¹ Vendim nr. 247, datë 25.09.2017 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë.

⁶² Vendim nr. 32, datë 04.12.2017, vendim nr. 135, datë 07.03.2018, vendim nr. 414, datë 22.10.2019 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë.

⁶³ Vendimi nr. 508, datë 28.10.2019, vendim nr. 162, datë 24.04.2019 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë

⁶⁴ Vendim nr.72, datë 18.10.2019 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë

⁶⁵ Vendim nr.145, datë 12.07.2019 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë

- nenin 137 të K.Penal në lidhje me përcaktimin e veprës penale të “Vjedhje e energjisë elektrike”⁶⁶

Krahas dispozitave të Kodit Penal dhe ligjeve të posaçme si më sipër, gjyqtarja ka identifikuar dhe referuar si ligj të zbatueshëm edhe një sërë dispozitash të Kushtetutës dhe akteve ndërkombëtare që përbëjnë burim të së drejtës si dhe një sërë ligjesh të posaçme në drejtim të vlerësimit të anës objektive të veprave penale specifike, dhe konkretisht:

- nenin 32 të Kushtetutës lidhur me parimin e mos dënimit pa ligj si dhe parimin se askush nuk mund të dënohet mbi bazën e të dhënave të mbledhura në mënyrë të paligjshme⁶⁷;
- nenin 27 të Kushtetutës në lidhje me parimin e moskufizimit të lirisë, përveç në rastet dhe sipas procedurave të parashikuara nga ligji;⁶⁸
- nenin 148 të Kushtetutës në lidhje me funksionet e prokurorisë si organ kushtetues⁶⁹
- nenin 31/6 të ligjit nr. 8331, datë 21.04.1998 “Për ekzekutimin e vendimeve penale” në lidhje me ndihmën që Gjykata i kërkon shërbimit të provës në përgatitjen e një raporti socio-ekonomik për të dënuarin gjatë shqyrtimit të kërkesës për lirim me kusht;⁷⁰
- Neni 115/1 i ligjit nr. 8378, datë 22.07.1998 “Kodi Rrugor i RSH”, në kuadër të analizës së anës objektive të veprës penale të parashikuar nga neni 291 i Kodit Penal⁷¹;
- Nenin 63 të ligjit nr. 8328, datë 16.04.1998 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve” i ndryshuar⁷².

Sa i përket konfliktit të normave, në vendimet gjyqësore burim vlerësimi, nuk konstatohet që të jetë evidentuar nga gjyqtarja ndonjë rast i konfliktit të normave ligjore procedurale ose materiale, referuar kjo edhe natyrës së çështjeve të trajtuara.

KONKLUZIONI

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtarja ka aftësi shumë të mira për përshkrimin dhe analizën e fakteve, si të atyre me natyrë procedurale, në të cilat jepet një panoramë e qartë e ecures së çështjes dhe veprimeve të kryera, së bashku me analizën ligjore, në rastet kur elementët proceduralë lidhen në trajtimin e kërkesave të palëve, ashtu edhe të fakteve thelbësore të çështjes, të cilët paraqiten në mënyrë koncize, të plotë dhe analitike, duke integruar provat e administruara në gjykim dhe faktin e ekstraktuar si pasojë e analizës dhe vlerësimit tërësor të tyre. Gjithashtu gjyqtarja ka aftësi shumë të mira në identifikimin e normës/normave konkrete procedurale dhe/ose materiale që gjejnë zbatim në zgjidhjen e çështjes, citimin dhe analizën e tyre në funksion të zgjidhjes së mosmarrëveshjes, si dhe në përcaktimin e qartë të natyrës së mosmarrëveshjes në shqyrtim, e cila shërben si bazë për orientimin e arsyetimit dhe analizës ligjore lidhur me zgjidhjen e saj.

⁶⁶ vendim nr.90, datë 16.04.2018 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësore Lezhë

⁶⁷ Vendimi nr. 117, datë 05.04.2017 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësore Lezhë

⁶⁸ Vendimi nr. 508, datë 28.10.2019, vendim nr. 162, datë 24.04.2019 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësore Lezhë

⁶⁹ Vendim nr. 145, datë 12.07.2019 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësore Lezhë

⁷⁰ Vendim nr. 72, datë 18.10.2019 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësore Lezhë

⁷¹ Vendimi nr. 357, datë 17.12.2018 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësore Lezhë

⁷² Vendim nr. 226, datë 22.06.2018 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësore Lezhë

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtarës në lidhje me treguesin “Aftësia për të identifikuar natyrën e çështjes, ligjin e zbatueshëm dhe/ose konfliktin e normave” vlerësohet “Shumë e lartë” dhe pikëzohet me 25 pikë.

1.A.b Aftësia për të interpretuar ligjin në zgjidhjen e çështjes.

Interpretimi i ligjit është ekskluzivitet i gjyqtarit, interpretim i cili duhet të bëhet duke dhënë kuptimin e saktë dhe të rregullt normës ligjore. Interpretimi, si funksion dhe metodë duhet ti japë jetë normave materiale dhe procedurale relevante, përmes kuptimit të drejtë të përmbajtjes dhe qëllimit të tyre në funksion të zgjidhjes së mosmarrëveshjes.

Në vendimet gjyqësore burim vlerësimi, identifikimi i normës juridike (*procedurale dhe materiale - civile apo penale*) si ligj i zbatueshëm në zgjidhjen e çështjes, bëhet në shërbim të analizës juridike të fakteve objekt shqyrtimi dhe duke sjellë si rrjedhojë logjike konkluzionin e arritur nga gjyqtarja lidhur me zbatimin e saj. Normat ligjore në shumicën e rasteve referohen ose citohen duke u shoqëruar në çdo rast me interpretimin e tyre abstrakt dhe por e njëjta rëndësi nuk i kushtohet interpretimit të tyre me aplikimin mbi faktet e çështjes, si në ato me natyrë procedurale ashtu edhe në ato që kanë lidhje me themelin e çështjes. Nga burimet e vlerësimit konstatohet se përgjithësisht gjyqtarja përqendrohet në interpretimin abstrakt të normës, të shoqëruar në shumë raste edhe me praktikën e Gjykatës së Lartë, të Gjykatës Kushtetuese dhe në disa raste edhe të GJEDNJ, duke dhënë një panoramë të gjërë të praktikës lidhur me çështjet e ngjashme, pa e zërthyer normën në raport me faktet e çështjes, për të shkuar si rrjedhojë logjike në konkluzionet e arritura lidhur me zbatimin e saj në rastet konkrete apo në rastet kur bëhet një zberthim i tillë është i shkurtër në raport me trajtimin teorik të rastit.

- Në lidhje me interpretimin e ligjit material të zbatueshëm:

Në vendimet civile përgjithësisht interpretimi i normës bëhet duke identifikuar në mënyrë specifike qëllimin, funksionin, kushtet dhe kriteret që duhet të plotësohen në mënyrë kumulative ose alternative, që të gjejë zbatim norma konkrete, por jo gjithmonë e analizon normën në përputhje me faktin që ka rezultuar i provuar në gjykim. Në mënyrë më specifike, në disa prej vendimeve gjyqësore burim vlerësimi rezulton se gjyqtarja citon dhe analizon:

- *Nenet të Kodit të Familjes*, nenet 1 dhe 50 analizojnë parimet mbi të cilat lidhet dhe bazohet martesja dhe të drejtat dhe detyrimet reciproke të bashkëshortëve, nenin 55 ku analizohet detyrimi i bashkëshortëve për një jetë të përbashkët si një element themelor mbi të cilin mbështetet martesja, nenet 50 dhe 132 duke analizuar shkaqet ku bazohen bashkëshortët për të kërkuar zgjidhjen e martesës, analizojnë nenin 133 në lidhje me rastet kur gjykata përcakton fajësinë, nenin 146 dhe 143 duke analizuar pasojën e zgjidhjes së martesës në lidhje me mbiemrin e bashkëshortit që ka ndryshuar me martesë, si dhe detyrimin e pasqyrimin të ndryshimeve në gjendjen civile, nenet 6, 154 dhe 155, 158, 161, 201 duke analizuar (bazuar edhe në provën e marrë me psikolog) rëndësinë e prindërimit edhe pas zgjidhjes së martesës, të drejtat dhe detyrimet e ish-bashkëshortëve në përcaktimin e interesit më të lartë të fëmijës

dhe përcaktimin e përgjegjësisë prindërore dhe detyrimit për ushqim si një vendim i ndryshueshëm në kohë etj.⁷³

- nenet 608, 609, 614 të K.Civil duke analizuar elementët e dëmit me karakter pasuror, duke konkluduar në nevojën e ekzistencës së të katër elementëve që një person të mbajë përgjegjësi civile për shkaktimin e tij, dhe nenet 115 dhe 133 të K.Civil në lidhje me afatin e parashkrimit të padisë për shpërblimin e dëmit jokontraktor dhe rastet kur ndërpritet parashkrimi⁷⁴, por pa i cituar përmbajtjen e plotë të neneve 115 dhe 133 të K.Civil si dhe pa dhënë një përkufizim të qartë për kuptimin e ndërprerjes dhe si këto dispozita gjejnë zbatim në rastin konkret, mungesë e të cilave e bëjnë të paqartë përfundimin e arritur nga gjyqtarja;
- nenin 772, të K.Civil duke analizuar kontratën e furnizimit, faktin se kjo kontratë nuk është formale dhe karakterin periodik të saj.⁷⁵
- Në çështjen me objekt kundërshtimin e vendimit të AKKP⁷⁶, gjyqtarja ka identifikuar dhe cituar si ligj të zbatueshëm, ligjin nr.9235, datë 29.07.2004 “Për kthimin dhe Kompesimi e pronës” i ndryshuar, dhe ligjin nr.133/2015 “Për trajtimin e pronës dhe përfundimin e procesit të kompesimit të pronave”, si dhe ka identifikuar qëllim dhe funksionin e tij, kushtet dhe kriterit që duhet të plotësohet në mënyrë komulative, që gjejnë zbatim në rastin e shqyrtimit të ligjshmërisë së vendimeve të AKKP apo KKP si vendime që njohin të drejtën e pronësisë së subjekteve të shpronësuar, duke dhënë një panoramë të gjërë të qëndrimeve të Gjykatës së Lartë, të Gjykatës Kushtetuese apo të GJEDNJ, lidhur me çështjet që i përkasin vendimeve të AKKP apo të Komisioneve të Kthimit dhe Kompesimit të pronave, por pa cituar dhe analizuar dispozitat konkrete të ligjeve “Për kthimin e kompesimin e pronave”, të ndryshuar ndër vite, të cilat gjejnë zbatim në rastin konkret, apo për të analizuar pse vendimi i AKKP objekt ankimi është marrë në kundërshtim me ligjin, në raport me rrethanat dhe faktet e çështjes të provuar gjatë gjyqimit.

Përveç dispozitave të Kodit Civil dhe Kodit të Familjes, për shyrtrimin e çështjes, gjyqtarja merr në analizë dispozita të Kushtetues apo të Konventave të ndryshme, dispozita të ligjeve të ndryshme si p.sh:

- nenin 53 të Kushtetutës, nenin 8 të KEDNJ, dispozita të Konventës dhe Deklaratën për të Drejtat e Fëmijës në çështjen me objekt zgjidhje martese, në lidhje me të drejtën për të krijuar familje dhe për të drejtën e jetës private dhe familjare, si dhe parimin e interesit më të lartë të fëmijës;⁷⁷
- nenin 1, 3, 10, 12/1, 15/1 dhe 20 të ligjit nr. 9669, datë 18.12.2006 “Për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare” i ndryshuar, në lidhje me qëllimin e ligjit, kuptimin e termave të përdorur nga ligji, mënyrën se si sigurohet mbrojtja nga dhuna në familje, organet kompetente për lëshimin e urdhrave të mbrojtjes, provat që duhet t’i paraqiten gjykatës dhe procedurën e ndjekur nga gjykata për lëshimin ose jo të urdhërit të menjëhershëm të mbrojtjes;⁷⁸
- nenin 42 të Kushtetutës dhe nenin 1 Protokollit 1 i KEDNJ në lidhje me të drejtën e pronës dhe mbrojtjen e saj⁷⁹, duke bërë një arsyetim abstrak të këtyre normave, po pa bërë një

⁷³Vendimi nr. 212, datë 12.04.2018, vendimi nr. 688, datë 31.10.2019, vendimi nr. 469, datë 17.07.2018 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë.

⁷⁴ Vendim nr.256, datë 25.04.2017, Vendimi 220, datë 07.04.2017 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë.

⁷⁵ Vendimi nr. 144, datë 05.03.2019 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë.

⁷⁶ Vendimi nr.52, datë 07.02.2018 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë.

⁷⁷Vendimi nr. 212, datë 12.04.2018, vendimi nr. 688, datë 31.10.2019, vendimi nr. 469, datë 17.07.2018 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë

⁷⁸ Vendim nr. 17, datë 06.03.2017 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë

⁷⁹Vendimi nr. 52, datë 07.02.2018 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë

analizë për të shkuar tek konkluzionet e arritura nga gjyqtarja lidhur me mënyrën e zbatimit të tyre.

- nenin 52 të Kushtetutës në lidhje me të drejtën e pensionit të pleqërisë⁸⁰;
- ligjin nr. 8662, datë 18.09.2000 “Për trajtimit si titull ekzekutiv të faturës së konsumit të energjisë elektrike” i ndryshuar, në kuadër të vlerësimit të cilësisë së aktit për të cilin kërkohet lëshimi i urdhrit të ekzekutimit, si titull ekzekutiv⁸¹;

Në vendimet penale gjyqtarja interpreton dispozitat e pjesës së posaçme dhe të përgjithshme të Kodit Penal në lidhje me cilësimin e veprës penale, elementët e saj (që përgjithësisht ndalet gjatë në interpretimin e tyre për çdo vepër penale në gjykim), moshën për përgjegjësi penale, bashkëpunimin, pezullimin e dënimit, dënimin alternativ etj. Më konkretisht gjyqtarja analizon:

- nenet 1/c, 12 dhe 47, 49, 50/ç 59, 63 të K.Penal në lidhje me parimet ku bazohet Kodi Penal, moshën për përgjegjësi penale, kriteret për përcaktimin e llojit dhe masës së dënimit, pezullimin e ekzekutimit të vendimit me burgim dhe vënien në provë⁸² ;
- nenin 324/a të K.Penal në lidhje me përcaktimin e veprës penale “Futja ose mbajtja e sendeve të ndaluara në institucionin e ekzekutimit të vendimeve me burgim”;
- nenin 283/1 të K.Penal në lidhje me përcaktimin e veprës penale të “Prodhim dhe shitje e narkotikëve”⁸³
- nenin 291 të K.Penal në lidhje me përcaktimin e veprës penale ‘Drejtimi i automjeteve në mënyrë të parregullt’⁸⁴ ;
- nenin 64 të K.Penal në lidhje me kriteret që duhet të plotësojë i dënuari për t’u liruar me kusht⁸⁵;
- nenin 137 të K.Penal në lidhje me përcaktimin e veprës penale të “Vjedhje e energjisë elektrike”⁸⁶

Krahas dispozitave të Kodit Penal dhe ligjeve të posaçme si më sipër, gjyqtarja ka analizuar edhe një sërë dispozitash të Kushtetutës dhe akteve ndërkombëtare që përbëjnë burim të së drejtës si dhe një sërë ligjesh të posaçme në drejtim të vlerësimit të anës objektive të veprave penale specifike, dhe konkretisht:

- nenin 32 të Kushtetutës lidhur me parimin e mos dënimit pa ligj si dhe parimin se askush nuk mund të dënohet mbi bazën e të dhënave të mbledhura në mënyrë të paligjshme⁸⁷;
- nenin 27 të Kushtetutës në lidhje me parimin e moskufizimit të lirisë, përveç në rastet dhe sipas procedurave të parashikuara nga ligji; ⁸⁸
- nenin 148 të Kushtetutës në lidhje me funksionet e prokurorisë si organ kushtetues⁸⁹

Në ato raste kur dispozita e pjesës së posaçme të K. Penal në lidhje me veprën penale që i atribuohet të pandehurit është një dispozitë blankete ose kur është i nevojshëm referimi në

⁸⁰ Vendim nr. 578, datë 25.09.2018, vendim nr.313, datë 14.05.2019 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë

⁸¹ Vendimi nr. 297, datë 13.04.2017 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë

⁸² Vendim nr. 102, datë 18.03.2019, Vendim nr. 224, datë 19.07.2017, vendim nr. 90, datë 16.04.2018, Vendim nr. 247, datë 25.09.2017 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë

⁸³ Vendim nr. 117, datë 05.04.2017, vendim nr.224, datë 19.07.2017 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë

⁸⁴ Vendim nr. 247, datë 25.09.2017 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë

⁸⁵ Vendim nr.72, datë 18.10.2019 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë

⁸⁶ vendim nr. 90, datë 16.04.2018 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë

⁸⁷ Vendimi nr. 117, datë 05.04.2017 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë

⁸⁸ Vendimi nr. 508, datë 28.10.2019, vendim nr. 162, datë 24.04.2019 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë

⁸⁹ Vendim nr. 145, datë 12.07.2019 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë

ligje të posaçëm për të analizuar objektin dhe anën objektive të veprës penale, gjyqtarja zbaton dhe në disa raste referon në interpretim edhe në dispozita të ligjeve të posaçme si psh:

- nenin 31/6 të ligjit nr. 8331, datë 21.04.1998 “Për ekzekutimin e vendimeve penale” në lidhje me ndihmën që Gjykata i kërkon shërbimit të provës në përgatitjen e një raporti socio-ekonomik për të dënuarin gjatë shqyrtimit të kërkesës për lirim me kusht;⁹⁰
- Neni 115/1 i ligjit nr. 8378, datë 22.07.1998 “Kodi Rrugor i RSH”, në kuadër të analizës së anës objektive të veprës penale të parashikuar nga neni 291 i Kodit Penal⁹¹;
- Nenin 63 të ligjit nr. 8328, datë 16.04.1998 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve” i ndryshuar⁹².

Përsa i përket interpretimit të dispozitave procedurale civile dhe penale, gjyqtarja i jep rëndësi interpretimit të normës së zbatueshme si në rastet kur trajtohen çështje të procedurës, ashtu edhe në rastet kur është vetë dispozita procedurale ajo që vjen në ndihmë të zgjidhjes së çështjes në themel, si p.sh çështjet penale të seancës paraprake. Konkretisht:

- në çështjet penale të themelit gjyqtarja interpreton dispozitat procedurale në mbështetje të argumentimit të saj në lidhje me vlerësimin e kërkesës për procedim me gjykim të shkurtuar (*neni 403, 406 i K.Pr.Penale*), në mbështetje të të cilit referon edhe praktikën unifikuese të Gjykatës së Lartë (*vendimin nr. 2, datë 29.01.2003 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë*) dhe praktikën e Gjykatës Kushtetuese (*vendimi nr. 4, datë 10.02.2012 dhe vendimin nr. 24, datë 30.04.2012*)⁹³. Po ashtu në këto çështje gjyqtarja interpreton normat procedurale (nenin 128 e vijues të K.Pr.P) në lidhje me pavlefshmërinë e akteve, llojet e pavlefshmërisë dhe rolin e gjyqtarit për kontrollin e tyre.
- në vendimet e kategorisë së çështjeve seancë paraprake (*dërgim në gjyq*), gjyqtarja i kushton rëndësi interpretimit të normave procedurale penale (*nenet 328, 328/1/dh, 329, 329/a, 329/b, 331, 332 e vijues të K.Pr.Penale*) në drejtim të përcaktimit të rolit të gjykatës në kontrollin dhe vlerësimin e veprimeve të kryera gjatë fazës së hetimit paraprak; analizës dhe vlerësimit në drejtim të qëllimit të këtij instituti të ri procedural (*seancës paraprake*); funksionin e kësaj faze procedurale dhe detyrat e gjyqtarit të seancës paraprake në funksion të vlerësimit të plotësisht të kushteve dhe kriterëve ligjore për dërgimin e çështjes në gjyq ose pushimin e procedimit penal; përcaktimin e burimeve të provës dhe formimit të fashikullit të gjykimit; analizën e konceptit të mjaftueshmërisë së provave në mbështetje të provueshmërisë së faktit penal dhe autorësisë; rolin e gjyqtarit të seancës paraprake në lidhje me vlerësimin apo ndryshimin e kualifikimit ligjor apo kryerjen e veprimeve shtesë,⁹⁴ etj. Po në këto çështje gjyqtarja interpreton normat procedurale (nenin 291 dhe 329 të K.Pr.P) në lidhje me të drejtën e kontrollit gjyqësor ndaj vendimit të prokurorit për pushimin e procedimit penal gjatë fazës së hetimeve paraprake.
- *Analizon nenin 151/3 të K.Pr.Penale në lidhje me nenin 32 të Kushtetutës* në lidhje me papërdorshmërinë e provave të marrë në shkelje të ndalimeve të parashikuara nga ligji,

⁹⁰ Vendim nr. 72, datë 18.10.2019 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë

⁹¹ Vendimi nr. 357, datë 17.12.2018 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë

⁹² Vendim nr. 226, datë 22.06.2018 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë

⁹³ Vendimi nr. 247, datë 25.09.2017, vendimi nr. 90, datë 16.04.2018, vendimi nr. 102, datë 18.03.2019, vendim nr. 224, datë 19.07.2017 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë.

⁹⁴ Vendim nr. 162, datë 24.04.2019, vendim nr. 508, datë 28.10.2019, Vendimi nr. 32, datë 04.12.2017, vendim nr. 414, datë 22.10.2019, vendim nr. 135, datë 07.03.2018 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë.

duke qenë se askush nuk mund të deklarohet fajtor mbi bazën e të dhënave të mbledhura në mënyrë të paligjshme⁹⁵;

- merr në analizë, duke iu referuar në mënyrë të përgjithshme dispozitave procedurale dhe nenit 42 të Kushtetutës, të drejtën për akses në gjykatë dhe konceptin e “interetit të ligjshëm”, në funksion të vlerësimit mbi legjitimitetin aktiv të palës paditëse për të ngritur padinë e parashikuar nga neni 32/c i K.Pr.Civile⁹⁶;
- analizon nenin 510/e dhe 511/ç duke shpjeguar se çfarë konsiderohet titull ekzekutiv dhe çfarë kriteresh duhet të përmbushë një akt që të konsiderohet titull ekzekutiv⁹⁷;
- merr në analizë dispozitat ligjore me karakter procedural (*nenet 609, 610, 616 të K.Pr.Civile*) në lidhje me normën ligjore të zbatueshme për pavlefshmërinë e titullit ekzekutiv, vendim gjyqësor të formës së prerë, të kundërshtimit të veprimeve përmbarimore si dhe me faktin se nuk ndodhemi para rastit të pushimit të ekekutimi⁹⁸;
- analizon nenin 12 të K.Pr. Civile në lidhje me detyrimin e palës që pretendon një të drejtë të ta provojë faktet ku mbështetet⁹⁹;

Në vendimet penale themeli Gjykata, në caktimin e dënimit, ndër të tjera, analizon rrezikshmërinë e veprës penale, rrezikshmërinë shoqërore të personit, shkallën e fajit si dhe rrethanat rënduese dhe lehtësuese.

Në lidhje me aftësinë për të përdorur jurisprudencën relevante, rezulton se gjyqtarja ka identifikuar dhe përdorur gjerësisht jurisprudencën relevante (*vendimet unifikuese të Gjykatës së Lartë, vendimet e Kolegjit Civil dhe Penal të Gjykatës së Lartë, Gjykatës Kushtetuese dhe GJEDNJ*), në mbështetje të argumenteve të saj në lidhje me interpretimin dhe zbatimin e ligjit, kryesisht në rastet si më poshtë:

- Në funksion të analizës së aplikimit apo jo të gjykimit të shkurtuar, posaçërisht në funksion të zbatimit të parimit të ekonomisë gjyqësore dhe drejtësisë efektive, mbështetet dhe referon në praktikën unifikuese të Gjykatës së Lartë (*vendimin nr. 2, datë 29.01.2003 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë*) dhe praktikën e Gjykatës Kushtetuese (*vendimi nr. 4, datë 10.02.2012 dhe vendimin nr. 24, datë 30.04.2012*)¹⁰⁰.
- Lidhur me përcaktimin e natyrës së mosmarrëveshjes, ku vërtetimi i faktit të ekzistencës së marrëdhënies së punës është i natyrës civile, mbështetet dhe referon në vendimin nr. 00-2015—515, datë 26.02.2015 i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë¹⁰¹.
- Në funksion të interpretimit të së drejtës për t’u martuar dhe për të pasur një jetë familjare, gjyqtarja referon nenin 8 të KEDNJ, dispozita të Konventës dhe Deklaratën për të Drejtat e Fëmijës¹⁰² dhe në nenin 1 të protokollit 1 të KEDNJ në lidhje me të drejtën e pronës dhe gëzimit të lirë të saj¹⁰³.
- Në lidhje me kriteret që duhet të plotësojë një akt për të qenë një titull ekzekutiv gjyqtarja referon në Vendimin Unifikues nr. 980, datë 29.09.2000 dhe vendimin nr. 3, datë 29.03.2012¹⁰⁴.

⁹⁵ Vendim nr. 117, datë 05.04.2017 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë.

⁹⁶ Vendim nr. 578, datë 25.09.2018, vendim nr.313, datë 14.05.2019, vendim nr.220, datë 07.04.2017 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë.

⁹⁷ Vendimi nr. 297, datë 13.04.2017 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë.

⁹⁸ Vendimi nr. 115, datë 02.03.2018 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë

⁹⁹ Vendim nr. 688, datë 31.10.2019 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë

¹⁰⁰ Vendimi nr. 247, datë 25.09.2017, vendimi nr. 90, datë 16.04.2018, vendimi nr. 102, datë 18.03.2019, vendim nr. 224, datë 19.07.2017 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë

¹⁰¹ Vendim nr.578, datë 25.09.2018, vendim nr. 313, datë 14.05.2019 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë

¹⁰² Vendimi nr. 212, datë 12.04.2018, vendimi nr. 688, datë 31.10.2019, vendimi nr. 469, datë 17.07.2018 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë

¹⁰³ Vendim nr. 52, datë 07.02.2018 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë

¹⁰⁴ Në lidhje me kamatvonesat

të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, Vendimin nr. 6, datë 10.01.2012 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë.¹⁰⁵

- Në kuadër të vlerësimit të juridiksionit dhe kompetencës lëndore apo tokësore gjyqtarja referon vendimin unifikues 4/2013 dhe 2/2011 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, ndërsa në lidhje me mënyrat e fitimit të pronësisë, posaçërisht në interpretimin e frymës së ligjit për «Kthimin dhe kompensimin e pronave ish-pronarëve» referon në Vendimin Unifikues nr. 24, datë 13.03.2002 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, Vendimin 27/2010 të Gjykatës Kushtetuese lidhur me natyrën e gjykimeve në rastet e kërimit të kthimit të pronës dhe Vendimin nr. 4/1994 lidhur me pronat që mund t'i kthehen pronarëve¹⁰⁶.
- Në lidhje me pavlefshmërinë e titullit ekzekutiv, gjyqtarja referon në Vendimin 76/2012 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, në Vendimin 272/2010 të Kolegjit civil të GjL në lidhje me rastet përjashtimore kur mund të goditet vendimi gjyqësor për pavlefshmëri pa ndjekur rrugën e ankimit dhe në Vendimin 30/2006 dhe 81/2011 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë në lidhje me kundërshtimin e veprimeve përmbarimore¹⁰⁷ ;
- Në lidhje me vlerësimin e kërkesës për procedim me gjykim të shkurtuar (*neni 403, 406 i K.Pr.Penale*), në mbështetje të të cilit referon në praktikën unifikuese të Gjykatës së Lartë (*vendimin nr. 2, datë 29.01.2003 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë*) dhe praktikën e Gjykatës Kushtetuese (*vendimi nr. 4, datë 10.02.2012 dhe vendimin nr. 24, datë 30.04.2012*)¹⁰⁸.
- Në kuadër të vlerësimit të mënyrës dhe kohës së marrjes së provës, papapërdorshmërinë e provave të marra në mënyrë të parregullt, gjyqtarja referon në vendimet 252/2010, 37/2016, 44/2012, 180/2013 të Gjykatës së Lartë¹⁰⁹.
- Lidhur me fazën e fillimit të procedimit penal dhe palët që marrin pjesë në gjykimin e ankimit kundër vendimit të prokurorit për mosfillim, gjyqtarja referon Vendimin 129/2015 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë dhe vendimin nr. 2/2013 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, në vendimin nr. 14/2008 të Gjykatës Kushtetuese dhe Vendimin nr. 7/2013 dhe 196/2012 të Kolegjit Penal të Gjykatës Kushtetuese në lidhje me rastet kur lejohet ankim gjyqësor ndaj vendimeve të prokurorit gjatë hetimeve paraprake¹¹⁰.
- Lidhur me qëllimin e institutit të lirit me kusht gjyqtarja referon në Vendimin nr. 10/2012, vendimin nr. 25/2014 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, në Vendimin Unifikues nr. 2/2015 lidhur me masat që duhet të marrin autoritet shtetërore që dënimin të shërbejë për riedukim e jo vetëm si ndëshkim, në Vendimi Unifikues Nr. 2, date 25.05.2015 i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, vendimi Nr. 10, date 10.01.2012, vendimi Nr.230, date 19.12.2014, vendimi Nr.75, datë 12.03.2014, vendim nr. 10, date 10.01.2012, vendim nr. 72, date 07.03.2012, vendim nr. 125, date 02.05.2012, vendim nr. 155, date 16.11.2011, vendimi nr. 160, date 08.06.2012 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë lidhur me arsyet e veçanta që tregojnë se dënimin i vuajtur e ka arritur qëllimin e për edukim dhe i dënuari është i aftë të riintegrohet në shoqëri, në vendimin nr. 119/2014 në lidhje ndihmën që Shërbimi i Provës i jep Gjykatës për mundësitë që i dënuari ka realisht për t'u riintegruar në shoqëri e për të mos u bërë përsëritës.¹¹¹

Në lidhje me zbatimin e parimeve të përgjithshme të së drejtës, nga tërësia e vendimeve burim vlerësimi, rezulton kujdesi i gjyqtarës që gjatë interpretimit të ligjit të zbatueshëm në zgjidhjen e çështjes të referohen dhe zbatohen parimet e përgjithshme të së drejtës, gjë që

¹⁰⁵ Vendim nr.297, datë 13.04.2017 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë

¹⁰⁶ Vendim nr. 52, datë 07.02.2018 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë

¹⁰⁷ Vendim nr. 115, datë 02.03.2018 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë

¹⁰⁸ Vendimi nr. 247, datë 25.09.2017, vendimi nr. 90, datë 16.04.2018, vendimi nr. 102, datë 18.03.2019, vendim nr. 224, datë 19.07.2017 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë

¹⁰⁹ Vendim nr. 117, datë 05.04.2017 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë

¹¹⁰ Vendim nr. 145, datë 12.07.2019 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë

¹¹¹ Vendim nr.72, datë 18.10.2019 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë

realizohet duke i përmendur ato shprehimisht apo të nxjerra nga konteksti i arsytimit të vendimit. Gjyqtarja njeh, referon dhe zbaton parimet materiale dhe procedurale gjatë gjykimit, siç janë:

- Parimet e përgjithshme në caktimin e dënimit, *si të barazisë para ligjit, të drejtësisë në caktimin e fajësisë dhe të dënimit, të humanizmit, përshtatshmërisë së llojit dhe masës së dënimit (neni 47, 1/b dhe 1/c i K. Penal)*, parimi i individualizimit të dënimit të cilat analizohen më pas në raport me rrethanat konkrete të çështjes¹¹²;
- *Parimin e drejtësisë efektive dhe ekonomisë gjyqësore*, në mbështetje të argumenteve lidhur me pranimin e kërkesës për procedim me gjykim të shkurtuar¹¹³;
- *Parimin e ligjshmërisë* i referuar dhe po ashtu i nxjerrë nga konteksti i arsytimit dhe konkluzionit të arritur në të gjitha vendimet penale të themelit;
- *Parimin e procesit të rregullt ligjor (neni 42 i Kushtetutës)* si dhe garantimin e respektimit të të drejtave dhe lirive të njeriut, të cilat rezultojnë edhe nga arsyetimi, duke iu referuar aspekteve procedurale të gjykimit që lidhen me njoftimin dhe pjesëmarrjen e subjekteve në proces, të drejtën e mbrojtjes, në vendimet penale të themelit dhe seancës paraprake¹¹⁴; Posaçërisht në vendimet penale të seancës paraprake gjyqtarja referon parimet e kontradiktoritetit si dhe paanshmërisë së gjykatës¹¹⁵;
- *Parimin e interesit më të lartë moral dhe material të fëmijëve të mitur*, duke cituar për këtë qëllim nenet 2, 3 dhe 5 të K. Familjes, dispozita të Konventës së OKB “Mbi të drejtat e fëmijëve”, Deklaratën për të Drejtat e Fëmijës, Deklaratën Universale të të Drejtave të Njeriut si dhe nenin 53 të Kushtetutës. Po ashtu në lidhje me të drejtën e takimit të fëmijës, gjyqtarja mban në konsideratë edhe *të drejtën për jetë familjare* të sanksionuar në nenin 8/1 të KEDNJ. Në këto vendime, në kuadër të analizës lidhur me të drejtën për martesë, të drejtën për jetë private dhe familjare, gjyqtarja referon *parimin e autonomisë së vullnetit të palëve në lidhjen e martesës*¹¹⁶;
- *Parimin e rregullshmërisë dhe efikasitetit të lidhjes shkakësore (id quod plerum que acidit)* në funksion të shpjegimit të lidhjes shkak-pasojë ndërmjet faktit të paligjshëm në tërësinë e tij dhe çënimeve konkrete të pësura në të drejta dhe interesa të ligjshme¹¹⁷;
- Në vendimet civile, gjyqtarja referon *parimin “iura novit curia” (gjykata e njeh ligjin)* në funksion të përmbushjes së funksionit të gjykatës për identifikimin e natyrës së kërkimeve objekt padie dhe ligjin e zbatueshëm, pavarësisht nga mënyra e formulimit të objekti të padisë apo bazës ligjore të referuar nga paditësi;
- *Parimin e procesit të rregullt ligjor* nëpërmjet zhvillimit të një hetimi gjyqësor të plotë dhe të gjithanshëm në çështjet civile (*nenet 14 dhe 16 të K.Pr.Civile*)¹¹⁸.

Lidhur me këtë tregues gjyqtarja në kundërshtimet e saj ka kërkuar pikëzimin maksimal me 25 pikë, duke parashtruar se konkluzionet e relatores nuk janë të sakta dhe kontradiktore me pjesën tjetër të analizës së bërë në projektraportit. Konkretisht ajo pretendoi se nuk rezulton ndonjë rast kur ajo të mos ketë identifikuar dispozitat materiale. Në lidhje me vendimin

¹¹²Vendim nr. 102, datë 18.03.2019, Vvndim nr. 224, datë 19.07.2017, vendim nr. 90, datë 16.04.2018, Vendim nr. 247, datë 25.09.2017

¹¹³ Vendimi nr. 247, datë 25.09.2017, vendimi nr. 90, datë 16.04.2018, vendimi nr. 102, datë 18.03.2019, vendim nr. 224, datë 19.07.2017

¹¹⁴Elementët e parimit të procesit të rregullt ligjor rezultojnë nga konteksti i arsytimit dhe posaçërisht ecuria procedurale në të gjitha çështjet penale burim vlerësimi.

¹¹⁵ Vendimi nr. 135, datë 07.03.2018, vendim nr. 32, datë 04.12.2017

¹¹⁶ Vendimi nr. 212, datë 12.04.2018, vendimi nr. 688, datë 31.10.2019, vendimi nr. 469, datë 17.07.2018

¹¹⁷ Vendim nr. 256, datë 25.04.2017, vendim nr. 220, datë 07.04.2017 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë

¹¹⁸Vendimet civile burim vlerësimi.

nr.52, datë 07.02.2018 ka parashtruar se e ka çmuar të panevojshëm të citonte të gjitha dispozitat e ligjit të posaçëm, e cila ka ndodhur për shkak të vendimarrjes përfundimtare dhe arsytimi kryesisht është lidhur me aspektet procedurale dhe nuk lidhej me dispozitat specifike të ligjit të posaçëm. Ndërsa në vendimin nr.220, datë 07.04.2017, ajo ka arsyetuar se kur ka filluar ndërprerja e parashkrimit dhe se nuk ka pasur asnjë arsye për të arsyetuar për rastet se kur parashkrimi nuk quhet i ndërprerë dhe se ky pretendim është ngritur në prapsim nga pala e paditur, duke pretenduar vetëm se është parashkruar, pa e trajtuar më tej këtë prapsim. Në këto kundërshtime, gjyqtarja ka paraqitur edhe pjesë të arsytimit të vendimeve burim vlerësimi, të cilat janë administruar dhe janë përshkruar gjerësisht në Raportin Analitik dhe në projektraportin e vlerësimit. Gjithashtu, ajo pretendoi se përfundimi i arritur se aftësia e saj për këtë tregues është “mbi mesataren” nuk janë në unitet me analizën e bërë në përmbajtje të projektraportit lidhur me atë çka rezulton nga burimet e vlerësimit, duke cituar pjesë të projektraportit të vlerësimit, të sipërmendur dhe në vijim pretendon se konkluzioni i arritur nga relatorja nuk është argumentuar, duke e bërë të vështirë edhe konkluzionin e arritur prej saj. Dhe në përfundim ajo ka pretenduar se burimet e vlerësimit në të cilat janë konstatuar mangësi nga relatorja lidhur me këtë tregues tregojnë të kundërtët e konkluzionit të arritur dhe për këtë arsye kërkon që shkalla e aftësisë së saj për këtë tregues duhet të vlerësohet “shumë e lartë”. Nga ana e gjyqtarës nuk u paraqit asnjë provë për të provuar aludimin e saj se është trajtuar në mënyrë të jo të barabartë nga vlerësimet e kryera më parë nga Këshilli.

Këshilli pasi mori në analizë dhe kundërshtimet e paraqitura nga gjyqtarja, e cila ka kërkuar një analizë tjetër të burimeve të vlerësimit, vlerësoi se këto pretendime ishin tërësisht të pambështetura, duke konkluduar se vlerësimi i gjyqtarës për këtë tregues është bërë në përputhje me metodologjinë e pikëzimit të miratura nga Këshilli, me vendimin nr.264, datë 21.11.2019, që është pjesë përbërëse e skemës së vlerësimit.

Për pikëzimin e këtij treguesi në Metodologjia e Pikëzimit është parashikuar se:” Për të pikëzuar aftësinë e gjyqtarit për të interpretuar ligjin, vlerësuesi përqendrohet në dokumentet ligjore të dorëzuara nga gjyqtari, formularin e vetëvlerësimit, si dhe në aktet e dosjeve të përzgjedhura me short, në të cilat vlerësohet aftësia e gjyqtarit për të interpretuar ligjin e identifikuar dhe arsytimi i tij për mënyrën e zbatimit të ligjit mbi faktet objekt gjykimi. Vetëm referimi formal i ligjit, i pashoqëruar me një analizë të dispozitave, raportit midis tyre dhe zbatimit mbi rrethanat e faktit, sipas rastit, mund të jetë tregues i një mungese të aftësive për të interpretuar ligjin. Vlerësohet gjithashtu aftësia e gjyqtarit për të zbatuar parimet e përgjithshme të së drejtës materiale e procedurale që kanë lidhje me interpretimin e ligjit në zgjidhjen e çështjes, pavarësisht përmendjes së tyre shprehimisht në vendim.

Brenda këtij treguesi vlerësohet gjithashtu aftësia e gjyqtarit për të analizuar jurisprudencën, duke u përqendruar tek aftësia për të kërkuar, identifikuar, organizuar dhe përdorur jurisprudencën relevante për një çështje të caktuar. Vlerësohet sa dhe si gjyqtari identifikon praktikën gjyqësore vendase dhe atë ndërkombëtare, në mbështetje të një vendimi ose interpretimi të caktuar, si përdor dhe krahason burime jurisprudenciale nga sistemi ligjor vendas dhe nga sisteme të tjera. Në veçanti, vlerësohet nëse gjyqtari i referohet dhe menaxhon me efikasitet, në vendin e duhur dhe sipas llojit të qëllimit të aktit: praktikën e konsoliduar gjyqësore; praktikën e unifikuar/njësuar të Gjykatës së Lartë; praktikën gjyqësore të Gjykatës Kushtetuese; GJEDNJ-së dhe të gjithë jurisprudencën, edhe në rastet kur ajo nuk përbën burim të së drejtës, por i shërben interpretimit të ligjit në kuadër të përafrimit të legjislacionit.”

Këshilli, ashtu siç është arsyetuar më lart, vlerëson se gjyqtarja përqendrohet me shumë në analizën abstrakte të dispozitave, si dhe referimin e praktikës gjyqësore të Gjykatës së Lartë, Gjykatës Kushtetuese por edhe GJEDNJ, që përbën pjesën dominuese të arsytimit, pa i kushtuar rëndësinë e duhur zërthimin e normën në raport me faktet e çështjes.

KONKLUZIONI

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtarja ka aftësi shumë të mira në interpretimin e ligjit procedural në funksion të vlerësimit të çështjeve me karakter procedural apo kur ato shërbejnë për zgjidhjen përfundimtare të çështjes, por jo gjithmonë shfaq të njëjtën aftësi në interpretimin e ligjit material, sidomos në çështjet civile, në funksion të vlerësimit të çështjeve që shërbejnë për zgjidhjen përfundimtare të çështjes. Dispozitat e ligjit material përgjithësisht rezultojnë të jenë referuar dhe interpretuar në mënyrë konsistente, duke i zërthyer paraprakisht në elementë përbërës të tyre, duke identifikuar qëllimin dhe funksionin e dispozitës, por nuk i kushtohet e njëjta rëndësi aplikimit të saj mbi faktet e çështjes konkrete. Evidentohet një kujdesi i gjyqtarës për të identifikuar dhe zbatuar praktikën relevante gjyqësore unifikuese, praktikën gjyqësore të Gjykatës së Lartë, të Gjykatës Kushtetuese dhe të GJEDNJ, si dhe për të referuar dhe zbatuar parimet e së drejtës, si në aspektin procedural, ashtu edhe atë thelbësor.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, vlerësohet se aftësia e gjyqtarës në lidhje me treguesin “Aftësia për të interpretuar ligjin në zgjidhjen e çështjes”, është “Mbi mesataren” dhe pikëzohet me 20 pikë.

1.B ARSYETIMI LIGJOR

1.B.a Qartësia, konciziteti dhe kuptueshmëria e vendimit.

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik, rezulton se gjuha e përdorur nga gjyqtarja gjatë gjykimit, në aktet procedurale të dosjeve të analizuar, në komunikimin shkresor me të tretët dhe në vendimet gjyqësore, është e qartë, e drejtpërdrejtë dhe e kuptueshme.

Në përdorimin e instituteve të së drejtës apo parimeve të përgjithshme të së drejtës procedurale dhe materiale, evidentohet përdorimi i termave/shprehjeve në gjuhën latine, përgjithësisht të etiketuara (në thonjëza), duke u shoqëruar me dhënien e kuptimit të termit/shprehjes përkatëse, pa krijuar konfuzion për përmbajtjen apo kuptimin e tyre¹¹⁹. Në referimin e fjalëve me karakter teknik, kryesisht në referimin e konkluzioneve të akteve të ekspertimit apo në kuadër të referimit të ligjeve të posaçme, përdorimi i termave teknike është i kufizuar, i shoqëruar me shpjegimin e tij ose kuptohet qartë nga konteksti i arsytimit.

¹¹⁹ Evidentohet përdorimi i termave latinë si : sui generis, id quod plerum que acidit, iura novit curia, de jure, strictu sensu etj.

Nuk evidentohet në asnjë rast përdorimi i fjalëve apo shprehjeve që mund cenojnë integritetin e personit, si dhe evidentohet kujdes për shmangien absolute të përdorimit të fjalëve të cilat mund të krijojnë kontekst fyës apo denigrues. Në vendimet gjyqësore për çështjet familjare (*me objekt zgjidhje martesë*), evidentohet kujdesi i gjyqtarës për zgjedhjen e gjuhës së përdorur, pavarësisht mënyrës së formulimit të tyre nga palët, në respektim të parimit të interesit më të lartë të fëmijës dhe të drejtës për jetë private dhe familjare të subjekteve të procedimit.¹²⁰

Në arsyetimin e vendimeve evidentohet zbatimi i rregullave gramatikore, të sintaksës në ndërtimin e fjalive, duke i dhënë qartësi përshkrimit të rrethanave procedurale dhe fakteve të çështjes, apo shprehjes së mendimit juridik. Në të gjitha vendimet gjyqësore rezultojnë përdorimi i të gjitha shkronjave të alfabetit shqip (*ë dhe ç*). Fjalitë ndërtohen drejt dhe janë të organizuara në rrjedhë logjike të njëra-tjetrës, dhe paragrafët apo nënndarjet e arsyetimit të vendimit gjithashtu. Nuk rezultojnë të jenë përdorur terma apo fjalë që krijojnë paqartësi, në lidhje me kuptimin e tyre apo të kontekstit në të cilin përdoren.

Gjyqtarja përdor fjali me gjatësi mesatare dhe në disa raste edhe fjali më të gjata, si pasojë e vazhdimësisë së mendimit juridik të shprehur, por kjo nuk krijon paqartësi, pasi në çdo rast rezultojnë se mendimi është shprehur në mënyrë të thjeshtë dhe të kuptueshme, duke organizuar fjalitë dhe nënndarjet e arsyetimit të vendimit, në rrjedhë logjike të njëra-tjetrës. Vendimet në përgjithësi janë të organizuara në nënndarje, të identifikuar në shumicën e vendimeve me tituj, duke orientuar qartë për përmbajtjen e tyre, të cilët lidhen me njëri-tjetrin në mënyrë kronologjike dhe vazhdimësisë së mendimit. Karakteristike e gjyqtarës është përmbyllja e arsyetimit në secilin paragraf apo pjesë të vendimit më një ose disa fjali përmbyllëse, që vijnë si rrjedhë logjike e mendimit të shprehur dhe përbëjnë konkluzionin e arritur mbi elementin konkret të marrë në analizë.

Në disa nga vendimet e analizuara evidentohet vendosja e plotë e tekstit të dispozitave ligjore të zbatueshme¹²¹, por duke vijuar në pjesën e argumentimit ligjor me zberthimin dhe analizën e tyre por kjo nuk cenon koncizitetin e vendimit dhe duket së është përdorur gjithnjë me qëllim analizën e dispozitave në pjesën vijuese të arsyetimit.

KONKLUZIONI

Në tërësi, referuar burimeve të vlerësimit për këtë tregues, rezultojnë se gjyqtarja i kushton rëndësi të posaçme arsyetimit të vendimeve në drejtim të qartësisë dhe kuptueshmërisë për lexuesin. E njëjta rëndësi evidentohet edhe në drejtim të koncizitetit të pjesës përshkruese, në çdo nënndarje të saj, duke i dhënë peshën e nevojshme në arsyetim çdo pjese të vendimit, sipas përmbajtjes.

¹²⁰ Vendimi nr. 212, datë 12.04.2018, vendimi nr. 1150, datë 11.12.2019, vendimi nr. 881, datë 03.10.2019 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë

¹²¹ Në të gjitha vendimet e analizuara që përmbajnë pjesën “Ligji i zbatueshëm” citohet i plotë teksti i dispozitës

Shkalla e aftësisë së gjyqtarës dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, vlerësohet se shkalla e aftësisë së gjyqtarës në lidhje me treguesin “Qartësia, konciziteti dhe kuptueshmëria e vendimit” është “shumë e lartë”, dhe pikëzohet me 15 pikë.

1.B.b Struktura e qëndrueshme dhe e mirë organizuar e vendimit.

Organizimi i arsytimit ligjor duhet të përcaktojë nëse lexuesi i saj do ta kuptojë dhe të bindet nga argumentet e përdorura nga gjyqtari. Nëse gjyqtari në dhënien e argumenteve ligjore nuk do të ndjekë një strukturë të qartë, shumë nga pikat kyçe të vendimit mund të humbasin, apo mund të mos kuptohen drejt. Në këtë kontekst, është thelbësore që arsytimi të ndjekë një format të qartë organizimi, në funksion të orientimit të lexuesit dhe të kuptueshmërisë së përmbajtjes së vendimit gjyqësor. Edhe pse nuk ka një unifikim në lidhje me mënyrën e strukturimit të një vendimi gjyqësor, e për pasojë i jep një liri gjyqtarit në strukturimin e tij, nga ana tjetër, referuar rregullave të shkrimit dhe arsytimit ligjor, shkrimi ligjor ka strukturën e tij specifike, që juristës/ gjyqtarët duhet ta përdorin në një formë apo në një tjetër, dhe pavarësisht nëse ndiqet metoda IRAC (*Issue, Rule, Application, Conclusion*), CRAC (*Conclusion, Rule, Application, Conclusion*) etj, të gjitha këto metoda duhet të jenë në funksion të argumentimit ligjor të përdorur nga gjyqtari në zgjidhjen e çështjes, duke shtruar çështjen/ pyetjen për zgjidhje, normën relevante që duhet të zbatohet për zgjidhjen e saj, analizën e fakteve përkatëse në lidhje me çështjen e shtruar për zgjidhje dhe konkluzionin e arritur.

Nga analiza e burimeve të vlerësimit për këtë tregues rezulton se :

Gjyqtarja ndjek në hartimin e vendimit një strukturë të qëndrueshme dhe të organizuar nga pikpamja formale, të cilës i përmbahet në prezantimin e fakteve me natyrë procedurale apo të themelit të çështjes, identifikimit të ligjit të zbatueshëm, argumentimin ligjor dhe lidhjes së tyre me konkluzionet e arritura. Këto të fundit vijnë gjithnjë si mbyllje e procesit të arsytimit ligjor dhe argumentimit logjik. Gjyqtarja ndjek përgjithësisht një metodologji të njëjtë të strukturimit të pjesëve përbërëse të vendimit, duke ndarë pjesën përshkruese-arsyetuese në nënndarje, të identifikuar me tituj, në funksion të orientimit mbi qëllimin e secilës pjesë, por këto pjesë në shumicën e rasteve nuk janë ndarë në paragrafë, të cilat do ta lehtësonin të kuptuarit e vendimit. Në pjesën më të madhe të vendimeve, arsytimi paraqitet si një i tërë (pa paragrafë), sidomos tek pjesa që gjejnë pasqyrim rrethanat e faktet dhe pretendimet e palëve, të cilat e bëjnë jo gjithmonë të lehtë kuptimin e tij. Vendimet gjyqësore burim vlerësimi përmbajnë pjesën hyrëse, pjesën përshkruese-arsyetuese, si dhe dispozitivin e vendimit.

Në pjesën hyrëse gjejnë pasqyrim të dhënat e regjistrimit e çështjes, trupi gjykues dhe sekretarja gjyqësore, data dhe ora e shqyrtimit, palët, përfaqësuesit e tyre, prezenca ose mungesa e tyre në seancë, objekti i shqyrtimit (*padisë ose kërkesës në çështjet civile dhe akuza ose objekti i kërkesës në çështjet penale*), si dhe kërkimet përfundimtare të palëve, të paraqitura në mënyrë të përmbledhur.

Pjesa përshkuese-arsyetuese është e ndarë në disa pjesë, të cilat kryesisht janë të identifikuar me tituj, duke orientuar lexuesin për përmbajtjen e secilës pjesë të vendimit. Mënyra e organizimit të pjesës përshkuese-arsyetuese të vendimeve burim vlerësimin ndjek kryesisht këtë renditje:

- (i) *procedura*, duke u ndalur kryesisht në ecurinë procedurale të çështjes si dhe në aspekte që lidhen me të drejtat e palëve, njoftimin dhe pjesëmarrjen e tyre në gjykim, analizën dhe vlerësimin kryesisht të gjykatës lidhur me çështje të juridiksionit, kompetencës, etj. Në këtë pjesë, në vendimet penale të themelit, ndryshe nga ato të seancës paraprake, është pozicionuar nën titullin “rrethanat e faktit”, evidentohen edhe vendimmarrjet e ndërmjetme të gjykatës gjatë procesit si p.sh. në rastin e shqyrtimit të kërkesës për procedim me gjykim të shkurtuar në çështjet penale të themelit, etj, që në disa raste paraqitet teje e zgjeruar. Në çështjet civile, përveç tre rasteve, nuk rezulton të ketë një pjesë të ndarë të arsytimit për elementët proceduralë pasi ato janë bërë pjesë e analizës ligjore tërësore, pas pasqyrimin të fakteve të çështjes. Në tre vendimet civile të referuar rezulton që në pjesën hyrëse të jenë analizuar më vete elementët procedurale lidhur me kompetencën, juridiksionin, përbërjen e gjykatës, thirrjen e palës së interesuar (Avokatura e Shtetit) në gjykim¹²², analizën lidhur me mjetin procedural nepërmjet të cilit është investuar gjykata, legjitimitetin e palëve¹²³, me pasojë pushimin e gjykimit.
- (ii) *Rrethanat e faktit së bashku me përshkrimin dhe analizën e provave* të lejuara dhe administruara në gjykim, të analizuar në raport me njëra tjetrën, duke konkluduar për faktin e provuar si deduksion i analizës së provave. Faktet e çështjes analizohen në pjesën e dytë ose të parë të vendimit, duke integruar dhe analizuar provat e marra dhe duke u ndalur herë pas herë në vlerën provuese të tyre. Gjyqtarja i kushton rendësi kësaj pjese të arsytimit të vendimit, duke i paraqitur faktet e çështjes përgjithësisht në mënyrë korrekte edhe koncize, duke i dhënë qartësi faktit penal apo civil objekt gjykimi. Por konstatohet se ajo përgjithësisht nuk arrin të ndajë/strukturojë përshkrimin e fakteve të çështjes si dhe mendimin e saj juridik në analizimin e çështjes në paragrafë, duke e bërë vendimin në këtë pjesë jo lehtësisht të kuptueshëm. Gjithashtu, konstatohet se në këtë pjesë në disa raste është përfshirë dhe procedura që ka ndjekur padie deri në momentin që ajo është marrë në shqyrtim nga kjo gjykatë, pjesë që nuk ka lidhje me faktet e çështjes. Pretendimet e palëve¹²⁴ janë pasqyruar edhe në këtë pjesë të vendimit, por edhe në atë pjesë të arsytimit të vendimit ku janë marrë në analizë lidhur me bazueshmërinë e tyre, por edhe këto jo të strukturuar në paragrafë, duke ardhur si një e tërë me përshkrimin e fakteve të çështjes apo analizës juridike.
- (iii) *Ligji i zbatueshëm*. Në shumicën e vendimeve burim vlerësimi, ligji i zbatueshëm, si ai më natyrë procedurale ashtu edhe dispozitat e ligjit material të zbatueshëm, janë pjesë e integruar e analizës ligjore të gjykatës, duke u lokalizuar krahas argumenteve të gjykatës lidhur me elementë të zbatimit të tij. Thuajse në të gjitha vendimet gjyqësore burim vlerësimi, ligji i zbatueshëm evidentohet nëpërmjet listimit dhe citimit të përmbajtjes së dispozitave, në një nënndarje të veçantë, para analizës ligjore të çështjes. Por në disa vendime, mungon evidentimi i qartë dhe i plotë i ligjit të zbatueshëm, duke i mjaftuar vetëm me citimin e ligjit të posaçëm, pa cituar dispozitat konkrete që gjejnë zbatim¹²⁵.
- (iv) *Vlerësimi i gjykatë* lidhur me çështjen. Pas evidentimit dhe analizës së elementëve procedurale, fakteve të çështjes dhe referimit të ligjit të zbatueshëm, arsytimi vijon me një nënndarje të titulluar “vlerësimi i gjykatës”, në të cilin, sipas kategorisë së vendimeve

¹²² Vendimi nr. 52, datë 07.02.2018 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë

¹²³ Vendimi nr. 578, datë 25.09.2018, vendim nr. 313, datë 14.05.2019 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë

¹²⁴ Për më tepër lexo në faqen 8 të këtij raporti

¹²⁵ Vendimi nr.52, datë 07.02.2018 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë.

gjqqtarja zhvillon analizën ligjore të çështjes. Kjo analizë, referuar kompleksitetit të çështjes është e organizuar në disa rasteve në nënndarje, ku merren në analizë secili nga kërkimet e objektit të padisë, apo analizën lidhur me përgjegjësinë penale për secilin të pandehur apo vepër për të cilën procedohet, në vendimet penale. Por edhe në këtë pjesë në disa raste konstatohet se mendimi juridik nuk është i ndarë në paragrafë, që të mundësojë një kuptim të qartë të analizës juridike, apo në disa raste kur është ndarë, paraqitet në paragrafë të gjatë. Në *vendimet penale të themelit* gjyqtarja e ka organizuar këtë pjesë të vendimit duke analizuar fillimisht elementët e figurës së veprës penale për secilin të pandehur për të vijuar me pas me analizën ligjore në drejtim të caktimit dhe individualizimit të dënimit¹²⁶. Në *vendimet civile themeli dhe familjare* burim vlerësimi, në një pjesë të tyre, gjyqtarja e organizon pjesën e analizës ligjore duke marrë në vlerësim, në mënyrë të veçantë secilin kërkim objekt padie, apo secilin elementët që ajo vlerëson të nevojshme për t'iu nënshtruar analizës ligjore si p.sh lidhur me kërkesën për zgjidhjen e martesës, pasoja e zgjidhjes së martesës ndërmjet bashkëshortëve, pasojat e zgjidhjes së martesës tek fëmijët (lënia për rritje dhe edukim, detyrimi ushqimor), përcaktimi i mënyrës së ushtrimit të së drejtës së ankimit¹²⁷; lidhur me elementët e shkaktimit të dëmit¹²⁸, rastet e pavlefshmërisë së një titulli ekzekutiv, vendim gjyqësor të formës së prerë, natyrën juridike të gjykimit me objekt pavlefshmërinë e titullit ekzekutiv dhe të kundërshtimit të veprimeve përmbartimore. Pjesë e analizës ligjore, në përmbajtje apo në përfundim të argumentimit të saj lidhur me zgjidhjen e çështjes, janë edhe pretendimet e palëve të cilat merren në analizë lidhur edhe me faktet e provuara apo edhe më vete¹²⁹. Në tërësi, gjyqtarja organizon pjesën e arsytimit ligjor të vendimit duke ndjekur kryesisht metodën e dhënies së konkluzionit të saj mbi bazueshmërinë ose jo të kërkimeve objekt padie, për të vijuar më pas me shtjellimin dhe renditjen e argumenteve në mbështetje të këtij konkluzioni. Ndërkohë në çështjet penale, analiza ligjore organizohet duke filluar me referimin e ligjit material të zbatueshëm, zberthimin dhe analizën e elementëve të figurës së veprës penale konkrete dhe përqasjen e tyre me faktin penal të provuar në gjykim, për të vijuar me konkluzionin mbi ekzistencën e veprës penale dhe fajësinë e të pandehurit dhe më tej, me analizën në një pjesë më vetë, lidhur me përcaktimin e llojit dhe të masës së dënimit. Në përfundim të analizës ligjore në tërësi, ose në lidhje me secilën çështje të shtruar për vlerësim apo kërkesë të objektit të padisë, gjyqtarja konkludon lidhur me çështjen, duke e paraqitur këtë pjesë, si sintezë të analizës ligjore të kryer.

Në pjesën e dispozitivit gjen pasqyrim disponimi i gjykatës, data e shpalljes së vendimit dhe nënshkrimi i gjyqtarës dhe sekretarës gjyqësore. Konstatohet se dispozitivi i vendimeve është i plotë dhe në të gjejmë pasqyrim: disponimi i gjykatës mbi : (i) çdo kërkim të objektit të padisë apo kërkesës (*pranimin apo rrëzimin e kërkesë padisë*), (ii) përgjegjësinë penale të të pandehurit mbi akuzën që i atribuohet (*deklarimin fajtor apo të pafajshëm*), apo mënyrën e disponimit në çështjet specifike të seancës paraprake (*dërgimin në gjyq apo pushimin e procedimit penal*), (iii) dënimin dhe masën e dënimit, (iv) llogaritjen e dënimit, (v) mënyrën e ekzekutimit të tij, (vi) disponimi mbi provat materiale, (vii) masat e sigurimit si dhe (viii) shpenzimet gjyqësore. Gjithashtu, në të gjitha vendimet objekt vlerësimi pasqyrohet e drejta e ankimit dhe afati i ushtrimit të saj.

¹²⁶ Vendimet penale të themelit

¹²⁷ Vendimi nr. 212, datë 12.04.2018, vendimi nr. 688, datë 31.10.2019, vendimi nr. 469, datë 17.07.2018 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësore Lezhë

¹²⁸ Vendim nr. 256, datë 25.04.2017, vendim nr. 220, datë 07.04.2017 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësore Lezhë

¹²⁹ Vendimet civile dhe familjare burim vlerësimi

Vendimet gjyqësore përmbajnë të gjithë elementët e parashikuar në ligjin procedural penal ose civil, referuar natyrës së tyre ose kategorisë së çështjes, dhe konkretisht elementët e përcaktuar në: (i) nenin 310 të K.Pr.Civile, në vendimet civile dhe familjare, (ii) nenet 332/ç, 332/dh dhe 332/e dhe nenin 329/b të K.Pr.Penale, në vendimet e seancës paraprake për dërgimin e çështjes në gjyq apo pushimin e procedimit penal, (iii) nenin 383 të K.Pr.Penale, në vendimet penale themelit, etj.

Siç u theksua më lartë, gjyqtarja ndjek rregulla të qarta në strukturimin e vendimit gjyqësor, kjo sikundër e cituam edhe më sipër, duke i ndarë vendimet në pjesë, ku gjyqtarja zbaton rregullat e shkrimit ligjor, duke identifikuar faktet, provat, argumentin ligjor në lidhje me faktet, ligjin e zbatueshëm, analizën juridike dhe konkluzionin e arritur.

Megjithatë titujt e nëndarjeve të vendimit gjyqësor (*procedura, rrethanat e faktit, ligji i zbatueshëm, vlerësimi i gjykatës*) nuk janë të vetme mjete të majftueshme për organizimin e argumentit logjik. Janë paragrafët ata që e organizojnë shkrimin sipas ideve dhe lehtësojnë të kuptuarit e mendimit, duke e ndarë atë në njësi më të thjeshta, paragrafë të cilat duhen rënditur në atë mënyrë që mendimi të vijë rrjedhshëm, njëri pas tjetrit.

Edhe për këtë tregues, gjyqtarja ka paraqitur kundërshtime dhe ka kërkuar pikëzimin me 10 pikë, duke mos qenë dakord me konkluzionin e arritur nga relatorja. Konkretisht ajo pretendoi se çdo vendim i saj është ndarë në pjesë të veçanta (*procedura, faktet dhe pretendimet e palëve, ligji i zbatueshëm dhe vlerësimi i gjykatës*) dhe mosndarja e vendimit në paragrafë të shumtë nuk e bën atë të pakuptueshëm. Ndarja e vendimit gjyqësor në paragrafë, pavarësisht nëse këto paragrafë nga pikpamja vizuale janë të numërtuara apo të ndarë në hapësira (space), është evidente dhe konfigurohet qartë në filimin e fjalisë së re, në kryeradhë, pavarësisht se nuk është përdorur nga pikpamja teknike hapësira (space) nga njëri paragraf tek tjetri. Gjyqtarja pretendoi se ndarja e arsytimit të vendimit në paragrafë, e cila është e pashmangshme sa herë përfundon një argument dhe fillon një i dytë, në vijim të tij, dhe është evidente në vendimet gjyqësore, por se në rastin e saj është përdorur kalimi në fjali të re (kryeradhë) dhe jo në çdo rat hapësira më shkrim. Kjo mënyrë e të shkruarit nuk ka asnjë ndikim në shtrukturën e mirëorganizuar dhe të qendrueshme të vendimit e cila konsiston në aspektin logjik të organizimit të mendimit dhe jo në aspektin vizual.

Këshilli pasi mori në shqyrtim dhe kundërshtimet e paraqitura nga gjyqtarja, vendosi të miratojë pa ndryshime projektraportin e vlerësimit edhe për këtë tregues, duke vlerësuar kështu se aftësia e gjyqtares për këtë tregues është “Mbi mesataren”. Këshilli ka konkluduar se vendimet gjyqësore burim vlerësimi, të administruara gjatë procedurës së vlerësimit janë të ndarë në pjesë, të përshkruara në raport, por këto nëndarje nuk janë të vetmet njësi ndarëse që e bëjnë vendimin lehtësisht të kuptueshëm. Mendimi juridik që të jetë lehtësisht i kuptueshëm, duhet të ketë nëndarje më të vogla, siç janë paragrafët e vendimit, të cilët shfaqin një mendim të caktuar dhe duhet të vijnë njëri pas tjetrit në rrjedhë logjike. Ekzistenca ose jo e ndarjeve të vendimit në nëntituj, apo në nëndarje më të vogla siç janë paragrafët nuk e bëjnë gjithmonë vendimin e pakuptueshëm, por e vështirësojnë kuptimin e tij.

Nga burimet vlerësimit është konstatuar se gjyqtarja e strukturon vendimin gjyqësor në pjesë të ndryshme, të ndarë me nëntituj, por jo gjithmonë e strukturon këto pjesë në nëndarje më të

vogla siç janë paragrafët, duke u paraqitur në disa raste pjesët e vendimit si një e tërë, me fjali që vijnë njëra pas tjetrës, të pandarë në kryeradhë.

KONKLUZIONI

Në tërësi, referuar burimeve të vlerësimit për këtë tregues, evidentohet se gjyqtarja ka aftësi të mbi mesataren në ndjekjen e një strukture të organizuar të vendimit, të ndarë në tituj, por jo gjithmonë mendimi është ndarë në paragrafë, duke u paraqitur çdo pjesë e vendimit si një i tërë. Gjyqtarja ndjek përgjithësisht një strukturë sipas këtij rendi: trajtimi i aspekteve procedurale të ngritura gjatë gjykimit apo të vlerësuar kryesisht nga gjykata, parashtrimi i rrethanave të faktit, pretendimet e palëve ndërgjyqëse, të cilat janë pjesë e rrethanave të faktit, ndonjëherë të pandarë në paragrafë, ligjin e zbatueshëm, trajtimi i çështjeve që duhet të shqyrtohen nga gjykata në lidhje me themelin, duke përfshirë analizën e pretendimeve të palëve dhe në fund të pjesës arsyetuese ose të çdo pjesë të veçantë të tij, përfundimet e arritura nga gjykata. Në përgjithësi konstatohet që për çdo nënndarje apo njësi e vendimit të jenë vendosur titujt përkatës dhe fjali tematike, për orientimin e duhur të palëve dhe gjykatave më të larta mbi përmbajtjen e vendimit si dhe në shërbim të qartësisë dhe kuptueshmërisë së tij duke mundësuar përgjithësisht lexim të organizuar dhe të strukturuar në rrjedhë logjike.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtarës në treguesin “Struktura e qëndrueshme dhe e mirë organizuar e vendimit”, vlerësohet “ mbi mesatare” dhe pikëzohet me 8 pikë.

1.B.c Cilësia e analizës dhe argumentimit logjik.

Vendimet duhet të arsyetohen, përndryshe janë të pavlefshme dhe arsyetimi i vendimit duhet të tregojë, zgjidhjet e të gjitha çështjeve procedurale dhe të thelbit/meritore, të së drejtës dhe të faktit, me të cilat është dashur të përballët gjyqtari, për të justifikuar vendimin e shprehur në dispozitiv. Konkluzioni i vërtetuar në dispozitivin e vendimit, duhet të arsyetohet, duke parashtruar procesin logjik, nëpërmjet të cilit është arritur tek bindja e formuar. GJEDNJ është shprehur se, megjithëse gjykatave i lejohet një liri e konsiderueshme veprimi, përsa i përket strukturës dhe përmbajtjes, ato janë të detyruara të shprehin me qartësinë e duhur arsyet mbi të cilat ato i mbështesin vendimet e tyre me qëllim që subjekti ta ushtrojë realisht të drejtën që ka për tu ankuar¹³⁰.

Nga analiza e burimeve të vlerësimit për këtë tregues rezulton se :

Në vendimet e analizuara, përgjithësisht rezultojnë një nivel shumë i mirë arsyetimi, duke shqyrtuar dhe argumentuar çdo element të nevojshëm të vlerësuar nga gjyqtarja në raport me faktin civil apo penal, si dhe çdo element të vlerësuar të nevojshëm për t’u analizuar në

¹³⁰ Vendimi I GJEDNJ, Çështja Dadjanastassion vs Greqisë, datë 16.12.1992, faqe 33.

raport me aspektet procedurale të gjykimit, kryesisht çështje të kompetencës lëndore; përcaktimit të barrës së provës dhe rolin e gjykatës në funksion të vlerësimit të shkakut ligjor të padisë; rolin dhe funksionin e gjyqtarit të seancës paraprake dhe kufijtë e shqyrtimit të çështjes në këtë fazë të procedimit; procedimit me gjykim të shkurtuar si dhe pjesëmarrjen dhe të drejtat e të dëmtuarit në gjykim, etj.

Arsyetimi i vendimeve përfundimtare, pas përcaktimit të fakteve të çështjes, zhvillohet mbi bazën e një analize juridike të koncepteve ligjore të parashikuara në ligjin procedural dhe material (civil apo penal), duke bërë një analizë tërësore dhe koncize të provave të administruara, në funksion të përcaktimit të qartë të fakteve të vlerësuara si të provuara në gjykim. Në pjesën më të madhe të vendimeve, konstatohet se gjyqtarja i kushton rëndësi identifikimit dhe analizës së koncepteve ligjore të së drejtës materiale ose procedurale në lidhje me konkluzionet e arritura për zgjidhjen e çështjes, duke bërë një analizë për qëllimin dhe funksionin përkatës të dispozitave, si dhe të zberthimit të kushteve apo elementëve të nevojshëm me qëllim që dispozita përkatëse të gjejnë zbatim në rastet konkrete në shërbim të konkluzioneve të arritura për zgjidhjen e çështjes. Por në disa vendime të tjera burim vlerësimi nuk rezulton e njëjta shkallë kujdesi në drejtim të zhvillimit të analizës ligjore dhe argumentit logjik, pasi analiza përqendrohet kryesisht në interpretimin abstrakt të dispozitave, duke e shoqëruar, thuajse gjithmonë me praktikën e unifikuar të Gjykatës së Lartë dhe të gjykatës së apelit, apo dhe të qëndrimeve të mbajtura nga Gjykata Kushtetuese, pa u analizuar në raport me faktet e provuara në funksion të mbështetjes së marrëdhiesh shkak- pasojë, e cila jo gjithmonë paraqitet e qartë.

Arsyetimi i vendimeve përgjithësisht është i qartë dhe gjithëpërfshirës, duke marrë në analizë dhe duke i dhënë përgjigje pretendimeve dhe kërtimeve të palëve ndërgjyqëse si dhe çështjeve të ngritura kryesisht për diskutim nga gjyqtarja.

Në vendimet civile burim vlerësimi gjyqtarja i kushton rëndësi analizës me të zgjeruar së instituteve dhe koncepteve të caktuara të së drejtës. kur kjo rezulton e nevojshme, duke qenë më e kufizuar në analizën e këtyre instituteve dhe koncepteve në raport me rrethanat konkrete të çështjes, p.sh:

- (i) institutit të zgjidhjes së martesës dhe përcaktimit të përgjegjësisë prindërore, duke analizuar martesën, shkaqet e zgjidhjes së saj, pasojat e zgjidhjes së martesës për bashkëshortët dhe fëmijët e mitur, duke u ndalur në këtë drejtim në pasojat në lidhje më mënyrën e ushtrimit të përgjegjësisë prindërore dhe ato me karakter material, analizë e cila mbështetet në çdo rast në parimin e interesit më të lartë të fëmijës¹³¹;
- (ii) institutit të pronës private, i parë nën dritën e procesit të kthimit dhe kompensimit të pronave ish pronarëve, duke analizuar vendimet e organeve administrative të cilat nuk mund të konsiderohen akte administrative në kuptimin e ngushtë të fjalës por tituj pronësie që nga momenti që marrin formën e prerë.¹³²
- (iii) Konceptin e dëmit pasuror jashtë kontraktor, duke analizuar elementët përbërës të tij që duhet të plotësohen me qëllim që të vlerësohet se jemi në rastet e shpërblimit të tij,

¹³¹ Vendimi nr. 212, datë 12.04.2018, vendimi nr. 688, datë 31.10.2019, vendimi nr. 469, datë 17.07.2018 Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë.

¹³² Vendimi nr.52, datë 07.02.2018 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë.

analizën e koncepteve ligjore në shërbim të arritjes së konkluzioneve në lidhje me zgjidhjen e çështjes¹³³

- (iv) Mjetet e mbrojtjes në fazën e ekzekutimit të titullit ekzekutiv, shkaqet e pavlefshmërisë të titullit ekzekutiv në rastet kur ai është vendim gjyqësor, ankimi kundër veprimeve të përmbauesit gjyqësor/ kundërshtimi i veprimeve përmbaimore, përcaktimin e interesit të ligjshëm të palëve në fazën e ekzekutimit për të kundërshtuar veprimet e përmbauesit¹³⁴.

Në vendimet penale burim vlerësimi, karakteristikë e gjyqtarës është paraqitja dhe analiza e detajuar e fakteve të cilat kanë rezultuar të provuara në gjykim dhe marrja në analizë e tyre në drejtim të ekzistencës së elementëve të figurës së veprës penale për të cilën procedohet, rolin dhe përgjegjësinë penale të të pandehurit në raport me faktin penal. Çdo fakt i vlerësuar si i provuar lidhet në mënyrë të drejtpërdrejtë provën/provat përkatëse, me aspektet ligjore konkrete të cilat ato mbështesin, si dhe elementin që sjell secila prej tyre në shërbim të provueshmërisë së tij. Gjyqtarja integron në mënyrë të natyrshme faktin e provuar me analizën dhe interpretimin e ligjit të zbatueshëm në rastin konkret, si në drejtim të kualifikimit ligjor të faktit penal, ashtu edhe në drejtim të vlerësimit të kushteve ligjore për zgjidhjen e çështjeve me karakter procedural.

Gjyqtarja ndalet në evidentimin e qartë dhe në mënyrë të natyrshme të lidhjes shkak-pasojë mes veprimeve të të pandehurit në raport me faktin penal të provuar në çështjet e themelit, faktin penal objekt akuze në çështje të seancës paraprake, apo në raport me faktin për të cilin kërkohet pushimi i procedimit penal. Në çdo rast interpretimi dhe analiza e integruar e normave ligjore procedurale dhe materiale, në raport me faktet e provuara në gjykim, i shërben arsyetimit ligjor dhe zhvillimit të argumentimin logjik, në mbështetje të konkluzioneve të saj për zgjidhjen e çështjes, kryesisht në drejtim të :

- (i) analizës së figurës konkrete të veprës penale për të cilën procedohet, zërthimin dhe analizën e elementëve e saj si dhe autorësisë e të pandehurit¹³⁵,
- (ii) institutin procedural të gjykimit të shkurtuar, duke analizuar në çdo rast kushtet procedurale për pranimin e tij së bashku me analizën dhe vlerësimin mbi kushtet thelbësore që vlerësohen për procedimin me këtë rit të posaçëm gjykimi¹³⁶;
- (iii) analizës lidhur me kushtet dhe kriteret ligjore të përcaktimi dhe individualizimit të dënimit, analizës lidhur me rrethanat rënduese dhe lehtësuese që ndikojnë për përcaktimin e dënimit si dhe aplikimin në këtë drejtim të parimeve mbi të cilat caktohet dënimi penal në funksion të arritjes së qëllimit të tij. Po ashtu gjyqtarja zhvillon analizën e kushteve ligjore të aplikimit të alternativave të dënimit me burgim duke u ndalur në analizën e qëllimit të aplikimit të tyre në raport me arritjen e qëllimit të dënimit penal apo zbatimin e parimit të caktimit të dënimit në mënyrë të drejtë dhe proporcionale¹³⁷;
- (iv) analizën e figurës së gjyqtarit të seancës paraprake, rolin e tij, qëllimin e kësaj fazë të procedimit dhe elementet që janë objekt kontrolli nga gjykata me qëllim përgatitjen e

¹³³ Vendimi nr. 220 datë vendimi 07.04.2017 dhe vendimin nr. 256 datë 25.04.2017 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë.

¹³⁴ Vendimi nr. 115 dt 02.03.2018 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë.

¹³⁵ Në të gjitha vendimet penale të themelit apo edhe ato të seancës paraprake me objekt dërgimin e çështjes në gjyq apo pushimin e procedimit penal, gjyqtarja ndalet në analizën e elementëve të figurës së veprës penale dhe përjashtjen e faktit të provuar në raport me to, në funksion të vlerësimit të saj mbi cilësimin juridik të faktit penal për të cilin procedohet.

¹³⁶ Vendimi nr. 247, datë 25.09.2017, vendimi nr. 90, datë 16.04.2018, vendimi nr. 102, datë 18.03.2019, vendim nr. 224, datë 19.07.2017 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë

¹³⁷ Në vendimet penale themeli.

çështjes për gjykim. Në kuadër të kësaj analizë gjyqarja ndalet dhe analizon dispozitat mbi pavlefshmërinë e akteve dhe papërdorshmërinë e provave, mjaftueshmërinë e provave dhe ligjshmërinë e marrjes së tyre, para aplikimit të tyre mbi faktin konkret dhe vlerësimin përfundimtar mbi çështjen¹³⁸

Sa i përket përmbajtjes gjithëpërfshirëse në lidhje me marrjen në shqyrtim të pretendimeve të palëve, në të gjitha vendimet burim vlerësimi rezultoi se ata janë pjesë e integruar e vendimit gjyqësor, duke u pozicionuar në atë pjesë të arsytimit me të cilën lidhet pretendimi (me aspektet procedurale të gjykimit, marrjen e provave dhe mënyrën e marrjes së tyre, provueshmërinë e faktit, cilësimin ligjor të faktit penal apo përcaktimin e natyrës së mosmarrëveshjes civile, etj.), duke u marrë në shqyrtim dhe analizuar në përmbajtje të arsytimit ligjor dhe në disa raste komplekse në një pjesë të veçuar të arsytimit (por në pjesën përkatëse të arsytimit që ka të bëjë pikërisht me pretendimin konkret). Pretendimet e palëve përgjithësisht kanë marrë një përgjigje të argumentuar, në aspektin e mbështetjes në ligj ose prova të tyre, duke u integruar në mënyrë të natyrshme si pjesë e arsytimit tërësor. Nuk konstatohet i njëjti kujdes i gjyqtarës tek çështjes civile, ku analiza e gjyqtarës lidhur me to ka qenë më i shkurtër duke mos dhënë gjithmonë një përgjigje të argumentuar ligjore mbi pretendimet e palëve në raport me faktet e çështjes.

Në disa vendime gjyqësore argumenti rrjedh nga konkluzioni i gjyqtarës i parashtruar në fillim të arsytimit, pas analizës së provave, për të vijuar hap pas hapi me shtjellimin e argumenteve në mbështetje të tij. Ndërkohë në vendimet e tjera burim vlerësimi nuk është ndjekur kjo mënyrë arsytimi por analiza dhe arritja e konkluzionit vjen pas analizës së ligjore të çështjes.

Lidhur me këtë tregues, gjyqarja ka paraqitur kundërshtime dhe ka kërkuar vlerësimin e aftësive të saj si “shumë të larta”. Konkretisht gjyqarja ka pretenduar se nuk ka asnjë rast se ajo të mos i ketë kushtuar rëndësi analizës ligjore dhe se nga ana e relatores nuk është cituar asnjë vendim konkret, duke pretenduar ndër të tjera se dhe projektraporti i hartuar nga relatorja ka mospërputhje midis analizës dhe konkluzionit të arritur, duke hedhur aludime mbi faktin se përse nuk është cituar ndonjë vendim konkret, duke e bërë të pabazë konkluzionin e arritur.

Këshilli, pasi mori në shqyrtim dhe kundërshtimet e paraqitura nga gjyqarja, vendosi të miratojë pa ndryshime projektraportin e vlerësimin edhe për këtë tregues, duke vlerësuar kështu se aftësia e gjyqtarës për këtë tregues është “Mbi mesataren”. Këshilli, referuar burimeve të vlerësimin (vendimet gjyqësore) ka konkluduar se cilësia e analizës është mbi mesataren, pasi ka konstatuar se gjyqarja nuk i kushton të njëjtën rëndësi analizës së koncepteve juridike, në raport me faktet e çështjes, duke i integruar ato me njëra -tjetrën për ta bërë më të qartë lidhjen shkak- pasojë . Konstatohet se përgjithësisht gjyqarja analizon koncepte, institute dhe dispozitat ligjore, por nuk i kushton të njëjtës rëndësi se si këto institute zbatohen në raport me rrethanat dhe faktet e provuara gjatë gjykimit. Është konstatuar se në disa vendime gjyqësore mbizotëron pasqyrimi i praktikës gjyqësore të gjykatës së lartë, për të përforcuar analizës e koncepteve por jo se si ato gjejnë zbatim në rastin konkret, duke e bërë që analiza ligjore e koncepteve dhe e dispozitave të jetë tepër e gjatë në raport me analizën juridike mbi faktet konkrete.

¹³⁸ Vendimi nr.414, datë 22.10.2019, vendim nr. 32, datë 04.12.2017 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë

Përsa i përket pretendimeve të gjyqtares për pasaktësi të raportin apo mosreferimin e vendimeve gjyqësore, apo referimin jo të drejtë të përmbajtjes së tij, Këshilli vlerësoi se këto pretendimeve janë të pabazuara. Në raportin e vlerësimit ashtu dhe në raportin analitik të vlerësimit, janë përshkruar në mënyrë të detajuar ato se çfarë janë konstatuar në vendimet burim vlerësimi, duke cituar edhe vendimet gjyqësore, mbi të cilave është arritur në një vlerësim të caktuar. Analiza përqendrohet në tërësi tek të gjitha vendimet gjyqësore burim vlerësimi, pa i dhënë rëndësi të veçantë një vendimi apo tjetrit.

Gjithashtu, pretendimi i gjyqtares se është konsideruar “gabim” pasqyrimi i pretendimeve të palëve si tek pjesa e përshkrimit të faktit ashtu edhe tek pjesa arsyetuese, është i pabazuar. Pasi po të lexosh me vëmendje Raportin për vlerësimin etik dhe profesional të gjyqtares, por edhe të gjyqtarëve të tjerë, për të cilën gjyqtarja pretendon se nuk është trajtuar në mënyrë të barabartë është cituar se “ *në të gjitha vendimet burim vlerësimi rezultoi se ata janë pjesë e integruar e vendimit gjyqësor, duke u pozicionuar në atë pjesë të arsyetimit me të cilën lidhet pretendimi (me aspektet procedurale të gjykimit, marrjen e provave dhe mënyrën e marrjes së tyre, provueshmërinë e faktit, cilësimin ligjor të faktit penal apo përcaktimin e natyrës së mosmarrëveshjes civile, etj.), duke u marrë në shqyrtim dhe analizuar në përmbajtje të arsyetimit ligjor dhe në disa raste komplekse në një pjesë të veçantë të arsyetimit (por në pjesën përkatëse të arsyetimit që ka të bëjë pikërisht me pretendimin konkret).*” Pra konstatohet qartë se pasqyrimi i pretendimeve të palëve në secilën pjesë ku ato merren në analizë është vlerësuar shumë pozitive.

KONKLUZIONI

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, duke i vlerësuar tërësinë e tyre në raport me natyrën e çështjeve, komplekse ose jo, rezulton se gjyqtarja ka aftësi mbi mesatare në lidhje me treguesin “*Cilësia e analizës dhe argumentit logjik*”. Konstatohet se vendimet gjyqësore burim vlerësimi, në varësit të kompleksitetit të çështjes dhe pretendimet e palëve, në pjesën analitike të tyre përmbajnë argumenta të lidhura me njëri-tjetrin, duke i ndalur tek evidentimi i lidhjes shkak- pasojë në raport me konkluzionet për zgjidhjen e çështjes. Gjyqtarja i kushton rëndësi analizimit të pretendimeve të palëve në raport me rrethanat konkrete të çështjes, duke i dhënë përgjigje të argumentuar si për çështjet e procedurës ashtu dhe ato për themelin e çështjes. Megjithatë, referuar burimeve të vlerësimit nuk evidentohet e njëjta shkallë kujdesi në drejtim të analizës dhe argumentit logjik, pasi elementi analitik në pjesën më të madhe të vendimit dominohet nga analiza abstrakte e dispozitave ligjore që gjejnë zbatim, duke u pasuruar me qëndrimet e praktikës gjyqësore dhe integrimin e parimeve të përgjithshme të së drejtës, dhe një pjesë me e vogël në përshkrimin dhe analiza e fakteve të çështjes, pa i ndërthurur këto të fundit me interpretimin e ligjit të zbatueshëm dhe më tej në dhënien e arsyeve për mënyrën e zbatimit të tij mbi faktet e çështjes. Përgjithësisht, arsyetimi i vendimeve është i qartë, i plotë dhe merr në analizë dhe i jep përgjigje të gjitha pretendimeve dhe kërkimeve të palëve apo çështjeve të shtruara për diskutim në aspektin procedural dhe thelbësor, me qëllim dhënien e një përgjigje të argumentuar në lidhje me mënyrën e zgjidhjes së çështjes por jo gjithmonë analiza është e plotë dhe e ndërthurur me interpretimin e ligjit në mënyrë të plotë me faktet e provuara.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtarës në treguesin “Cilësia e analizës dhe argumentimit logjik”, vlerësohet “Mbi mesataren” dhe pikëzohet me 20 pikë.

Niveli i vlerësimit	
AFTËSITË PROFESIONALE TË GJYQTARES	
Pikët	Niveli i vlerësimit
88	Shumë mirë

2. AFTËSITË ORGANIZATIVE TË GJYQTARIT

Për të vlerësuar dhe pikëzuar aftësinë e gjyqtarës në drejtim të aftësive organizative, vlerësuesi përqendrohet në aftësinë për të organizuar, menaxhuar dhe kontrolluar efektivisht procedurat gjyqësore. Produktiviteti është rrjedhojë e menaxhimit të kohës, i cili tregon sa mirë gjyqtari përdor kohën e tij si kur gjykon i vetëm ashtu edhe në panel me të tjerë.

2.A AFTËSIA E GJYQTARES PËR TË PËRBALLUAR NGARKESËN NË PUNË.

2.A.a Respektimi i afateve ligjore.

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik dhe tabelave me të dhëna statistikore për periudhën e vlerësimit, rezulton se gjyqtarja ka gjykuar gjithsej 744 çështje për të cilat ligji parashikon afat ligjor shqyrtimi, të cilat i përkasin kategorisë së çështjeve “Civile të përgjithshme me palë kundërshtare”, “Civile të përgjithshme pa palë kundërshtare”, “Familjare me palë kundërshtare”, “Kërkesa penale në fazën e hetimit paraprak” dhe “Penale seancë parapake”.

Sipas të dhënave të pasqyruara në Raportin Analitik, rezulton se nga 744 çështje për të cilat ligji parashikon afat gjykimi, 182 prej tyre janë shqyrtuar në tejkalim të këtij afati ndërsa 505 çështje janë shqyrtuar brenda afateve ligjore. Referuar raportit të çështjeve për të cilat vendimi është marrë në tejkalim të afatit ligjor (182 çështje), me numrin total të çështjeve të gjykuara për të cilat ligji parashikon afat gjykimi (744 çështje), gjyqtarja rezulton që të ketë gjykuar **24.4 % të çështjeve jashtë afatit ligjor.**

Në Formularin e Integruar të Vlerësimit gjyqtari parashtron, ndër të tjera, “Vazhdimisht jam përpjekur që të respektoj afatet ligjore brenda të cilës duhet të përfundojë gjykimi i një çështje, por njëkohësisht duke i dhënë përparësi edhe garantimit të të drejtave të palëve ndërgjyqëse si dhe kryerjes së një hetimi të plotë dhe të gjithanshëm, me qëllimin e vetëm zgjidhjen e drejtë të çështjes. Gjithashtu, dëshiroj të vë në dukje se seancat gjyqësore nuk janë

shtyrë për shkaqe që lidhen me mua si gjyqtare e çështjes, duke qenë gjithmonë e pranishme në punë dhe duke mos munguar pothuajse asnjë ditë. Tjetër fakt që dua të theksoj është se në shumë raste afati ka kaluar vetëm disa ditë...¹³⁹”.

Në përllogaritjen e afateve ligjore, për të gjitha dosjet, përllogaritja e afateve do të fillojë nga data e shortimit (pra, data kur çështja ka shkuar pranë gjyqtares), dhe jo ajo e regjistrimit. Në të gjitha dosjet, në përllogaritje do të zbriten:

- leja vjetore e muajit gusht prej 35 ditësh (ligji parashikon 25 ditë pune për gjyqtarët apo 35 ditë kalendarike).
- festat e fundvitit dhe afati i mbartjes së dosjeve .

Po ashtu, gjyqtarja ka shpjeguar lidhur me kohëzgjatjen e disa çështjeve, të cilat, referuar tabelave me të dhëna statistikore, në raport me shpjegimet e saj, rezulton si vijon:

(i) në çështjet me objekt « *kundërshtim veprimesh përmbaremore* », neni 610 K.Pr.C¹⁴⁰, parashikonte dhe vijon të parashikojë afatin 20 ditor të shqyrtimit, afati i cili është parashikuar që me ligjin nr.10 052, datë 29.12.2008, ndërsa në kundërshtim me sa pretendoi gjyqtarja, me ligjin nr.114/2016 ky paragrafi i III vetëm është riformuluar. Pra, çështjet me objekt “*Kundërshtim i veprimeve përmbaremore*”, që i përkasin periudhës së vlerësimit, pavarësisht se ata rezultojnë të regjistruara në vitin 2016, klasifikohen tek çështjet me afat ligjor. Referuar tabelave me të dhëna statistikore dhe konkretisht tabelës nr. 1, viti 2017, rezulton se : *çështja me numër rendor 9 (63/964)* ka kaluar pranë gjyqtares më datë 13.10.2016 dhe është pezulluar nga data 25.01.2017 deri me datë 11.09.2017 (për 7 muaj e 17 ditë), datë në të cilën është vendosur pushimi. Gjykimi ka zgjatur 3 muaj e 12 ditë, jashtë afatit 20 ditë të gjykimit të tyre sipas nenit 610 paragrafi i 3 i K.Pr.Civile; *çështja me numër rendor 22 (96/737)* ka kaluar pranë gjyqtares më datë 22.09.2016. Gjykimi ka zgjatur 4 muaj e 28 ditë, jashtë afatit 20 ditë të gjykimit. Kështu, këto dy çështje nuk do të hiqen nga numri i çështjeve të llogaritura me afat ligjor, pasi neni 610 i K.Pr.Civile që ka qenë në fuqi në momentin e gjykimit të tyre parashikonte afatin 20 ditore të gjykimit.

(ii) *çështja me numër rendor 38 (124/1164)* ka kaluar pranë gjyqtares më datë 27.12.2016 dhe është pezulluar nga data 25.01.2017 deri me datë 11.09.2017 (për 7 muaj e 17 ditë), datë në të cilën është vendosur pushimi (8 muaj e 18 ditë). Duke vlerësuar gjykimin deri në datën e marrjes së vendimit për pezullimin e gjykimit, çështja ka zgjatur 29 ditë, **jashtë afatit 20 ditore të gjykimit**, ndërsa çështja me nr. 58 (545) rezulton e gjykuar për 22 ditë, tejkalmimi prej 2 ditësh do të konsiderohet i papërfillshëm e për pasojë do të **konsiderohet si e përfunduar brenda afatit ligjor 20/ditor**.

(iii) Në çështjet me objekt « *lëshim urdhër ekzekutimi* » , neni 510 i K.Pr.C, para ndryshimeve me ligjin nr. 38/2017 (30.03.2017)¹⁴¹ parashikonte afatin 5/ditor të shqyrtimit. Referuar tabelave me të dhëna statistikore dhe konkretisht tabelës nr. 2, viti 2017, rezulton se :

¹³⁹Gjyqtari ka referuar shpjegimet si më sipër, paraqitur në mënyrë të përmblëdhur në këtë projekt raport, por që parashtrihen në mënyrë të detajuar në raportin analitik, faqe 39-42 të tij, duke referuar të dhëna për disa çështje konkrete të cilat analizohen më sipër.

¹⁴⁰ Neni 610, paragrafi i 3 i K.Pr.Civile, i shtuar dhe ndryshuar me ligjin **PI**.8812, datë 17.5.2001, neni 125; ndryshuar me ligjin nr.10 052, datë 29.12.2008, në kohën e ngritjes dhe përfundimit të vendimi parashikon se ; » *Ankimi shqyrtohet brenda 20 ditëve nga gjykata e vendit të ekzekutimit, e cila kur e sheh të nevojshme mund të thërrasë edhe palët*»

¹⁴¹ Ligji nr.38/2017, ka hyrë në fuqi me dt.05.11.2017 (gjashtë muaj pas botimit në fletoren zyrtare, i cili rezulton se është botuar në Fletoren Zyrtare nr.98, viti 2017, datë 05.05.2017).

çështjet me numër rendor 1(10), 2 (15), 3(22), 4(26), 5(29), 6(33), 7 (40) janë shortuar në datë 09.01.2017 dhe kanë përfunduar në datë 13.01.2017, pra brenda 5 ditëve; çështjet me numër rendor 8 (43), 9 (48) janë shortuar me datë 12.01.2017 dhe kanë përfunduar më datë 16.01.2017, pra brenda 5 ditëve; çështja me numër rendor 26 (128) është shortuar me datë 06.02.2017 dhe ka përfunduar me datë 10.02.2017, pra brenda 5 ditëve; çështja me numër rendor 34 (166), është shortuar me datë 23.02.2017 dhe ka përfunduar me datë 25.02.2017, pra brenda 5 ditëve; çështja me numër rendor 40 (190) është shortuar me datë 17.03.2017 dhe ka përfunduar me datë 21.03.2017, pra brenda 5 ditëve; çështja me numër rendor 63 (305) është shortuar me datë 18.04.2017 dhe ka përfunduar me datë 21.04.2017, pra brenda 5 ditëve; çështja me numër rendor 64 (310) është shortuar me datë 28.04.2017 dhe ka përfunduar me datë 02.05.2017, pra brenda 5 ditëve; çështja me numër rendor 72 (347) është shortuar me datë 07.06.2017 dhe ka përfunduar me datë 12.06.2017, pra brenda 5 ditëve, çështja me numër rendor 74 (360) është shortuar me datë 23.06.2017 dhe ka përfunduar me datë 28.06.2017, pra brenda 5 ditëve; çështjet me numër rendor 107 (495), 108 (501), 109 (505), 110 (509) janë shortuar me datë 29.09.2017 dhe kanë përfunduar me datë 04.10.2017, pra brenda 5 ditëve; çështja me numër rendor 115 (530) është shortuar me datë 03.10.2017 dhe ka përfunduar me datë 09.10.2017, pra brenda 5 ditëve; çështja me numër rendor 116 (535) është shortuar me datë 06.10.2017 dhe ka përfunduar me datë 11.10.2017, pra brenda 5 ditëve. **Kështu që, edhe këto 22 çështje do të konsiderohen si të përfunduara brenda afatit ligjor 5 ditor.**

- (iv) Në tabelën nr.2, viti 2017 (civile pa palë kundërshtare), çështja me numër rendor 20 (97) është shortuar me datë 02.02.2017 dhe ka përfunduar me datë 08.02.2017, çështjet me numër rendor 21 (107), 22 (109), 23 (116), 24 (118), 25 (125) janë shortuar me datë 02.02.2017 dhe kanë përfunduar me datë 08.02.2017, çështjet me numër 27 (134), 28 (140), 29 (143), 30 (147), 31(154), 32 (157), 33 (162) janë shortuar me datë 16.02.2017 dhe kanë përfunduar me datë 22.02.2017, çështjet me numër 41 (194), 42 (199), 43 (201), 44 (209), 45 (212), 46 (219), 47 (220), 48 (228) janë shortuar me datë 23.03.2017 dhe kanë përfunduar me datë 29.03.2017; çështjet me numër rendor 111 (514), 112 (519), 113 (522), 114 (526) janë shortuar me datë 03.10.2017 dhe kanë përfunduar me datë 09.10.2017 pra, kanë përfunduar për **6** ditë. Tejkalmi i afateve me 1 ditë do të konsiderohet i papërfillshëm, për pasojë **25** çështjet e gjykuara me një tejkalm afati prej një ditë **do të konsiderohen si të përfunduara brenda afatit ligjor 5 ditor.**
- (v) Ndërsa në tabelën nr.2, viti 2017 (civile pa palë kundërshtare), çështja me numër 36 (174), është shortuar me datë 09.03.2017 dhe ka përfunduar me datë 16.03.2017, çështjet me numër 37 (179), 38 (184), 39 (187) janë shortuar me datë 13.03.2017 dhe kanë përfunduar me datë 20.03.2017, çështja me numër rendor 88 (411) është shortuar me datë 08.09.2017 dhe ka përfunduar me datë 15.09.2017, pra kanë përfunduar për **7** ditë, pra e kanë tejkualuar afatin ligjor me dy ditë. Tejkalmi i afateve me 2 ditë do të konsiderohet i papërfillshëm, për pasojë **5** çështjet e gjykuara me një tejkalm afati prej dy ditësh **do të konsiderohen si të përfunduara brenda afatit ligjor prej 5 ditësh.**
- (vi) Në tabelë nr.2, viti 2019 (civile pa palë kundërshtare) çështjen me numër rendor 195 (67) e konsideruar në raportin analitik si e përfundur tej afatit ligjor prej 5 ditësh, rezulton të jetë shortuar më datë 17.07.2019 dhe përfunduar më datë 19.09.2019, pra është gjykuar për 2 ditëve, **brenda afatit 5 ditor**; çështja me numër rendor 21 (679) (sigurim padie), është shortuar me datë 23.10.2019 dhe ka përfunduar me datë 29.10.2019, pra ka përfunduar për **6** ditë, duke e tejkualuar afatin ligjor prej 5 ditësh vetëm me një ditë, tejkalm që do të konsiderohet i papërfillshëm, si pasojë çështja **do të konsiderohet e përfunduar brenda afati ligjor 5 ditor.**

- (vii) Në tabelën nr.6, viti 2018 çështja me numër rendor 1 (105) (caktim përfaqësuesi ligjor), është shortuar me datë 04.06.2018 dhe ka përfunduar me datë 11.06.2018, pra ka përfunduar për 7 ditë, **brenda afati ligjor 10 ditor të parashikuar nga neni 522 i K.Pr.Civile.**
- (viii) Në tabelën nr.10, viti 2019 (kërkesa penale të hetimit paraprak) çështja me numër rendor 23 (45) është shortuar me datë 20.02.2019 dhe ka përfunduar me datë 26.02.2019, pra ka përfunduar për 6 ditë; çështja me numër rendor 34 (88) është shortuar me datë 12.04.2019 dhe ka përfunduar me datë 18.04.2019; pra ka përfunduar për 6 ditë; çështja me numër rendor 49 (129) është shortuar me datë 07.06.2019 dhe ka përfunduar me datë 13.06.2019, pra ka përfunduar për 6 ditë; çështja me numër rendor 86 (358) është shortuar me datë 10.12.2019 dhe ka përfunduar me datë 16.12.2019, pra ka përfunduar për 6 ditë, duke e tejkaluar afatin ligjor prej 5 ditësh vetëm me një ditë, tejkalim që do të konsiderohet i papërfillshëm, si pasojë çështja **do të konsiderohet e përfunduar brenda afati ligjor 5 ditor.**
- (ix) Në tabelën nr. 11, viti 2017 (seanca penale paraprake), çështja me nr. 18 (35), e konsideruar në raportin analitik si jashtë afateve, rezulton e shortuar me datë 06.11.2017 dhe ka përfunduar me datë 04.12.2017, është gjykuar për 28 ditë, pra **brenda afatit 30 ditor të parashikuar në ligj.**
- (x) Në tabelën nr.11, viti 2018 (seanca penale paraprake) çështja me numër rendor 13 (23/125) është shortuar më datë 03.01.2018 dhe ka përfunduar me datë 25.01.2018, është gjykuar për 22 ditë; çështja me numër rendor 21 (60) është shortuar me datë 08.1.2018 dhe ka përfunduar me datë 06.02.2018, është gjykuar për 28 ditë, pra të dyja çështjet kanë përfunduar **brenda afatit 30 ditor të parashikuar në ligj;** çështja me numër rendor 16 (26/97) është shortuar me datë 28.12.2017 dhe ka përfunduar me datë 06.02.2018, është gjykuar për 1 muaj e 9 ditë; çështja me numër rendor 17 (27/85) është shortuar me datë 22.12.2017 dhe ka përfunduar me datë 01.02.2018, është gjykuar për 1 muaj e 9 ditë; Duke llogaritur festat e fundvitit dhe afatin e mbartjes së dosjeve, çështjet rezultojnë të gjykuara për rreth 30 ditë, **pra brenda afatit 30 ditor të parashikuar në ligj**¹⁴². Po në këtë tabelë, çështja me numër rendor 99 (469) është shortuar me datë 27.07.2018 dhe ka përfunduar me datë 10.09.2018, është gjykuar për 1 muaj e 13 ditë; çështja me numër rendor 101 (485) është shortuar me datë 31.07.2018 dhe ka përfunduar me datë 11.09.2018, është gjykuar për 1 muaj e 11 ditë; çështja me numër rendor 102 (487) është shortuar me datë 31.07.2018 dhe ka përfunduar me datë 19.09.2018, është gjykuar për 1 muaj e 19 ditë. Duke llogaritur pushimet vjetore të muajit gusht, çështjet rezultojnë të gjykuara për 8 ditë, 6 ditë dhe 14 ditë, pra **brenda afatit 30 ditor të parashikuar në ligj.**
- (xi) Në tabelën nr.11, viti 2019 (seanca penale paraprake) çështja me numër rendor 6 (800/08) është shortuar me datë 19.12.2018 dhe ka përfunduar me datë 30.01.2019, është gjykuar për 1 muaj e 10 ditë; çështja me numër rendor 7 (810/09) është shortuar me datë 21.12.2018 dhe ka përfunduar me datë 29.01.2019, është gjykuar për 1 muaj e 8 ditë; çështja me numër rendor 8 (804/10) është shortuar me datë 21.12.2018 dhe ka përfunduar me datë 10.01.2019, është gjykuar për 1 muaj. Duke llogaritur festat e fundvitit dhe afatin e mbartjes së dosjeve, çështjet rezultojnë të gjykuara për rreth 30 ditë, **pra brenda afatit 30 ditor të parashikuar në ligj**¹⁴³. Po në këtë tabelë, çështja me numër rendor 75 (302) është shortuar me datë 10.04.2019 dhe ka përfunduar me datë 09.05.2019, është gjykuar për 29 ditë; çështja me numër rendor 97 (408) është shortuar

¹⁴² Neni 325/2 I K.Pr.Penale

¹⁴³ Neni 325/2 I K.Pr.Penale

me datë 17.06.2019 dhe ka përfunduar me datë 15.07.2019, është gjykuar për 28 ditë, **pra brenda afatit 30 ditor të parashikuar në ligj.**

Për pasojë, duke konsideruar (i) shpjegimet e gjyqtarës lidhur me shortimin dhe planifikimin e çështjeve dhe (ii) tejkalimin e afatit me 1 ose 2 ditë, (iii) pushimet e vitit vjetore ato të vitit të Ri si dhe mbarjten e dosjeve **këto 73 çështje do të konsiderohen si të përfunduara brenda afatit ligjor.**

Në lidhje me çështjet e tjera¹⁴⁴ për të cilat gjyqtarja ka pretenduar llogaritjen e festave të fundvitit, afatin e mbartjes së dosjeve apo kohën që dosja ka mbetur në pritje nga regjistrimi deri në shortim (siç janë llogaritur më sipër), edhe nëse i llogarisim nuk ndryshojnë përfundimin, pra, janë përfunduar jashtë afatit 5 ditor, 20 ditore apo 30 ditore (megjithë toleranca 1-2 ditë që u la edhe në llogaritje e afateve të çështjeve të mësipërme).

Lidhur me çështjet e përfunduara tej afati ligjor për të cilat gjyqtarja ka dhënë shpjegime lidhur me mënyrën e planifikimit, shkaqet e shtyrjes së seancave dhe arsytet objektive që kanë ndikuar në kohëzgjatjen e tyre, duke iu referuar konkretisht secilës prej tyre. Po ashtu për çështjet e tjera të përfunduara tej afatit për të cilat nuk është referuar konkretisht, gjyqtarja ka parashtruar se përfundimi i tyre tej afatit ka qenë tërësisht për shkaqe objektive që lidhen me njoftimin dhe pjesëmarrjen e palëve në gjykim si dhe garantimin e të drejtave procedurale të tyre, në kuadër të zhvillimit të një procesi të rregullt ligjor, pavarësisht se ajo në çdo rast ka marrë të gjitha masat e nevojshme për planifikimin dhe zhvillimin efektiv të seancave gjyqësore, brenda afateve ligjore dhe shtyrjen e tyre për shkaqe objektive, në distancë kohore sa më të shkurtër nga njëra seancë në tjetrën. Po ashtu, duke iu referuar kategorive të ndryshme të çështjeve dhe dispozitave ligjore procedurale që rregullojnë gjykimin e tyre, gjyqtarja ka parashtruar se afatet për kryerjen e veprimeve të ndryshme procedurale bëjnë të pamundur respektimin e afatet ligjore apo standardet minimale kohore në fuqi për përfundimin e çështjeve¹⁴⁵ dhe apo ashtu nuk janë në koherencë me afatet e arsyeshme të parashikuara në nenin 399/2 të Kodit të Procedurës Civile.

Analiza e të dhënave statistikore nga ana e vlerësuesit duhet bërë në mënyrë të tillë që të shmangen përfundimet që vijnë për shkaqe që nuk janë përgjegjësi e gjyqtarit. Për analizën e këtij treguesi, vlerësuesi nuk bazohet vetëm në të dhënat statistikore, por merr në konsideratë të gjitha të dhënat dhe burimet e tjera të vlerësimit. Duke iu referuar tabelave me të dhënat statistikore si dhe çështjeve të analizuara më sipër, rezultoi se numri i çështjeve me afat ligjor është 744 çështje. Po ashtu në numrin e çështjeve me afat ligjor, të përfunduara tej këtij afati (182 çështje), duhet të zbriten 73 çështje, pasi referuar analizës për secilën prej tyre, rezultoi se ato duhet të konsiderohen të përfunduara brenda afatit ligjor. Në këtë mënyrë, raporti i çështjeve për të cilat vendimi është marrë në tejkalim të afatit ligjor (109 çështje), me numrin total të çështjeve të gjykuara për të cilat ligji parashikon afat gjykimi (744 çështje), rezulton të jetë 14,6 %, përqindje e cila sipas Metodologjisë pikëzohet me 12 pikë.

Në metodologjinë e pikëzimit, lidhur me këtë tregues, është përcaktuar hapësira e vlerësuesit për të përcaktuar një shkallë më të lartë pikëzimi, deri në një pikëzim maksimal, bazuar në analizën e të dhënave që rezultojnë nga analiza e të gjithave burimeve të vlerësimit, nisur nga

¹⁴⁴ Çështjet me nr. 54, 59, 66, 68, 74, 77, 80, 87, 89, 305, 403, 405 të tabelës nr. 2, viti 2017 etj

¹⁴⁵ Shih për më tepër shpjegimet e detajuara të gjyqtarës pasqyruar në formularin e vetëvlerësimit dhe raportin analitik, faqe 39-42.

tregues të tillë si: kompleksiteti i çështjeve, ngarkesa e gjyqtarit, rritja e volumit të punës, apo aspekte të tjera që lidhen me kushtet e punës së tij, duke shmangur çështje që nuk janë përgjegjësi e gjyqtarit.

Në rastin konkret, në lidhje me aspektin sasior të volumit të çështjeve të përfunduara, rezulton se gjyqtarja ka përfunduar në total për gjithë periudhën 3-vjeçare objekt vlerësimi (01.01.2017-31.12.2019) të vlerësimit 2334 çështje, nga të cilat 744 çështje parashikojnë afati ligjore gjykimi, nga të cilat 612 janë çështje themeli (civile dhe penale), pra mesatarisht 778 çështje në vit, pa përfshirë këtu ngarkesën si anëtare e trupit gjykues.

KONKLuzioni

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtarja ka treguar kujdes të posaçëm për zhvillimin e gjykimit brenda afateve ligjore. Nëse në përlogaritjen e çështjeve të shqyrtuara jashtë afatit ligjor, përjashtohen çështjet ku afati ligjor është tejkaluar me një kohë relativisht të shkurtër (*deri në 2 ditë*), atëherë numri i çështjeve të përfunduara jashtë afatit do të rezultonte 109 çështje dhe për pasojë, raporti i çështjeve për të cilat vendimi është marrë në tejkallim të afatit ligjor (109 çështje), me numrin total të çështjeve të gjykuara për të cilat ligji parashikon afat gjykimi (744 çështje), rezulton të jetë **14,6 % të çështjeve të përfunduara tej afatit ligjor**, përqindje që sipas Metodologjisë vlerësohet me 12 pikë. Por për pikëzimin e këtij treguesi, duke iu referuar analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit lidhur me: (i) raportin e çështjeve të gjykuara në tejkallim të afatit ligjor, që rezultojnë në masën 14.6% (ii) ngarkesën e gjyqtares si relatore (*në total për tre vite ka gjykuar 2334 çështje, nga të cilat 31.8 % apo 744 çështje janë me afat ligjore*)¹⁴⁶ dhe (iii) aspektet që lidhen me kushtet e punës, konkretisht angazhimin si anëtare të trupa gjykues, kohën që gjyqtarja kalon në zhvillimin e seancave, gjyqtarja për këtë tregues vlerësohet në nivelin maksimal të tij, duke e pikëzuar me 15 pikë.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, shkalla e aftësisë së gjyqtares për këtë tregues është shumë e lartë, brenda marzhit “0-10 %”, dhe pikëzohet me 15 pikë.

2.A.b Plotësimi i standardeve minimale kohore.

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik dhe tabelave me të dhëna statistikore për periudhën e vlerësimit, rezulton se gjyqtarja ka gjykuar gjithsej 1590 çështje për të cilat zbatohet standardi minimal kohor (*447 çështje në vitin 2017, 586 çështje në vitin 2018 dhe 557 çështje në vitin 2019*), të cilat i përkasin kategorive të çështjeve “Civile të përgjithshme me palë kundërshtare”, “Civile të përgjithshme pa palë kundërshtare”,

¹⁴⁶ Në vendimin nr. 261/2, viti 2010, t ish KLD-së, lidhur me standardin sasior, në pikën 3, shkronja g), parashikohet se “Gjyqtari i gjykatës së shkallës së parë që nuk është i organizuar në seksione, si relator, jo më pak se 200 çështje penale (krime dhe kundërvajtje) dhe civile që kanë të bëjnë me mosmarrëveshje me palë kundërshtare.”.

“Familjare me palë kundërshtare”, “Familjare pa palë kundërshtare”, “Marrëdhënie pune”, “Penale krime”, “Penale kundërvajtje”, “Seanca paraprahe-kërkesa për pushimin e procedimit penal” dhe “Kërkesa penale në fazën e ekzekutimit”, për të cilat vendimi nr. 261/2, datë 14.04.2010, i KLD përcakton këto standarde minimale kohore për gjykimin në gjykatën e shkallës së parë, si vijon:

- jo më tej se 6 muaj për gjykimet civile të themelit;
- jo më tej se 4 muaj për gjykimet familjare;
- jo më tej se 9 muaj për krimet me maksimumin e dënimit deri në 10 vjet dhe 12 muaj për krimet me minimumin e dënimit jo më pak se 10 vjet;
- jo më tej se 4 muaj për kundërvajtjet penale;
- jo më tej se 2 muaj për gjykimin e kërkesave civile pa palë kundërshtare;
- jo më tej se 2 muaj për gjykimin e kërkesave administrativo-penale.

Sipas të dhënave të pasqyruara në Raportin Analitik, rezulton se nga 1590 çështje të përfunduara gjatë periudhës së vlerësimit, për të cilat zbatohet standardi minimal kohor, 252 prej tyre ose **15,8 % janë gjykuar tej standardit minimal kohor në fuqi.**

Në formularin e integruar të vlerësimit, referuar këtij treguesi, gjyqtarja shprehet *“Vazhdimisht jam përpjekur që të respektoj standartet minimale kohore brenda të cilës duhet të përfundojë gjykimi i një çështje, por njëkohësisht duke i dhënë përparësi edhe garantimit të të drejtave të palëve ndërgjyqëse si dhe kryerjes së një hetimi të plotë dhe të gjithanshëm, me qëllimin e vetëm zgjidhjen e drejtë të çështjes. Gjithashtu, dëshiroj të vë në dukje se seancat gjyqësore nuk janë shtyrë për shkaqe që lidhen me mua si gjyqtare e çështjes, duke qenë gjithmonë e pranishme në punë dhe duke mos mundur pothuajse asnjë ditë. Tjetër fakt që dua të theksoj është se në shumë raste afati ka kaluar vetëm disa ditë”*

Pretendimet e parashtruara nga ana e gjyqtarës në lidhje me përfundimin e disa prej çështjeve jashtë standardit minimal kohor analizohen në vijim në tërësinë e tyre duke vlerësuar se vetëm në disa prej tyre argumentet e gjyqtarës lidhur me analizën logjike të të dhënave dhe përjashtimin e rrethanave që nuk janë përgjegjësi e gjyqtarit, gjejnë mbështetje në Skemën e Vlerësimit të Gjyqtarëve, pasi:

Së pari, standardet minimale kohore nuk janë afate të arsyeshme. Ato nxisin gjyqtarin të jetë sa më produktiv, pavarësisht ngarkesës në punë. Standardet orientuese janë indikator matës i performancës së gjyqtarit. Ndërsa qëllimi i afateve të arsyeshme nuk është përcaktimi në mënyrë taksative i afateve të arsyeshme të gjykimit të çështjeve për gjyqtarin në vetvete, por si afate maksimale për përfundimin e tyre, shkelja e të cilave legjitimon kërkuesin palë në proces që të kërkojë dëmshpërblim.

Së dyti, afatet e përcaktuara me vendimin nr. 261/2 të ish KLD-së për përfundimin e çështjeve (civile apo penale) kanë qenë dhe ende janë afate orientuese në funksion të menaxhimit dhe efikasitetit të çështjeve gjyqësore nga ana e gjyqtarit. Këto afate orientuese shërbejnë si një standard matës për efekt të vlerësimit të gjyqtarëve, nëse ata në punën e tyre kanë ndërmarrë një rol të vëmendshëm në planifikimin e seancave gjyqësore dhe në sigurimin e administrimit efikas të seancave gjyqësore, e për rrjedhojë të përfundimit të çështjeve në një kohë sa më të shkurtër. Nga ana tjetër, tejkalimi i këtyre afateve orientuese, nuk nënkupton shkeljen e standardit të procesit të rregullt ligjor parashikuar nga neni 42 i Kushtetutës dhe neni 6 të KEDNJ-së

Së treti, afatet e nevojshme për kryerjen e veprimeve procedurale të detyrueshme për tu zbatuar (*njoftimi i deklaratës së mbrojtjes, njoftimi me shpallje për palët...etj.*), apo edhe ato opsionale për tu zbatuar (*shpallja e arsyetuar e vendimit, etj.*) llogariten në afatin standard orientues të gjykimit të çështjes. Standardet orientuese përfshijnë në vetvete edhe kohën që i duhet gjyqtarit për kryerjen e veprimeve procedurale, të tilla si: shtyrjen deri në 20 ditë për shpallje të arsyetuar të vendimit; shtyrjen deri në tre ditë për tu shprehur në lidhje me kërkesat e palëve ; respektimin e afatit 30/ditor për paraqitjen e deklaratës së mbrojtjes ; afatit 20/ditor për njoftimin e palëve me shpallje, afati 5/ditor për paraqitjen e konkluzioneve përfundimtare me shkrim (neni 302/2 i K.Pr.Civile) etj.

Së katërti, afatet të cilat nuk janë në funksion të procesit (*si p.sh. afati 35 ditë në muajin Gusht - leja vjetore*) apo afatet të cilat ecin për shkak të disa veprimeve procedurale (*si p.sh. koha e kaluar nga pezullimi i çështjes deri në rifillimin e saj, koha e kaluar nga data e ankimit të një vendimi të ndërmjetëm, faza e parë e pjesëtimit, ankim ndaj pezullimit të çështjes, parashtrimi i konfliktit të kompetencës Gjykatës së Lartë, etj.*), janë afate, të cilat nuk duhet të llogariten në afatin orientues, pasi ato nuk ecin jo për shkak të menaxhimit jo të mire të çështjes nga ana e gjykatës. Në këtë kontekst, këto afate nuk duhet të llogariten në kohëzgjatjen e gjykimit, për aq sa rezultojnë të referuara nga ana e gjyqtarit për çështje konkrete apo nga të dhënat e pasqyruara në tabelat statistikore. Po kështu duhet mbajtur në vëmendje edhe caktimi i gjyqtarës si relatores e çështjes, në ato raste kur çështja është shortuar pas dhënies së dorëheqjes apo përjashtimit të gjyqtarëve të tjerë. Në rastin konkret nuk rezulton që gjyqtarja të ketë referuar të dhëna për kohën e pezullimit, kthimit të çështjes për vijimin e hetimeve, etj., për çështje konkrete, duke pamundësuar identifikimin dhe analizën e këtyre çështjeve. Për pasojë, në rastin konkret, duke iu referuar tabelave me të dhëna statistikore, e vetmja e dhënë objektive që rezulton është kohëzgjatja e gjykimit dikuar nga leja vjetore në muajin gusht, e cila do të analizohet dhe zbritet në çështjet respektive.

Në përlllogaritjen e standardit minimal kohor, për të gjitha dosjet, përlllogaritja e afateve do të fillojë nga data e shortimit (pra, data kur çështja ka shkuar pranë gjyqtarës), dhe jo ajo e regjistrimit. Në të gjitha dosjet, në përlllogaritje do të zbriten:

- leja vjetore e muajit gusht prej 35 ditësh (ligji parashikon 25 ditë pune apo 5 javë kalenderike për gjyqtarët) ;
- festat e fundvitit dhe afati i mbartjes së dosjeve.

Gjyqtarja ka pretenduar që për disa çështje të mbahën parasysh shkaqet e tejkalimit. Duke mbajtur në konsideratë analizën e sipërcituar mbi pretendimet e parashtruara nga ana e gjyqtarës, vlerësohet që të konsiderohen si çështje të cilat kanë përfunduar brenda standardit minimal kohor çështjet si më poshtë:

- (i) Çështja civile me nr. rendor 28, 107/1152, tabela nr. 1, viti 2017, shortuar me datë 22.12.2016 dhe ka përfunduar në datë 04.07.2017, e cila është gjykuar për 6 muaj e 12 ditë. Pas pretendimit në lidhje me mos përfshirjen në kohëzgjatjen e çështjes kohën e festave të fundvitit dhe mbartjes së dosjeve, çështja është gjykuar për 6 muaj, **pra brenda standardit minimal kohor prej 6 muaj sipas vendimit 261/2 të ish KLD-së.**
- (ii) Çështja civile me nr. rendor 30, tabela nr. 1, viti 2017, me nr. 110/1098, shortuar me datë 24.11.2016 dhe ka përfunduar në datë 01.06.2017, e cila është gjykuar për 6 muaj e 7 ditë. Pas pretendimit në lidhje me mos përfshirjen në kohëzgjatjen e çështjes kohën e festave të fundvitit dhe mbartjes së dosjeve, çështja është gjykuar për 6 muaj, pra, **brenda standardit minimal kohor prej 6 muaj sipas vendimit 261/2 të ish KLD-së.**

Përsa i përket çështjeve të tjera të pretenduara nga gjyqtarja¹⁴⁷, për të cilat ka pretenduar llogaritjen e festave të fundvitit, afatin e mbartjes së dosjeve apo kohën që dosja ka mbetur në pritje nga regjistrimi deri në shortim (siç janë llogaritur më sipër), apo muajin gusht që gjyqtarët kryejnë lejen vjetore, edhe nëse i llogarisim nuk ndryshojnë përfundimin, mbeten të gjykuara jashtë standardit minimal kohor.

Për të qenë sa më afër vërtetësisë së vlerësimit, janë konsideruar brenda standardit minimal kohor disa çështje të tjera, që edhe pse nuk janë pretenduar nga gjyqtarja, janë rezultat i studimit me kujdes të statistikave duke mbajtur në konsideratë analizën e sipërcituar (llogaritjen e festave të fundvitit, afatin e mbartjes së dosjeve, kohën që dosja ka mbetur në pritje nga regjistrimi deri në shortim dhe muajin gusht që gjyqtarët kryejnë lejen vjetore).

- (i) Çështja civile (pa palë kundërshtare) me nr. rendor 172 (634), 177 (778), 180 (857) të cilat janë gjykuar për për 3 muaj e 11 ditë, 2 muaj e 5, 2 muaj e 5 ditë. Duke mos përfshirë në kohëzgjatjen e çështjes kohën e pushimeve vjetore të muajit gusht, çështjet janë gjykuar për 2 muaj e 6 ditë, 2 muaj e 5 ditë, 2 muaj e 5 ditë tejkallim i cili vlerësohet i papërfillshëm dhe për pasojë çështja konsiderohet e përfunduar ***brenda standardit minimal kohor prej 2 muaj sipas vendimit 261/2 të ish KLD-së.***
- (ii) Çështja civile (pa palë kundërshtare) me nr. rendor 150 (55/1057), tabela nr. 2, viti 2017 është gjykuar për 2 muaj e 6 ditë. Duke mos përfshirë në kohëzgjatjen e çështjes kohën e festave të fundvitit dhe mbartjes së dosjeve çështja është gjykuar për rreth 2 muaj; çështjet civile me nr. rendor 170 (624), 171 (631), 172 (634), 173 (650), 250 (97) të cilat janë gjykuar për 3 muaj e 4 ditë, për 2 muaj e 27 ditë, për 3 muaj e 11 ditë, 2 muaj e 28 ditë, 2 muaj e 3 ditë. Duke mos përfshirë në kohëzgjatjen e çështjes kohën pushimeve vjetore të muajit gusht, çështjet janë gjykuar për 1 muaj 29 ditë, 1 muaj 22 ditë, 2 muaj e 6 ditë, 1 muaj e 23 ditë, 28 ditë pra ***brenda standardit minimal kohor prej 2 muaj sipas vendimit 261/2 të ish KLD-së.***
- (iii) Çështja civile (pa palë kundërshtare), tabelën nr.2, viti 2017, çështjet me nr. rendor 165 (410), nr. 180 (857), janë gjykuar për 2 muaj e 3 ditë, 2 muaj e pesë ditë, tejkallime të cilat vlerësohen të papërfillshme dhe për pasojë çështja konsiderohet e përfunduar ***brenda standardit minimal kohor prej 2 muaj sipas vendimit 261/2 të ish KLD-së.***
- (iv) Çështjet familjare (me palë kundërshtare) në tabelën nr. 3, viti 2017, me nr. rendor 36 (118/1112), është gjykuar për 4 muaj e 5 ditë. Duke mos përfshirë në kohëzgjatjen e çështjes kohën e festave të fundvitit dhe mbartjes së dosjeve, çështja është gjykuar për 4 muaj. Po në tabelën nr. 3, vitit 2017 çështjet familjare me nr. rendor 61 (572), 62 (586), 71 (718), 73 (723), janë gjykuar për 4 muaj e 4 ditë, për 4 muaj e 12 ditë, për 4 muaj e 20 ditë, për 4 muaj e 22 ditë. Duke mos përfshirë në kohëzgjatjen e çështjes pushimet vjetore të muajit gusht, çështjet janë gjykuar për 2 muaj e 29 ditë, 3 muaj e 3 ditë, 3 muaj e 15 ditë, 2 muaj e 17 ditë, pra ***brenda standardit minimal kohor prej 4 muaj sipas vendimit 261/2 të ish KLD-së.***
- (v) Çështjet familjare (me palë kundërshtare) në tabelën nr. 3, viti 2017, me nr. rendor 27 (68/629), është gjykuar për 4 muaj e 15 ditë. Duke mos përfshirë në kohëzgjatjen e çështjes kohën e festave të fundvitit dhe mbartjes së dosjeve, çështja është gjykuar për 4 muaj e 5 ditë; çështja me nr. rendor 44 (358) është gjykuar për 4 muaj e 1 ditë, tejkallime të cilat vlerësohen të papërfillshme dhe për pasojë çështja konsiderohet e përfunduar ***brenda standardit minimal kohor prej 4 muaj sipas vendimit 261/2 të ish KLD-së.***

¹⁴⁷ Çështja me nr. rendor 29 (109/721), çështja me Nr.45/45/806, çështja me Nr.47/697, çështja me Nr.59/541, çështja me Nr.66/615, çështja me Nr.71/926, çështja me Nr.74/922, çështja me Nr.75/915, çështja me Nr.77/517, çështja me Nr.90/745 dhe çështja me Nr.114/1107 të gjitha në tabelën nr.1 të vitit 2017,

- (vi) Çështja familjare (pa palë kundërshtare) me nr. rendor 1 (476), tabela nr. 4, viti 2017 është gjykuar për 2 muaj e 2 ditë tejkalim i cili vlerësohet i papërfillshëm dhe për pasojë çështja konsiderohet e përfunduar **brenda standardit minimal kohor prej 2 muaj sipas vendimit 261/2 të ish KLD-së.**
- (vii) Çështja penale krime me nr. rendor 4 (21/247) tabela nr. 8, viti 2017 është gjykuar për 9 muaj e 4 ditë. Përveç faktit që tejkalimi i afatit me 4 ditë vlerësohet i papërfillshëm, duke mos përfshirë në kohëzgjatjen e çështjes kohën e festave të fundvitit dhe pushimeve vjetore të muajit gusht, çështja është gjykuar për 7 muaj e 20 ditë, pra **brenda standardit minimal kohor prej 9 muaj sipas vendimit 261/2 të ish KLD-së.**
- (viii) Çështja penale kundravajtje me nr. rendor 4 (26/337), tabela nr. 9, viti 2017 është gjykuar për 4 muaj e 16 ditë. Duke mos llogaritur përfshirjen në kohëzgjatjen e çështjes kohën e festave të fundvitit dhe mbartjes së dosjeve çështja është gjykuar për 4 muaj e 5 ditë, tejkalim i cili vlerësohet i papërfillshëm dhe për pasojë çështja konsiderohet e përfunduar **brenda standardit minimal kohor prej 4 muaj sipas vendimit 261/2 të ish KLD-së.**
- (ix) Çështjet penale seanca paraprake me nr. rendor 3 (53) dhe 5 (100), tabela nr. 11, viti 2017 që rezultojnë të gjykuara për 2 muaj e 6 ditë dhe 2 muaj e 2 ditë, tejkalim i cili vlerësohet i papërfillshëm dhe për pasojë çështja konsiderohet e përfunduar **brenda standardit minimal kohor prej 2 muaj sipas vendimit 261/2 të ish KLD-së.**
- (x) Çështjet penale (kërkesa penale në fazën e ekzekutimit), në tabelën nr. 12, viti 2017, me nr. rendor 2 (5/398) është gjykuar për 2 muaj e 9 ditë. Duke mos llogaritur përfshirjen në kohëzgjatjen e çështjes kohën e festave të fundvitit dhe mbartjes së dosjeve çështja është gjykuar për rreth 2 muaj, **brenda standardit minimal kohor prej 2 muaj sipas vendimit 261/2 të ish KLD-së** . Po në këtë tabelë (nr.12, viti 2017), çështjet me nr. rendor 39 (231), 40 (232), 41 (237), 82 (33), 83 (35), 85 (42) dhe 111 (155) që rezultojnë të gjykuara për, 2 muaj 1 ditë, 2 muaj e 5 ditë, 2 muaj e 2 ditë, 2 muaj e 5 ditë, 2 muaj e 4 ditë, 2 muaj e 3 ditë dhe 2 muaj e 4 ditë tejkalime të cilat vlerësohen të papërfillshëm dhe për pasojë çështjet konsiderohen të përfunduara **brenda standardit minimal kohor prej 2 muaj sipas vendimit 261/2 të ish KLD-së.**
- (xi) Çështjet civile (me palë kundërshtare) tabela nr. 1, viti 2018, me nr. rendor 8 (15/730), 27 (50/785), 31 (245), 48 (443), që rezultojnë të gjykuara për 6 muaj e 19 ditë, 6 muaj e 18 ditë, 6 muaj e 3 ditë dhe 6 muaj e 5 ditë, nëse do të llogarisim kohën e mbartjes së dosjeve dhe festat e fundvitit, koha që mbetet prej disa ditësh 4-5 ditëve vlerësohet i papërfillshëm, dhe për pasojë çështja konsiderohet e përfunduar **brenda standardit minimal kohor prej 6 muaj sipas vendimit 261/2 të ish KLD-së.**
- (xii) Çështjet civile (pa palë kundërshtare) me nr. rendor 4 (100), 16 (30/940), 19 (36/879), 34 (769), tabela nr. 2, viti 2018 që rezultojnë të gjykuara për 2 muaj e 2 ditë, 2 muaj e 8 ditë, 2 muaj e 21 ditë dhe 2 muaj e 18 ditë, nëse do të llogarisim kohën e mbartjes së dosjeve dhe festat e fundvitit, ato do të vlerësohet se kanë përfunduar për 2 muaj, 2 muaj e 10 ditë, dy muaj e 8 ditë, tejkalim i cili vlerësohet i papërfillshëm dhe për pasojë çështjet do të konsiderohen të përfunduar **brenda standardit minimal kohor prej 2 muaj sipas vendimit 261/2 të ish KLD-së.**
- (xiii) Çështjet familjare (me palë kundërshtare) me nr. rendor 28 (18/908) dhe 68 (726), tabela nr. 3, viti 2018 që rezultojnë të gjykuara për 4 muaj e 4 ditë dhe 4 muaj e 15 ditë, nëse do të llogarisim kohën e mbartjes së dosjeve dhe festat e fundvitit, do të vlerësohet se kanë përfunduar për rreth 4 muaj apo 4 muaj e 5 ditë, tejkalim i cili vlerësohet i papërfillshëm dhe për pasojë çështjet do të konsiderohen të përfunduar **brenda standardit minimal kohor prej 4 muaj sipas vendimit 261/2 të ish KLD-së.**
- (xiv) Çështjet familjare (pa palë kundërshtare) me nr. rendor 4 (750), tabela nr. 4, viti 2018 që rezultojnë të gjykuara për 2 muaj e 20 ditë. Nëse do të llogarisim pushimet vjetore të

muajit gusht, rezulton e gjykuar për 1 muaj e 15 ditë e për pasojë do të konsiderohet e përfunduar **brenda standardit minimal kohor prej 2 muaj sipas vendimit 261/2 të ish KLD-së.**

- (xv) Kërkesat penale (të fazës së ekzekutimit) në tabelën nr. 12, viti 2018, me nr. rendor 125 (159), 135 (317), 136 (320), 138 (325), 139 (329) që rezultojnë të gjykuara për 2 muaj e 8 ditë, 2 muaj e 3 ditë, 2 muaj e 4 ditë, 2 muaj e 2 ditë dhe 2 muaj e 2 ditë, nëse do të llogarisim pushimet vjetore të muajit gusht rezultojnë që çështjet të jenë gjykuar në më pak se 2 muaj, pra **brenda standardit minimal kohor prej 2 muaj sipas vendimit 261/2 të ish KLD-së.**
- (xvi) Kërkesat penale (të fazës së ekzekutimit) në tabelën nr. 12, viti 2018, me nr. rendor 1 (1/224), 28 (175), 48 (60/00413) dhe 70 (1/394), që rezultojnë të gjykuara për 2 muaj e 15 ditë¹⁴⁸, 2 muaj e 8 ditë, 2 muaj e 2 ditë dhe 2 muaj e 16¹⁴⁹ ditë, tejkalime të cilat vlerësohen të papërfillshme dhe për pasojë çështjet do të konsiderohen të përfunduar **brenda standardit minimal kohor prej 2 muaj sipas vendimit 261/2 të ish KLD-së.**
- (xvii) Çështjet civile (me palë kundërshtare) tabela nr. 1, viti 2019, me nr. rendor 26 (291) dhe 40 (389), që rezultojnë të gjykuara për 6 muaj e 9 ditë dhe 6 muaj e 17 ditë¹⁵⁰, tejkalim i cili vlerësohet i papërfillshëm dhe për pasojë çështjet do të konsiderohen të përfunduar **brenda standardit minimal kohor prej 6 muaj sipas vendimit 261/2 të ish KLD-së.**
- (xviii) Çështjet civile (pa palë kundërshtare) tabela nr. 2, viti 2019, me nr. rendor 196 (68) rezulton e gjykuar për 2 muaj e 1 ditë, tejkalim i cili vlerësohet i papërfillshëm, por nëse do të llogarisim pushimet vjetore të muajit gusht, çështja është gjykuar për 26 ditë, pra **brenda standardit minimal kohor prej 2 muaj sipas vendimit 261/2 të ish KLD-së.**
- (xix) Çështjet familjare (me palë kundërshtare) në tabelën nr. 3, viti 2019, me nr. rendor 4 (44/808), 20 (332) dhe 49 (112), që rezultojnë të gjykuara për 4 muaj e 9 ditë¹⁵¹, 4 muaj e 5 ditë dhe 5 muaj e 1 ditë¹⁵², tejkalim i cili vlerësohet i papërfillshëm dhe për pasojë çështjet do të konsiderohen të përfunduar **brenda standardit minimal kohor prej 4 muaj sipas vendimit 261/2 të ish KLD-së. 3**
- (xx) Çështjet civile (marrëdhënie pune) tabela nr.7, viti 2019, me nr. rendor 3 (61/904) dhe 5 (64/782), që rezultojnë të gjykuara të dyja për 6 muaj e 11 ditë¹⁵³, nëse do të llogarisim festat e fundvitit, mbarjen e dosjeve dhe pushimet vjetore për pasojë çështjet do të konsiderohen të përfunduar **brenda standardit minimal kohor prej 6 muaj sipas vendimit 261/2 të ish KLD-së.**
- (xxi) Çështjet penale (seanca paraprake) tabela nr. 11, viti 2019, me nr. rendor 16 (750/20), 35 (161) dhe 100 (415) që rezultojnë të gjykuara për 2 muaj e 3 ditë, 2 muaj e 3 ditë, 3 muaj e 8 ditë¹⁵⁴, tejkalim i cili vlerësohet i papërfillshëm dhe për pasojë çështja konsiderohet e përfunduar **brenda standardit minimal kohor prej 2 muaj sipas vendimit 261/2 të ish KLD-së.**

¹⁴⁸ Çështja është gjykuar për 2 muaj e 3 ditë nëse do të llogarisim kohën e mbartjes së dosjeve dhe festat e fundvitit, pra tejkalimi me 3 ditë është i papërfillshëm

¹⁴⁹ Çështja është gjykuar për 2 muaj e 4 ditë nëse do të llogarisim kohën e mbartjes së dosjeve dhe festat e fundvitit, pra tejkalimi me 4 ditë është i papërfillshëm

¹⁵⁰ Çështja është gjykuar brenda afatit nëse do të llogarisim pushimet vjetore të muajit gusht (5 muaj e 12 ditë)

¹⁵¹ Çështja është gjykuar brenda afatit nëse do të llogarisim kohën e mbartjes së dosjeve dhe festat e fundvitit (3 muaj e 27 ditë)

¹⁵² Çështja është gjykuar brenda afatit nëse do të llogarisim pushimet vjetore të muajit gusht (3 muaj e 26 ditë).

¹⁵³ Çështjet janë gjykuar brenda afatit nëse do të llogarisim kohën e mbartjes së dosjeve dhe festat e fundvitit (5 muaj e 29 ditë) dhe kohën e pushimeve vjetore të muajit gusht (5 muaj e 6 ditë)

¹⁵⁴ Çështja është gjykuar për 2 muaj e 3 ditë nëse do të llogarisim pushimet vjetore të muajit gusht, pra tejkalimi me 3 ditë është i papërfillshëm

(xxii) Çështjet penale (seanca paraprake) tabela nr. 11, viti 2019, me nr. rendor 111 (456), 113 (469), 114 (473), 115 (483), 116 (484), 117 (496), 120 (505), 121 (508) dhe 124 (518) që rezultojnë të gjykuara për 2 muaj e 15 ditë, 3 muaj e 4 ditë, 2 muaj e 22 ditë, 2 muaj e 15 ditë, 2 muaj e 13 ditë, 2 muaj e 10 ditë, 2 muaj e 28 ditë dhe 2 muaj e 3 ditë, duke qenë se në gjykimin e të gjithavë janë kryer pushimet vjetore të muajit gusht, duke ribërë përlllogaritjen rezultojnë se të gjitha çështjet janë përfunduar në më pak se 2 muaj, pra **brenda standardit minimal kohor prej 2 muaj sipas vendimit 261/2 të ish KLD-së.**

(xxiii) Kërkesat penale (të fazës së ekzekutimit) tabela nr. 12, viti 2019, me nr. rendor 4 (214/05), 25 (156), 69 (63), 70 (72) që rezultojnë të gjykuara për 2 muaj e 19 ditë, 3 muaj e 11 ditë, 3 muaj e 12 ditë dhe 2 muaj e 23 ditë, nëse do të llogarisim kohën e mbartjes së dosjeve, festat e fundvitit (për çështjen e parë) dhe pushimet vjetore të muajit gusht (për 3 çështjet e tjera) rezultojnë që çështjet të jenë gjykuar për 2 muaj e 7 ditë, 2 muaj e 6 ditë, 2 muaj e 7 ditë dhe 1 muaj e 17 ditë brenda afatit ose duke e tejkaluar në mënyrë të papaërfillshme atë (me 6-7 ditë) dhe si të tilla do të konsiderohen të gjykuara **brenda standardit minimal kohor prej 2 muaj sipas vendimit 261/2 të ish KLD-së.**

Pra, janë gjithsej 77 çështje që do të llogariten të gjykuara brenda standardit minimal kohor dhe do t'i zbriten numrit prej 252 çështjesh të përlllogaritura në raportin analitik, duke mbetur kështu 175 çështje.

Duke konsideruar sa më sipër, numri total i çështjeve për të cilat parashikohet standardi minimal kohor është 1590 dhe numrit total të çështjeve të përfunduara jashtë standardit minimal kohor rezultojnë të jetë 175 çështje, ose 11 % e numrit total të çështjeve për të cilat zbatohet standardi minimal kohor. Kjo përqindje përkon me pikëzimin me 4 pikë. Gjyqtarja, i është larguar përqindjes për pikëzimin maksimal (e cila është 0-10%) vetëm me 1 %.

Referuar Metodologjisë së Pikëzimit, në përcaktimin e nivelit të vlerësimit për këtë tregues, të dhënat statistikore analizohen duke shmangur çështje që nuk janë përgjegjësi e gjyqtarit. Vlerësuesi mund të përcaktojë një shkallë më të lartë pikëzimi duke marrë parasysh tregues të tjerë që lidhen me produktivitetin e gjyqtarit, siç është në rastin konkret, treguesi sasior i punës së gjyqtares.

Referuar treguesit sasior, rezultoi se gjyqtarja ka përfunduar në periudhën 3 vjeçare të vlerësimit në total 2332 çështje nga të cilat 866 çështje me palë kundërshtarë (*civile të përgjithshme, familjare, marrëdhënie pune, penale krime, penale kundërvajtje dhe kërkesa për pushim procedimi*). Referuar standardit sasior në fuqi¹⁵⁵, gjyqtarja duhet të përfundonte jo më pak se 200 çështje me palë kundërshtarë në vit, pra 600 çështje në tre vjet. Ndërkohë rezultojnë se ajo ka përfunduar 866 çështje me palë kundërshtarë, duke tejkaluar këtë standard me 266 çështje në periudhën tre vjeçare, ose në masën 30,7 %.

KONKLuzioni

¹⁵⁵ Në vendimin nr. 261/2, viti 2010, t ish KLD-së, lidhur me standardin sasior, në pikën 3, shkronja g), parashikohet se "Gjyqtari i gjykatës së shkallës së parë që nuk është i organizuar në seksione, si relator, jo më pak se 200 çështje penale (krime dhe kundërvajtje) dhe civile që kanë të bëjnë me mosmarrëveshje me palë kundërshtarë."

Për sa më sipër, për pikëzimin e këtij treguesi, duke iu referuar analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit lidhur me: (i) raportin e çështjeve të gjykuara tej standardit me numrin total të çështjeve që rezulton 11 % ; (ii) faktorët që ndikojnë në kohëzgjatjen e gjykimit referuar shkaqeve të bëra prezent nga gjyqtarja në vetëvlerësimin e saj, të cilat përgjithësisht nuk rezultojnë të jenë për shkaqe që janë përgjegjësi e gjyqtarit dhe (iii) tejkalimin e standardit sasior të zbatueshëm në masën 30,7 % , (iv) numrin teje të lartë të çështjeve të gjykuara brenda 3 vjetëve, prej 2334, nga të cilat 744 kanë qenë me afat ligjore, vlerësoj se për këtë tregues gjyqtarja duhet të pikëzohet në nivelin maksimal.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, në lidhje me këtë tregues gjyqtarja pikëzohet me 5 pikë, pasi shqyrtimi i 11 % të çështjeve jashtë standardit minimal kohor, ka ardhur përgjithësisht për shkaqe që nuk janë përgjegjësi e gjyqtarit, sikundër është treguesi sasior i punës së saj (tejkalim i standardit sasior me 30,7 %) si dhe gjykimi i një numri prej 744 çështje me afat ligjor.

2.A.c Koha mesatare që i dedikohet çdo çështjeje.

Nga tërësia e burimeve të vlerësimit për këtë tregues, të pasqyruara në Raportin Analitik, rezulton se koha mesatare që i dedikohet çdo çështjeje, krahasuar me standardin minimal kohor në fuqi sipas vendimit nr. 261/2, datë 14.4.2010, të KLD, për secilën kategori, pa përfshirë çështjet për të cilat ligji parashikon afate gjykimi, është si më poshtë:

- i. Në kategorinë e çështjeve “*Civile të përgjithshme me palë kundërshtare*”, koha mesatare që i dedikohet çdo çështje është 133,2 ditë (4 muaj e 13,2 ditë), pra ***më e shkurtër*** se standardi minimal kohor i miratuar, prej 6 muaj;
- ii. Në kategorinë e çështjeve “*Civile të përgjithshme pa palë kundërshtare*”, koha mesatare që i dedikohet çdo çështje është 19,5 ditë, pra ***më e shkurtër*** se standardi minimal kohor i miratuar, prej 2 muaj;
- iii. Në kategorinë e çështjeve “*Familjare me palë kundërshtare*”, koha mesatare që i dedikohet çdo çështje është 86 ditë (2 muaj e 26 ditë), pra ***më e shkurtër*** se standardi minimal kohor i miratuar, prej 4 muaj;
- iv. Në kategorinë e çështjeve “*Familjare pa palë kundërshtare*”, koha mesatare që i dedikohet çdo çështje është 37.7 ditë (1 muaj e 7 ditë), pra ***më e shkurtër*** se standardi minimal kohor i miratuar prej 2 muaj;
- v. Në kategorinë e çështjeve “*Tregtare me palë kundërshtare*”, koha mesatare që i dedikohet çdo çështje është 145 ditë (4 muaj e 25 ditë), pra ***më e shkurtër*** se standardi minimal kohor i miratuar prej 6 muaj;
- vi. Në kategorinë e çështjeve “*Tregtare pa palë kundërshtare*”, koha mesatare që i dedikohet çdo çështje është 69,8 ditë (2 muaj e 9,8 ditë), pra ***më e gjatë*** se standardi minimal kohor i miratuar prej 2 muaj, por *duke e tejkualuar këtë afat me vetëm 9 ditë*;
- vii. Në kategorinë e çështjeve “*Marrëdhënie pune*”, koha mesatare që i dedikohet çdo çështje është 104,8 ditë (3 muaj e 14,8 ditë), pra ***më e shkurtër*** se standardi minimal kohor i miratuar, prej 6 muaj;

- viii. Në kategorinë e çështjeve “*Penale-krime*”, koha mesatare që i dedikohet çdo çështje është 82,2 ditë (2 muaj e 22.2 ditë), pra **më e shkurtër** se standardi minimal kohor i miratuar, prej 9 apo 12 muaj;
- ix. Në kategorinë e çështjeve “*Penale-kundërvajtje*”, koha mesatare që i dedikohet çdo çështje është 108,7 ditë (3 muaj e 18,7 ditë), pra **më e shkurtër** se standardi minimal kohor i miratuar, prej 4 muaj;
- x. Në kategorinë e çështjeve “*Kërkesa penale në fazën e hetimit paraprak*”, koha mesatare që i dedikohet çdo çështje është 7 ditë, pra **më e shkurtër** se standardi minimal kohor i miratuar, prej 2 muaj;
- xi. Në kategorinë e çështjeve “*Seancë paraprake*”, koha mesatare që i dedikohet çdo çështje është 43 (1 muaj e 13 ditë) ditë, pra **më e shkurtër** se standardi minimal kohor i miratuar, prej 2 muaj;
- xii. Në kategorinë e çështjeve “*Kërkesa penale të fazës së ekzekutimit dhe marrëdhënieve juridiksionale me jashtë*”, koha mesatare që i dedikohet çdo çështje është 44,1 ditë (1 muaj e 14,1), pra **më e shkurtër** se standardi minimal kohor i miratuar, prej 2 muaj.

Në Formularin e Integruar të Vlerësimit gjyqtarja dhe kryetarja e kanë vlerësuar këtë tregues në nivelin shumë të lartë. Gjyqtarja parashtron si shkaqe që kanë ndikuar në kohëzgjatjen e gjykimit të disa çështjeve, ngarkesën e lartë me çështje të natyrave të ndryshme, zhvillimi i shumë seancave gjyqësore në ditë dhe çdo ditë të javës, delegime nëpër gjykata të ndryshme si dhe nga muaji prill 2019 përzgjedhjen edhe si zëvendëskryetare e gjykatës.

KONKLUZIONI

Në Metodologjinë e Pikëzimit parashikohet se për të bërë pikëzimin e këtij treguesi, të dhënat statistikore analizohen sipas situatës për të shmangur përfundimet që nuk janë përgjegjësi e gjyqtarit.¹⁵⁶ Referuar metodologjisë, duke qenë se shumicën e kategorive të çështjeve (11 nga 12 kategori), koha mesatare që i dedikohet çdo çështje është më e shkurtër se afati procedural për të gjitha kategoritë e çështjeve, përveç kategorisë “*Tregtare pa palë kundërshtarë*”, ku standardi minimal kohor është tejkaluar me vetëm 9 ditë, çka vlerësohet tejkalim i papërfillshëm, gjyqtarja duhet të pikëzohet në nivelin maksimal për këtë tregues.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, vlerësohet se, koha mesatare që i dedikohet çdo çështjeje duhet të konsiderohet më e shkurtër me standardin minimal kohor për të gjitha kategoritë e çështjeve, duke e pikëzuar me 5 pikë.

2.A.ç Rendimenti i përfundimit të çështjeve gjyqësore.

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik, rezulton se rendimenti i përfundimit të çështjeve, për të gjithë periudhën e vlerësimit (01.01.2017-31.12.2019) si

¹⁵⁶ Metodologjia e Pikëzimit për këtë tregues parashikon se : “...Të gjitha të dhënat statistikore analizohen sipas situatës, me qëllim për të shmangur përfundimet për çështje që nuk janë përgjegjësi e gjyqtarit. Analiza e të dhënave statistikore bazohet në kompleksitetin e çështjeve, volumin e çështjeve, rritjen e papritur të volumit të çështjeve, dhe aspekteve të tjera që lidhen me kushtet e punës, të cilat mund të çojnë në një pikëzim më të lartë nga ai i tabelës së mësipërme, deri në pikëzimin maksimal”.

raport midis numrit të çështjeve të përfunduara (2332 çështje) me numrin e çështjeve të caktuara (2036 çështje) brenda periudhës 3/vjeçare të vlerësimit, **është 114,6 %** përqindje e cila sipas Metodologjisë pikëzohet me 10 pikë, duke qenë se rezulton +99 %..

Në Formularin e Integruar të Vlerësimit gjyqtarja dhe kryetarja e kanë vlerësuar këtë tregues në nivelin shumë të lartë.

KONKLUZIONI

Duke iu referuar burimeve të vlerësimit, rendimenti i gjyqtarës për periudhën e vlerësimit rezulton në masën 114.6 % e për këtë arsye gjyqtarja duhet të vlerësohet dhe pikëzohet në nivelin maksimal për këtë tregues, pasi rezulton me një rendiment +99 %.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarës dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, vlerësohet se aftësia e gjyqtarës për këtë tregues është shumë e lartë dhe pikëzohet me 10 pikë, pasi rendimenti i përfundimit të çështjeve është + 99 %.

2.A.d Koha mesatare e arsytimit të vendimit përfundimtar gjyqësor.

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik, evidentohet se koha mesatare e arsytimit të vendimeve gjyqësore për kategori të veçanta çështjesh është si më poshtë:

- i. Për të gjitha çështjet e kategorisë “*civile të përgjithshme me palë kundërshtare*”, koha mesatare e arsytimit është 11 ditë, pra më e shkurtër se afati procedural 20 ditë i parashikuar nga neni 308/2 i K. Pr. Civile.
- ii. Për çështje të kategorisë “*civile të përgjithshme pa palë kundërshtare*”, koha mesatare e arsytimit është 7 ditë, pra **më e shkurtër** se afati procedural 20 ditë i parashikuar nga neni 308/2 i K. Pr. Civile.
- iii. Për çështje të kategorisë “*familjare me palë kundërshtare*”, koha mesatare e arsytimit është 10.2 ditë, pra **më e shkurtër** se afati procedural 20 ditë i parashikuar nga neni 308/2 i K. Pr. Civile.
- iv. Për çështje të kategorisë “*familjare pa palë kundërshtare*”, koha mesatare e arsytimit është 13.9 ditë, pra **më e shkurtër** se afati procedural 20 ditë i parashikuar nga neni 308/2 i K. Pr. Civile.
- v. Për çështje të kategorisë “*marrëdhënie pune*”, koha mesatare e arsytimit është 9.9 ditë, pra **më e shkurtër** se afati procedural 20 ditë i parashikuar nga neni 308/2 i K. Pr. Civile.
- vi. Për çështje të kategorisë “*tregtare pa palë kundërshtare*”, koha mesatare e arsytimit është 13 ditë, pra **më e shkurtër** se afati procedural 20 ditë i parashikuar nga neni 308/2 i K. Pr. Civile.
- vii. Për çështje të kategorisë “*kërkesa penale të hetimit paraprak*”, me objekt, *vleftësim arresti dhe caktim mase sigurimi si dhe zëvendësim mase sigurimi*, koha mesatare e arsytimit është 3.6 ditë, pra **më e shkurtër** se afati procedural 5 ditë i parashikuar nga neni 249, 244 dhe 260 i K. Pr. Penale.

- viii. Për çështje të kategorisë “*kërkesa penale të hetimit paraprak*”, me objekt, *verifikim kushtesh dhe kriteresh të caktimit të masës së sigurimit dhe shuarje mase sigurimi*, koha mesatare e arsyetimit është 4 ditë, pra **më e gjatë** se afati procedural 48 orë i parashikuar nga neni 248/2 i K. Pr. Penale¹⁵⁷.
- ix. Për çështje të kategorisë “*kërkesa penale të hetimit paraprak*”, me objekt, *vleftësim, lejim apo zgjatje e përgjimit*, koha mesatare e arsyetimit është 0 ditë, pra menjëherë me shpalljen e vendimit sikundër është i parashikuar nga neni 222/4 i K. Pr. Penale¹⁵⁸. Pra, koha mesatare e arsyetimit është **më e shkurtër** ose e barabartë me afatin procedural të parashikuar nga neni 222 i K.Pr.Penale
- x. Për çështje të kategorisë “*kërkesa penale të hetimit paraprak*”, me objekt, *kundërshtim vendimi mosfillimi*, për të cilat ligji procedural nuk ka parashikuar afat për arsyetimin e vendimit me objekt kundërshtim vendimi mosfillimi, koha mesatare e arsyetimit 12.6 ditë, pra **më e shkurtër** se afati procedural 30 ditë i parashikuar nga neni 430/1 i K. Pr. Penale.
- xi. Për çështje të kategorisë “*kërkesa penale të hetimit paraprak*”, me objekt, *përrjashtim gjyqtari*, për të cilat ligji procedural nuk ka parashikuar afat për arsyetimin e vendimit, koha mesatare e arsyetimit është 0.3 ditë, pra **më e shkurtër** se afati procedural 30 ditë i parashikuar nga neni 430/1 i K. Pr. Penale.
- xii. Për çështje të kategorisë “*kërkesa penale të hetimit paraprak*”, me objekt, *deklarim ikje, zgjatje e afateve të hetimit, kthim i sendeve të sekuestruara etj*, për të cilat ligji procedural nuk ka parashikuar afat për arsyetimin e vendimit, koha mesatare e arsyetimit është 6.2 ditë, pra **më e shkurtër** se afati procedural 30 ditë i parashikuar nga neni 430/1 i K. Pr. Penale.
- xiii. Për çështje të kategorisë “*seancë paraprake – dërgim në gjyq*”, koha mesatare e arsyetimit të vendimit është 4.8 ditë, pra **më e shkurtër** se afati procedural prej 10 ditë i parashikuar nga neni 332/dh, pg 2 i K. Pr. Penale.
- xiv. Për çështje të kategorisë “*seancë paraprake – pushim procedimi*” koha mesatare e arsyetimit të vendimit është 12.2 ditë, pra **më e shkurtër** se afati procedural prej 30 ditë i parashikuar nga neni 430/1 i K. Pr. Penale.
- xv. Për çështje të kategorisë “*kerkesa penale në fazën e ekzekutimit*” për të cilën nuk parashikohet ndonjë afat i posaçëm për arsyetimin e vendimit, koha mesatare e arsyetimit të vendimit është 10.2 ditë, pra **më e shkurtër** se afati procedural prej 30 ditësh i parashikuar nga neni 430/1 i K. Pr. Penale.
- xvi. Për çështje të kategorisë “*penale krime*”, koha mesatare e arsyetimit të vendimit është 13 ditë, pra **më e shkurtër** se afati procedural prej 30 ditë i parashikuar nga neni 430/1 i K. Pr. Penale.
- xvii. Për çështje të kategorisë “*penale kundravajtje*”, koha mesatare e arsyetimit të vendimit është 13.4 ditë, pra **më e shkurtër** se afati procedural prej 30 ditë i parashikuar nga neni 430/1 i K. Pr. Penale.

¹⁵⁷ Njëpërmjet marrjes në pyetje, gjykata verifikon kushtet dhe kriteret e caktimit të masës dhe nevojat e sigurimit, të parashikuara nga nenet 228, 229 dhe 230 të këtij Kodi. Kur këto kushte nuk ekzistojnë, gjykata vendos revokimin ose zëvendësimin e masës. Në të kundërt, gjykata vendos vazhdimin e zbatimit të saj. Gjykata depoziton vendimin e arsyetuar brenda 48 orëve.

¹⁵⁸ Në rastet e parashikuara në paragrafët 1, 2 dhe 3, të këtij neni, gjykata merr vendim të arsyetuar në dhomë këshillimi, brenda 24 orëve nga paraqitja e kërkesës së prokurorit. Kundër vendimit që refuzon kërkesën për përgjim mund të bëhet ankim i veçantë në gjykatën e apelit brenda 24 orëve. Gjykata e apelit shqyrton ankimin brenda 48 orëve nga marrja e akteve. Paraqitja e kërkesës për vleftësimin e përgjimit nuk shkakton ndërprerjen e tij.

Në Formularin e Integruar të Vlerësimit gjyqtarja dhe kryetarja e kanë vlerësuar këtë tregues në nivelin mbi mesatar. Gjyqtarja ka parashtruar se “...Përsa i përket arsytimit të vendimeve parashtror se pjesa më e madhe e tyre është arsyetuar dhe dorëzuar brenda afatit..” ndërsa kryetarja vë në dukje se “Mendoj se aftësia e gjyqtarës për të arsyetuar dhe dorëzuar vendimet brenda një afati sa më të shpejtë, është shumë e lartë. Në këtë rubrikë, mendoj se duhet të konsiderohet edhe rëndësia që gjyqtarja i kushton cilësisë së arsytimit, natyra e ndryshme e vendimeve (civile, penale, familjare), ngarkesa e lartë me çështje, delegimet nëpër disa gjykata të ndryshme, angazhimi aktiv i gjyqtarës në realizimin e projekteve nga gjykata si “Drejtësi pa vonesa” etj., mbledhjet e gjyqtarëve, hartimin e akteve model, broshurave informuese, etj., si dhe nga muaji prill 2019 në cilësinë e zëvendëskryetarës së gjykatës angazhimit aktiv në mbledhjet e Këshillit të Gjykatës dhe takimet me përdoruesit e gjykatës. Në asnjë rast nuk ka patur ankesa nga palët në këtë drejtim dhe nuk është cënuar e drejta e palëve për ankim.”

Nga të dhënat statistikore, rezulton se koha mesatare e arsytimit të vendimit është tejkaluar vetëm për 1 (një) nga 17 (shtatëmbëdhjetë) kategoritë e çështjeve, konkretisht në kategorinë e çështjes “kërkesa penale të hetimit paraprak” me objekt, *verifikim kushtesh dhe kriteresh të caktimit të masës së sigurimit dhe shuarje mase sigurimi*. Referuar Metodologjisë, kur koha e arsytimit është më e shkurtër se afati procedural për shumicën e kategorive të çështjeve, i korespondon pikëzimit me 12 pikë.

Sipas Metodologjisë, për të pikëzuar këtë tregues, analiza e të dhënave statistikore bazohet në kompleksitetin e çështjeve, volumin e çështjeve, rritjen e papritur të volumit të çështjeve dhe aspekte të tjera që lidhen me kushtet e punës, të cilat mund të çojnë në një pikëzim më të lartë nga ai i tabelës së mësipërme, duke zbatuar një koeficient jo më shumë se 20%.

Në rastin konkret, lidhur me këtë tregues duke pasur në konsideratë, volumin e çështjeve ku rezultoi se për një periudhë tre vjeçare (2017-2019), gjyqtarja ka dhënë 2334 vendime, mesatarisht rreth 778 vendime në vit, apo rreth 70.7 vendime në muaj, dhe mesatarisht 3.37 vendime në ditë, referuar ditëve mesatare të punës në një muaj prej 21 ditësh, si dhe aspekte të tjera që lidhen me kushtet e punës, konkretisht kohën angazhimit të gjyqtarës në gjykimet gjatë orarit zyrtar në ditët e javës, angazhimit e saj si anëtare e trupit gjykues apo në rastet kur është caktuar si e deleguar në gjykatën e Kurbinit, propozohet që për këtë tregues gjyqtarja të vlerësohet në një nivel më të lartë pikëzimi, që i korespondon pikëzimit maksimal prej 15 pikë.

Edhe për këtë tregues, gjyqtarja ka kërkuar rrillogaritjen e afateve të arsytimit të vendimeve për kategorinë “kërkesa penale në fazën e hetimeve paraprake” të vendimeve të marra sipas nenit 248 të K.Pr.Penale, duke pretenduar se pas ndryshimeve ligjore të bëra në vitin 2017 të gjitha vendimet e marra sipas këtij neni janë arsyetuar brenda 48 orëve.

Këshilli pasi mori në analizë edhe njëherë të dhënat statistikore të përcjella nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lëzhe, ku pasqyrohet edhe data e dorëzimit të vendimeve në kryesekretaria, e cila është konsideruar edhe koha e arsytimit të vendimit, si e vetmja e dhënë objektiv, referuar pretendimit të gjyqtarës, konstatoi se këto konstatime qëndrojnë. Konkretisht rezulton se koha mesatare e arsytimit të vendimet gjyqësore për çështje të kategorisë “kërkesa penale të hetimit paraprak”, me objekt, *verifikim kushtesh dhe kriteresh të caktimit të masës së sigurimit dhe shuarje mase sigurimi* », të marra përpara muajit Gusht 2017, kur kanë hyrë në fuqi dispozitat e reja të Kodit të Procedurës Penale, të

ndryshuara me ligjin nr. 35/2017, datë 30.3.2017, për 4 çështje (çështjet me numër rëndor 1, 20, 42 dhe 52 të Tabelës 10, vitit 2017) është 9.25 ditë. Ndërsa pas hyrjes në fuqi të ligjit nr.35/2017 afati mesatar i arsyetimit të vendimeve për këtë kategori çështjes është 1.34 ditë, pra më e shkurtër se afati ligjore prej 48 orëve¹⁵⁹.

KONKLuzioni

Duke iu referuar burimeve të vlerësimit, koha mesatare e arsyetimit të vendimit përfundimtar klasifikohet si “*Më e shkurtër ose e barabartë me afatin procedural për të gjitha kategoritë e çështjeve*” dhe gjyqtarja duke të pikëzohet me pikët maksimale për këtë tregues.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, në lidhje me treguesin “Koha mesatare e arsyetimit të vendimit gjyqësor përfundimtar” gjyqtarja pikëzohet me 15 pikë, pasi kjo kohë është më e shkurtër ose e barabartë me afatin procedural për të gjitha kategoritë e çështjeve.

2.B AFTËSIA PËR TË KRYER PROCEDURAT GJYQËSORE.

2.B.a Numri mesatar i seancave gjyqësore për çdo kategori çështjesh dhe kryerja e veprimeve të nevojshme procedurale për shmangien e seancave joproduktive.

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik, rezulton te jetë gjeneruar numri i seancave gjyqësore për çdo kategori çështjesh, nga ku rezulton se: Numri i seancave gjyqësore për çdo kategori çështjesh është:

- (i) për kategorinë e çështjeve “*Penale themeli*”, është 1.3 (një presje tre) seanca gjyqësore.
- (ii) për kategorinë e çështjeve/kërkesave “*seanca paraprake*”, “*dërgim çështje në gjyq*” dhe “*pushim prcedimi penal*”, është 4.8 (katër presje tetë) seanca gjyqësore.
- (iii) për kategorinë e çështjeve «*familjare me palë kundërshtare*» 2.7 (dy presje shtatë) seanca gjyqësore.
- (iv) për kategorinë e çështjeve «*Civile me palë kundërshtare*» është 3 (tre) seanca gjyqësore.

Nga tërësia e burimeve të vlerësimit për këtë tregues, evidentohet se numri mesatar i seancave gjyqësore, për të gjitha çështjet me palë kundërshtare, rezulton të jetë **2,95 seanca gjyqësore**.

Nga vëzhgimi i dosjeve të çështjeve të përzgjedhura me short evidentohet se gjyqtarja ka kryer në mënyrë efektive veprimet për vënien në lëvizje të çështjes, ka mbikëqyrur si duhet dërgimin pa vonesë të njoftimeve, njoftimet janë të plota dhe të qarta për palët që u drejtohen, nuk konstatohet në asnjë rast mungesa e njoftimeve për palët dhe në çdo rast janë marrë masa

¹⁵⁹ Shih çështjen me numër rëndor 60, 74, 78, Tabela 10, viti 2017 dhe çështjen me numër rëndor 43, 51 Tabela 10 viti 2019.

efektive për të siguruar zhvillimin e seancave gjyqësore në kohë. Konstatohet nga aktet në dosjet burim vlerësimi se gjyqtarja për çdo çështje ka disponuar me urdhër ose vendim për caktimin e datës së shqyrtimit të çështjes, duke caktuar seancën e parë gjyqësore dhe duke pasqyruar në këtë akt urdhërimin e sekretarisë gjyqësore për kryerjen e njoftimeve të palëve ndërgjyqëse, sipas kriterëve të parashikuara në K.Pr.Civile, si dhe duke përcaktuar provat që do të shqyrtohen në gjykim apo sipas K.Pr.P në çështjet penale, duke urdhëruar kryerjen e njoftimeve për palët dhe marrjen e masave për të siguruar prezencën apo shoqërimin e të pandehurve.

Seancat përgjithësisht janë shtyrë për shkaqe të ndryshme procedurale të tilla si: *për t'i dhënë kohë ekspertit për realizimin e aktit të ekspertimit, për të garantuar të drejtën e mbrojtjes së palës me avokat, për përsëritjen e njoftimeve në rastet kur ato kanë rezultuar se nuk janë kthyer, për të mundësuar prezencën në seancë të prokurorit ose mbrojtësit, për shkaqe objektive që lidhen me kushtet klimaterike, për t'i dhënë kohë palëve për tu njohur me aktet, për marrjen e informacioneve nga të tretët, për shkak të grevës së avokatëve, për t'u dhënë kohë palëve të njihen me aktin e ekspertimit, përgatitjen e konkluzioneve përfundimtare me shkrim nga palët, etj.*

Pra, në tërësi, shtyrjet e seancave gjyqësore kanë qenë për shkaqe objektive, të pavarura nga veprimet e gjyqtarës së çështjes, si dhe për të kryer veprimet e nevojshme procedurale me qëllim zhvillimin e një procesi të rregullt ligjor dhe respektimin e të drejtave procedurale të palëve dhe pjesëmarrësve në gjykim.

Vetëm në një rast evidentohet që seanca paraprake gjyqësore të mos jetë çelur për shkak të mos formimit të trupit gjykues, por në këtë rast, për shkak të përkeqësimit të motit dhe rreshjeve të shumta dhe përmytjeve në zonën e Lezhës, nuk është paraqitur asnjë nga palët ¹⁶⁰. Pra, mungesa e gjyqtarës në zhvillimin e seancës përgatitore nuk ka sjellë pasoja. Në rastet kur palët, përfaqësuesit e tyre apo organi i akuzës janë bërë shkak për zvarritjen e gjykimit, gjyqtarja ka marrë masat për zhvillimin e seancave produktive duke njoftuar organin e akuzës për marrjen e masave për zëvendësimin e prokurorit.

Caktimi i seancës së parë gjyqësore në ato raste kur parashikohet një detyrim ligjor për t'u respektuar (si afat maksimal), rezulton që gjyqtarja nuk e ka respektuar afatin vetëm në çështjet gjyqësore që kanë përfunduar me vendimin nr. 135 datë 07.03.2018, vendimin nr. 32 datë 04.12.2017 dhe vendimin nr. 414 datë 22.10.2019. Sipas raportit analitik në çështjet e kategorisë seancë paraprake, referuar vendimit për kalimin e çështjes për shqyrtim, rezulton që gjyqtarja ka caktuar datën e seancës së parë gjyqësore jashtë afatit ligjor 10 ditor të parashikuar në dispozitë neni 332/2 i K.Pr.Penale, por nga ana e gjyqtarës në vendimin e arsyetuar tek pjesa e procedurës është arsyetuar tejkalimi i këtij afati për shkak të kolizionit ndërmjet dispozitave, nenit 332/2 dhe 332/a pika 3 e K.Pr.Penale të ndryshuar¹⁶¹. Përgjithësisht, rezulton se seancat gjyqësore janë shtyrë brenda një afati në maksimum prej 7-30 ditësh nga njëra – tjetra në çështjet civile/familjare dhe deri në 14 ditë, konform nenit 342/2 të K.Pr.Penale, në çështjet penale. Vetëm në disa raste konstatohet lënia në një kohë të gjatë e seancës, për shkak të lejes vjetore në muajin gusht, apo në fund të vitit, periudhë që përkon me procedurën e mbartjeve të dosjeve nga administrata.

¹⁶⁰ Shih çështjen që i përket vendimit nr. 135 datë 07.03.2018

¹⁶¹ Raporti analitik, faqe 55

KONKLZIONI

Bazuar në sa parashtrohet më sipër, për treguesin “Numri mesatar i seancave gjyqësore për çdo çështje dhe kryerja e veprimeve të nevojshme procedurale për shmangien e atyre joproductive”, duke iu referuar të dhënave që rezultojnë nga vëzhgimi i çështjeve me palë kundërshtare të përzgjedhura me short, rezulton se numri mesatar i seancave gjyqësore është 2,95 seanca dhe në çdo rast gjyqtarja ka marrë masat e nevojshme për shmangien e seancave joproductive, për planifikimin dhe zhvillimin në kohë dhe me efektivitet të seancave, shkalla e aftësisë duhet të vlerësohet në nivel maksimal, duke e pikëzuar me 15 pikë.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, në lidhje me treguesin “Numri mesatar i seancave për çdo çështje dhe kryerja e veprimeve të nevojshme procedurale për shmangien e atyre joproductive”, vlerësohet se aftësia e gjyqtarës është “shumë e lartë” dhe pikëzohet me 15 pikë.

2.B.b Kryerja e veprimeve të nevojshme procedurale për organizimin e procesit gjyqësor.

Referuar Raportit Analitik dhe dosjeve të përzgjedhura për vlerësim, rezulton se gjyqtarja në përgjithësi ka vënë në lëvizje çështjet duke marrë vendim për caktimin e seancës përgatitore dhe/ose gjyqësore pas caktimit të çështjes me short duke iu referuar rregullave dhe gjykimit sipas kategorive të çështjeve. Konkretisht në çështjet civile gjykata është shprehur me vendim si për njoftimin e akteve dhe kërkesë padisë palëve të paditura konform nenit 158 të ndryshuar të K.Pr.Civile në funksion të lëshimit të deklaratës së mbrojtjes, por njëkohësisht edhe për kalimin e çështjes në seancë përgatitore (*neni 158/b i K.Pr.Civile*) e në vijim pas ezaurimit të seancës përgatitore edhe nxjerrjen e urdhrin për kalimin e çështjes në seancë gjyqësore (*neni 158/ç të K.Pr.Civile*). Në çështjet penale, konstatohet se gjithmonë gjykata ka vënë dosjen në lëvizje sikundër parashikohet në nenin 332 të K.Pr.Penale për çështjet e kategorisë seancë paraprake me objekt dërgimin e çështjes në gjyq, ndërkohë në çështjet penale të themelit në respektim të nenit 333/1 të K.Pr.Penale.

Në çështjet e përzgjedhura me short, gjyqtarja jo vetëm i ka vënë në lëvizje dosjet në kohë dhe në përputhje me kërkesat dhe afatet ligjore duke caktuar seancën, por duke treguar edhe kujdesin maksimal për marrjen e masave për njoftimin e palëve me qëllim zhvillimin e seancave gjyqësore efektive. Gjithashtu, rezulton se të gjitha veprimet procedurale gjatë shqyrtimit gjyqësor janë të dokumentuara. Drejtimi i procesit gjyqësor ka qenë i rregullt sipas kërkesave procedurale të parashikuara në ligj për gjykimin në shkallë të parë si në çështjet civile (*nenet 171 e vijues të K.Pr.Civile*) ashtu edhe në çështjet penale (*nenet 341 e vijues të K.Pr.Penale*) apo sipas ritit të gjykimit të zhvilluar (*nenit 405 e vijues të K.Pr.Penale në rastin e gjykimit të shkurtuar*), apo sipas ritit të gjykimeve të seancave paraprake (*neni 332/c i K.Pr.Penale i ndryshuar me ligjin nr. 35/2017*).

Gjatë zhvillimit të gjykimit, gjyqtarja tregon kujdes të posaçëm për verifikimin e paraqitjes së palëve, mbrojtësve, relativin e akteve të njoftimit të tyre, shkaqeve të mosparaqitjes së palëve ose pjesëmarrësve, marrjen e mendimit të palëve në çdo rast lidhur me ecurinë e

gjkimit, zhvillimin e gjykimit në mungesë të të pandehurit apo të paditurve, shpalljen e gjykatës, dëgjimin e kërkesave paraprake të palëve, shqyrtimin dhe vendimmarrjen e arsyetuar të gjykatës mbi këto kërkesa, zhvillimin e shqyrtimit gjyqësor sipas llojit të procesit të zhvilluar, dhënien e fjalës palëve për parashtrimin dhe paraqitjen e fakteve dhe të provave, shtyrjen e seancave gjyqësore duke pasqyruar shkakun në çdo rast si dhe urdhërimet për marrjen e masave për zhvillimin e seancës vijuese (*njoftimin e palëve, kryerjen e komunikimit me institucionet e tjera, etj*). Drejtimi i seancës zhvillohet në përgjithësi nëpërmjet urdhrave dhe vendimeve të ndërmjetme të cilat janë të shoqëruara me bazën ligjore përkatëse të tyre, si dhe me arsyet e vendimmarrjes. Gjithashtu rezulton që gjykata ka disponuar me vendime të ndërmjetme mbi çdo kërkesë të parashtruar nga palët në gjykim apo edhe vendimet e ndërmjetme të marra kryesisht si ato për marrjen e provave nga të tretë apo kryerjen e aktit të ekspertimit teknik.

Në dosje te vëzhguara, seancat e planifikuara janë çelur relativisht në kohë, por edhe në vonesa të cilat variojnë nga 5 minuta deri në 60 minuta vonesë, dhe gjithashtu rezulton që të relatohej shkakun nga ana e gjyqtarës në lidhje me shkaqet e fillimit të seancave me vonesë, kryesisht për shkak të gjykimeve të mëparshme. Pavarësisht kësaj, nuk ka rezultuar në asnjë rast që vonesa të jetë bërë shkak për moszhvillimin e seancës gjyqësore.

Seancat gjyqësore të zhvilluara në çështjet e vëzhguara janë dokumentuar në procesverbalin e seancës gjyqësore, mbajtur me regjistrim audio si dhe dokumentohen me shkrim nga sekretarja gjyqësore.

KONKLuzioni

Në tërësi, referuar të dhënave të pasqyruara në Raportin Analitik dhe burimeve të vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtarja ka kryer me efikasitet veprimet procedurale për organizimin dhe zhvillimin e procesit gjyqësor, duke respektuar afatet procedurale për zhvillimin e tyre, si dhe duke marrë të gjitha masat për zhvillimin e gjykimit në kohë duke respektuar të drejtat e palëve ndërgjyqëse.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, shkalla e aftësisë së gjyqtarës në treguesin "Kryerja e veprimeve të nevojshme procedurale për organizimin e procesit gjyqësor" vlerësohet "Shumë e lartë" dhe pikëzohet me 20 pikë.

2.C AFTËSIA E GJYQTARIT PËR TË ADMINISTRUAR DOSJEN GJYQËSORE.

2.C.a Rregullshmëria e dokumentacionit të dosjes.

Nga analiza e burimeve të vlerësimit, të pasqyruara në Raportin Analitik, rezulton se aktet e dosjeve janë renditur në mënyrë të rregullt dhe duke ndjekur përgjithësisht, të njëjtën radhë të renditjes së dokumenteve. Pavarësisht se nuk ka një rregullim që të përcaktojë në mënyrë të shprehur mënyrën e renditjes së akteve në dosjen gjyqësore, renditja duhet të jetë e tillë që të lehtësojë aksesimin e saj. Në këtë kuptim përgjithësisht renditja ka filluar me aktet që kanë vënë në lëvizje gjykatën, aktet e paraqitura nga palët para fillimit të seancave, veprimet dhe

vendimmarrjet e gjykatës gjatë veprimeve paraprake, nëse ka. Më pas kalohet tek procesverbalet, parashtrimet e palëve etj. gjithmonë sipas datës së zhvillimit të seancës. Në rastin konkret renditja sipas llojit të akteve procedurale por e ndërthurur kjo edhe me veprimet procedurale të kryera nga gjyqtari gjatë gjykimit, është dhe konsiderohet si një mënyrë që e bën të lehtë dhe të aksesueshme dosjen. Brenda kategorisë, aktet renditen sipas datave (*njoftimet, shkresat, procesverbalet e seancave*). Dosjet paraqiten të rregullta në aspektin formal të tyre, aktet janë të numërtuara dhe mund të shfrytëzohen pa asnjë vështirësi.

Duke iu referuar burimeve të vlerësimit, rezulton se renditja e akteve në dosje, e cila është përgjithësisht e njëjtë dhe ndjek rendin kronologjik, është bërë në mënyrë të tillë që ta bëjë dosjen gjyqësore lehtësisht të aksesueshme. Dosjet paraqiten të rregullta në aspektin formal të tyre, aktet janë të numërtuara dhe mund të shfrytëzohen me lehtësi.

KONKLuzioni

Në tërësi, rezulton se renditja e akteve në dosje, e cila është përgjithësisht e njëjtë dhe ndjek rendin logjik (sipas kategorisë) dhe kronologjike (brenda së njëjtës kategori aktesh), është bërë në mënyrë të tillë që ta bëjë dosjen gjyqësore lehtësisht të aksesueshme. Dosjet paraqiten të rregullta në aspektin formal të tyre, aktet janë të numërtuar dhe mund të shfrytëzohen me lehtësi.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Bazuar në sa parashtrohet më sipër, shkalla e aftësisë së gjyqtarës në treguesin “Rregullshmëria e dokumentacionit të dosjes” vlerësohet “shumë e lartë” dhe pikëzohet me 5 pikë.

2.C.b Saktësia dhe plotësia e dokumentacionit të dosjes.

Nga analiza e burimeve të vlerësimit, të pasqyruara në Raportin Analitik rezulton se në dosjet e përzgjedhura me short, ndodhen të gjitha aktet e hartuara nga gjykata (*njoftimet për çdo veprim apo seancë, procesverbalet e çdo seance përgatitore apo gjyqësore, vendimet për caktimin e seancave gjyqësore, vendimet e ndërmjetme të arsyetuara, vendimet gjyqësore*) si dhe aktet e paraqitura nga palët (*kërkesë padia, provat dhe diskutimet përfundimtare të palëve*). Nuk rezultojnë mungesa të dokumentacionit në dosjet e vëzhguara apo prania e akteve dhe dokumenteve që nuk i përkasin çështjes konkrete.

KONKLuzioni

Duke iu referuar burimeve të vlerësimit, rezulton se gjyqtarja ka shkallë shumë të lartë aftësie në këtë tregues. Në dosjet e vëzhguara nuk rezultojnë mungesa të dokumentacionit në dosjet e vëzhguara, apo prania e akteve apo dokumenteve që nuk i përkasin çështjes konkrete.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtarës për këtë tregues vlerësohet “Shumë e lartë” dhe pikëzohet me 10 pikë.

Niveli i vlerësimit	
KRITERI	
AFTËSITË ORGANIZATIVE TË GJYQTARES	
Pikët	Niveli i vlerësimit
100	Shkëlqyeshëm

3. ETIKA DHE ANGAZHIMI NDAJ VLERAVE PROFESIONALE

Vlerësimi i kriterit të etikës dhe angazhimit ndaj vlerave profesionale bëhet duke u bazuar në parimin kushtetues që çdo gjyqtar, për shkak të statusit të tij, ka etikë, integritet dhe shfaq paanësi në funksion. Pikëzimi për shumicën e treguesve të këtij kriteri bëhet në rend zbritës dhe çdo gjyqtar e fillon procesin e vlerësimit me totalin e pikëve referuar treguesit përkatës, duke zbritur sipas rastit pikët, në varësi të rezultateve të analizës objektive të të dhënave të burimeve të vlerësimit.

3.A ETIKA NË PUNË

3.A.a Angazhimi dhe përgjegjshmëria në funksion.

Nga analiza e burimeve të vlerësimit, të pasqyruara në Raportin Analitik, në lidhje me të dhënat që mund të tregojnë cenimin e etikës apo përgjegjshmërisë në funksion të gjyqtarës u konstatuan këto të dhëna:

Referuar informacionit të përcjellë prej Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, rezultojnë se ndaj gjyqtarës {...} në periudhën e vlerësimit 2017-2019 rezultojnë se janë paraqitur 4 ankesa. Konkretisht :

- (i) **Ankues Aleks Shtjefni**, depozituar ankesa pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor me nr. 2771 prot, datë 03.10.2018 dhe rregjistruar pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë me nr. 1460 prot datë 23.02.2021. Me shkresën me nr.103/2 prot., datë 14.06.2022 Inspektori i Lartë i Drejtësisë me vendimin nr.1460/4 prot., datë 31.01.2022 “Për arkivimin pas shqyrtimit fillestar të ankesës së paraqitur nga shtetasi z. Aleks Shtjefeni”, ka vendosur arkivimin e ankesës.
- (ii) **Ankues Nikoll Palokaj**, depozituar ankesa pranë ish Këshillit të Lartë të Drejtësisë me nr. 1686 prot, datë 04.05.2017 dhe rregjistruar pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë me nr. 1296 prot datë 22.02.2020. Me shkresën me nr.1907/2 prot., datë 05.10.2022 Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka sqaruar se praktika e përcjellë nga ish Këshilli i Lartë i Drejtësisë ka vetëm shkresën N-13/3 prot., datë 02.05.2017 me lëndë “Kthim-Përgjigje” të Drejtorisë së Përgjithshme të Planifikimit Strategjik dhe Inspektimit të Çështjeve të Drejtësisë në Ministrinë e Drejtësisë (fletë 2). Pas shqyrtimit të kësaj praktike, Inspektori i Lartë i Drejtësisë, referuar memo-s nr.800 prot., datë

06.04.2020 ka vendosur *mostrajtimin e saj si ankesë, duke e arkivuar në protokoll*, për shkak të mospërmbushjes së kriterëve të parashikuara në ligjin nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

(iii) **Ankues Valentin Macaj**, depozituar ankesa pranë ish Këshillit të Lartë të Drejtësisë me nr. 3259 prot, datë 13.11.2018 dhe rregjistruar pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë me nr. 710 prot datë 09.02.2021. Me shkresën me nr.103/2 prot., datë 14.06.2022 Inspektori i Lartë i Drejtësisë me vendimin nr.793 prot., datë 05.04.2022 “Për arkivimin pas shqyrtimit fillestar të ankesës së paraqitur nga shtetasi z. Valentin Macaj”, ka vendosur arkivimin e ankesës.

(iv) **Ankues Geg Peplokaj**, depozituar ankesa pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor me nr. 3068 prot, datë 06.06.2019 dhe rregjistruar pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë me nr. 1210 prot datë 17.06.2020. Me shkresën me nr.103/1 prot., datë 26.01.2022 Inspektori i Lartë i Drejtësisë me vendimin nr.1210/4 prot., datë 17.11.2020 “Për arkivimin pas shqyrtimit fillestar të ankesës së paraqitur nga shtetasi z. Gegë Peplokaj”, ka vendosur arkivimin e ankesës. Pas ankimimit të vendimit të mësipërm nga shtetasi Gegë Përlokaj rezulton se Komisioni i Përkohshëm për shqyrtimin e ankimeve kundër Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për arkivimin e ankimit ose pushimin e hetimit ndaj një gjyqtari pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor ka disponuar me vendimin nr.19, datë 13.01.2021: “Për refuzimin e ankimit të shtetasit Gegë Përlokaj kundër vendimit nr.1240/4, datë 17.11.2020 të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”.

Sa i takon masave disiplinore, rezulton se për periudhën 01.01.2017- 31.12.2019, për gjyqtaren {...}, nuk është dhënë asnjë e tillë.

Nga aktet e trajtimit të ankesave të dërguara nga ILD nuk rezultojnë të dhëna të drejtpërdrejta apo të tërthorta të cilat mund të vlerësohen në drejtim të treguesve të kriterit të etikës dhe angazhimit ndaj vlerave profesionale të gjyqtarës {...}.

Gjyqtarja dhe kryetari gjykatës në Formularin e Integruar të Vlerësimit i kanë vlerësuar shumë të larta aftësitë e gjyqtarës në drejtim të angazhimit dhe përgjegjshmërisë në funksion.

Në mungesë të të dhënave të dala nga burimet e vlerësimit deri në momentin e hartimit të projektraportit të vlerësimit, prej relatores ky tregues i shkallës së angazhimit dhe përgjegjshmërisë në funksion, ishte vlerësuar si “shkallë shumë e lartë aftësie”, duke u pikëzuar pikëzimi me 35 pikë.

Referuar neni 94 të Ligjit Nr.96/2016 “Për statusin”, gjyqtari ka të drejtë të paraqesë kundërshtime me shkrim për projektraportin e vlerësimit, si dhe të paraqesë prova të reja, me përjashtim të vendimeve gjyqësore të hartuara prej tij. Gjithashtu, ai ka të drejtë të dëgjohet në seancë. Këshilli, bazuar edhe në kundërshtimet e magjistratit si dhe provat e paraqitura prej tij, të cilët janë burim vlerësimi dhe bëhen pjesë e dosjes së vlerësimit, vendos të miratojë ose të miratojë me ndryshimet përkatëse projektraporti e vlerësimit të hartuar nga relatori apo mund t’i kërkojë relatorit hartimin e një projektraporti të ri vlerësimi.

Në rastin konkret, gjyqtarja kishte paraqitur kundërshtime me shkrim lidhur me projektraportin, të depozituar brenda afatit 15 ditorë, të cilat u shqyrtuan në seancë plenare.

Në zbatim të nenit 77 shkronja “g” të Ligjit për Statusin, kundërshtimet e gjyqtarës përbëjnë burim të pavarur vlerësimi, në kuptimin që, nëse prej tyre Këshilli në mbledhje plenare,

vlerëson në menyrë të ndryshme nga propozimi i relatorit, nuk ka pengese ta pasqyrojë qëndrimin e tij në raportin përfundimtar të vlerësimit. Bazuar në gjuhën e përdorur nga gjyqtarja në paraqitjen e kundërshtimeve të saj ndaj projektraportit të vlerësimit, Këshilli vlerësoi se prej tyre rezultonin të dhëna që afektonin këtë kriter, konkretisht “shkallën e angazhimit dhe përgjegjshmërisë në funksion”.

Në kundërshtimet e saj gjyqtarja, shprehte vlerësim të ndryshëm nga konkluzionet e projektraportit të vlerësimit, duke përdorur një gjuhë fyese, ofenduese e akuzuese ndaj relatores së procedurës, duke atakuar personalisht atë për mosnjohje të ligjit, mostrajtim të njëjtë me gjyqtarët e tjerë...etj. Disa nga shprehjet e përdorura nga ana e gjyqtares janë : *“...nuk e kuptoj se si mund të anashkalohej e gjithë puna e bërë nga ana ime dhe mbi të gjitha është e paqartë se si relatorja ka vlerësuar gjyqtarët e tjerë shkëlqyeshëm në këtë rubrikë. A është e mundur se çdo gjyqtar tjetër që është vlerësuar prej saj të ketë qenë perfekt në aftësitë profesionale në çdo vendim objekt vlerësimi?nuk e di se ku e ka bazuar këtë konkluzion relatorja, ndoshta kjo pjesë ka ngelur nga ndonjë projektraport i ndonjë gjyqtari tjetër.....nuk mund të bëhet ndarja në paragrafë domosdoshmërisht sepse relatorja çmon se mund të jetë pak më i gjatë një paragraf në një moment të caktuar.....elementët e konstatuar nga relatorja janë të nxituara.....mendoj se nëse do të kishte pasur raste të tjera, nuk do të ishin kursyer nga ana e relatores.....”*.

Në Metodologjinë e Pikëzimit, për përcaktimin e nivelit të pikëzimit për këtë tregues përcaktohet se: *“Etika në punë, me qëllim vlerësimin e angazhimit dhe përgjegjshmërisë në funksion, nënkupton sjelljen e kujdesshme, objektive, me vetëpërmbytje dhe maturi të gjyqtarit gjatë ushtrimit të detyrës, në mënyrë korrekte, të ndërjegjshme, sistematike dhe në kohë të arsyeshme.*

Përmbytja e këtij detyrimi profesional kërkon që gjyqtari në ushtrimin e detyrës duhet të tregojë dhe të provojë se në mënyrë të ndërjegjshme dhe me vërtetësi, shmang çdo sjellje që tregon mungesë respekti, vetëpërmbytjeje, ndjeshmërie, vëmendjeje apo qasje të papërshtatshme dhe ofensive, duke mos u kufizuar vetëm në shmangien e sjelljeve që formalisht kualifikohen si në kundërshtim me ligjin.”

Këshilli pasi shqyrtoi përmbajtjen e kundërshtimeve me shkrim të paraqitura nga gjyqtarja, vlerësoi se gjuha e përdorur prej saj në këto kundërshtime është jo etike, çka tregon mungesë respekti ndaj vlerësuesit, mungesë vetëpërmbytjeje, dhe qasje ofensive ndaj vlerësuesve. Pasur parasysh këtë sjellje të gjyqtares gjatë procedurës së vlerësimit, në raport edhe me burimet e tjera të vlerësimit nga ku nuk kanë rezultuar të dhëna të drejtpërdrejta apo të tërthorta të cilat mund të vlerësohen në drejtim të treguesve të kriterit të etikës dhe angazhimit ndaj vlerave profesionale të gjyqtares, Këshilli vlerësoi sipas parimit të proporcionalitetit se aftësia e saj për këtë tregues është e shkallës “Mbi mesatare”.

KONKLUZIONI

Në tërësi, referuar të dhënave të mësipërme që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, në zbatim të parimit të objektivitetit dhe proporcionalitetit, shkalla e etikës në punë të treguar nga gjyqtarja vlerësohet “mbi mesatare” duke u pikëzuar me 28 pikë.

Shkalla e etikës në punë të gjyqtarit dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, shkalla e etikës së gjyqtarit në lidhje me treguesin “angazhimi dhe përgjegjshmëria në funksion” është “mbi mesatare” duke u pikëzuar me 28 pikë.

3.B INTEGRITETI I GJYQTARIT

3.B.a Shmangia e shfaqjes së pahijshme, nderi dhe dinjteti.

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik, për periudhën 01.01.2017 - 31.12.2019, rezulton të jenë regjistruar pranë ILD-së 4 ankesa, për tre nga të cilat është disponuar për arkivimin e tyre, ndërsa për një prej tyre është disponuar për mostrajtimin e saj si ankesë.

Nga tërësia e fakteve të parashtruar dhe të analizuar në vendimin e ILD, nuk rezultojnë të dhëna për cenim të etikës apo elementë të tjerë që ndikojnë në vlerësimin etik dhe profesional të gjyqtares, si dhe nuk rezulton asnjë e dhënë apo indicie që të dëshmojë shfaqjen e sjelljeve që tregojnë mungesë integriteti të gjyqtares, shfaqje të pahijshme, shfaqje që çenojnë nderin, dinjtetin dhe pritshmërinë e publikut.

Gjithashtu, nuk rezulton që ndaj gjyqtares {...}, gjatë periudhës së vlerësimit të jetë dhënë apo zbatuar ndonjë masë disiplinore.

Referuar raportit të ILDKPKI, përcjellë pranë KLGJ me shkresën nr. 2807/1 prot., datë 09.07.2021, rezulton se: “Në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera, në përputhje me ligjin nr. 9049, datë 10.04.2003 “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar, ligjin nr. 9367, datë 07.04.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar dhe ligjin nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtareve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, konstatohet se për gjyqtaren.....: {...}: a) Deklaratat e interesave private periodike/vjetore 2017-2020 janë dorëzuar brenda afateve ligjore; b) Gjatë kontrollit u konstatua se deklaratat e interesave private janë plotësuar në përputhje me kërkesat e ligjit; c) Nga kontrolli i ushtruar nuk u verifikuan raste të konfliktit të interesave”.

Gjyqtarja dhe kryetarja e gjykatës, lidhur me këtë tregues, e kanë vlerësuar aftësinë e gjyqtares në nivel shumë të lartë.

Nga tërësia e burimeve të vlerësimit nuk rezulton asnjë e dhënë apo indicie që të dëshmojë për ekzistencën e shfaqjeve të pahijshme, cenim të nderit dhe dinjtetit të gjyqtarit, shfaqjen e sjelljeve që tregojnë favor ose disfavor në lidhje me çështjet në gjykim, apo çdo sjellje tjetër që mund të cenojë integritetin e gjyqtares.

KONKLUZIONI

Për sa më sipër, referuar parimit të prezumimit dhe përcaktimeve të Metodologjisë së Pikëzimit lidhur me këtë tregues, në mungesë të të dhënave që mund të tregojnë për cenim të integritetit të gjyqtarit, vlerësoj se gjyqtarja duhet të pikëzohet me pikët maksimale për këtë tregues, pasi prezumohet se ka shmangur plotësisht shfaqjen e sjelljeve të pahijshme, apo sjelljeve që cenojnë nderin dhe dinjitetin e gjyqtarit.

Shkalla e integritetit të gjyqtarit dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, vlerësohet se shkalla e integritetit të gjyqtares në lidhje me treguesin “Shmangia e sjelljeve të pahijshme, nderi dhe dinjiteti” është “Shumë e lartë” dhe pikëzohet me 40 pikë.

3.C PAANËSIA E GJYQTARIT

3.C.a Përdorimi ose jo i gjuhës diskriminuese.

Nga analiza e burimeve të vlerësimit pasqyruar në Raportin Analitik, nuk rezulton në asnjë rast përdorimi i gjuhës diskriminuese nga gjyqtarja në komunikimin me palët ndërgjyqëse gjatë zhvillimit të seancave, apo në përmbajtje të vendimeve përfundimtare të saj. Gjithashtu, nuk ka asnjë të dhënë për përdorim të gjuhës diskriminuese me të tretët, referuar komunikimit shkresor, akteve të administruara në dosjet e gjykimit, si dhe të dhënave nga vetëvlerësimi i gjyqtares.

Gjyqtarja lidhur me këtë tregues, e ka vlerësuar aftësinë e saj në nivelin shumë të lartë.

KONKLUZIONI

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtarja në asnjë rast nuk ka përdorur gjuhë diskriminuese, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, në komunikimin me subjektet e procedimit ose në përmbajtjen e vendimeve të hartuara prej saj. Për këto arsye, për këtë tregues rezulton se gjyqtarja ka shkallë shumë të lartë të aftësisë për të shmangur përdorimin e gjuhës diskriminuese.

Shkalla e integritetit të gjyqtarit dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, vlerësohet se aftësia e gjyqtares në treguesin “Shmangia e përdorimit të gjuhës diskriminuese” është “Shumë e lartë”, dhe pikëzohet me 10 pikë.

3.C.b Numri tejet i lartë i kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e gjyqtarit.

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik, rezulton se për periudhën e vlerësimit 01.01.2017–31.12.2019, janë paraqitur 6 (gjashtë) kërkesa për përjashtimin e gjyqtares, nga të cilat është pranuar vetëm 1 (një) prej tyre. Po kështu, rezulton se edhe vetë

gjqtarja ka paraqitur 59 (pesëdhjetë e nëntë) kërkesa për heqje dorë, nga të cilat nuk është pranuar vetëm 1 (një).

Gjqtarja dhe kryetarja e gjykatës e kanë vlerësuar numrin e kërkesa të pranuar për përjashtim si të pakonsiderueshëm. Gjyqtarja parashtron se në kushtet kur gjatë periudhës së vlerësimit ka gjykuar 1498 çështje, numri i kërkesave të pranuar për përjashtimin e saj është 4, dhe duhet të vlerësohet i pa konsiderueshëm. Kryetarja e gjykatës po ashtu ka parashtruar se kërkesat për dorëheqje janë paraqitur nga gjyqtarja menjëherë me evidentimin e shkakut dhe nuk kanë sjellë vonesa për gjykimin, janë të arsyetuara dhe argumentuara dhe në shumicën e rasteve janë miratuar nga ana e saj.

KONKLUZIONI

Sa më sipër, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, vlerësoj se numri i kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e gjyqtarës është “I pakonsiderueshëm”, duke qenë se gjatë kësaj periudhe vlerësimi, nga 6 kërkesa të paraqitura për përjashtimin e saj është pranuar vetëm 1 prej tyre.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, për treguesin “Numri tejet i lartë i kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e gjyqtarit”, vlerësohet se ky numër është “I pakonsiderueshëm”, dhe pikëzohet me 15 pikë.

Niveli i vlerësimit KRITERI ETIKA DHE ANGAZHIMI NDAJ VLERA VE PROFESIONALE	
Pikët	Niveli i vlerësimit
93	Shkëlqyeshëm

4. AFTËSITË PERSONALE DHE ANGAZHIMI PROFESIONAL

Në këtë kriter vlerësohet kapaciteti personal dhe angazhimi profesional i gjyqtarës në drejtim të aftësive të komunikimit, bashkëpunimit dhe angazhimit ndaj vlerave profesionale.

4.A AFTËSIA E KOMUNIKIMIT.

4.A.a Komunikimi i qartë dhe transparent.

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik, rezulton se gjyqtarja, gjatë komunikimit me palët dhe pjesëmarrësit në proces është e qartë dhe transparente. Gjithashtu evidentohet komunikim i qartë, i saktë dhe konciz gjatë zhvillimit të seancave gjyqësore duke e bërë procesin të kuptueshëm për palët dhe pjesëmarrësit në të. Të njëjtat cilësi rezultojnë edhe në arsyetimin e vendimeve përfundimtare ku gjuha e përdorur është e

thjeshtë, e kuptueshme, e qartë dhe drejtpërdrejtë. Në raportin analitik, referuar burimeve të vlerësimi, evidentohet gjuha e thjeshtë dhe të drejtëpërdrejtë. I njëjti konstatim rezulton edhe nga aktet e dosjeve të përzgjedhura me short, përfshirë këtu regjistrimet e seancave me mjete audio.

Në aktet shkresore drejtuar të tretëve është përdorur gjuhë e drejtpërdrejtë, e saktë dhe e kuptueshme, duke respektuar normat e komunikimit zyrtar.

Gjyqtarja dhe kryetarja e gjykatës, lidhur me këtë tregues, e kanë vlerësuar aftësinë e gjyqtarës në nivel shumë të lartë.

KONKLuzioni

Në tërësi, nga analiza e integruar e burimeve të vlerësimit, rezulton se gjyqtarja në çdo rast komunikon në mënyrë të qartë dhe transparente me palët dhe pjesëmarrësit në proces, duke treguar kujdes të jetë e qartë, e drejtpërdrejtë dhe e kuptueshme.

***Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi:** Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, vlerësohet se shkalla e aftësisë së gjyqtarës në lidhje me treguesin “Komunikimi i qartë dhe transparent” është “Shumë e lartë”, dhe pikëzohet me 25 pikë.*

4.A.b Respektimi i konfidencialitetit dhe mbrojtjes së të dhënave personale.

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik, nuk konstatohet që gjyqtarja të ketë ceduar në ruajtjen e konfidencialitetit dhe mbrojtjes së të dhënave personale në lidhje me informacionet dhe të dhënat për të cilat ajo është në dijeni për shkak të funksionit. I njëjti konstatim rezulton edhe nga aktet e dosjeve të përzgjedhura me short, përfshirë këtu regjistrimet e seancave me mjete audio.

KONKLuzioni

Në tërësi, nga analiza e integruar e burimeve të vlerësimit, rezulton se gjyqtarja në çdo rast ka respektuar konfidencialitetin dhe të dhënat personale të palëve duke treguar aftësi të larta në drejtim të këtij treguesi.

***Respektimi i konfidencialitetit nga gjyqtarja dhe pikëzimi:** Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, vlerësohet se shkalla e aftësisë së gjyqtarës në lidhje me treguesin “Respektimi i konfidencialitetit dhe mbrojtjes së të dhënave personale” është “E lartë”, dhe pikëzohet me 15 pikë.*

4.B AFTËSIA PËR TË BASHKËPUNUAR.

4.B.a Shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit me kolegët, duke përfshirë shkëmbimin e njohurive dhe përvojës profesionale me ta.

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik, nuk rezultojnë asnjë e dhënë ose indicie për mungesë të bashkëpunimit të gjyqtarëve me kolegët, gjatë periudhës së vlerësimit. Nga rezultatet e verifikimit të ankesave nga ana e ILD nuk ka asnjë të dhënë burimore që mund të vlerësohet në drejtim të këtij treguesi.

Gjyqtarja dhe kryetarja e gjykatës e kanë vlerësuar maksimalisht këtë tregues, duke evidentuar se shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit të saj me kolegët është në nivel maksimal, duke përfshirë shkëmbimin e njohurive dhe përvojës profesionale dhe përfshirjen në diskutime ligjore.

KONKLUZIONI

Në tërësi, nga të dhënat që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, rezultojnë se shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit me kolegët, si dhe shkëmbimi i njohurive dhe përvojës profesionale me ta, është shumë e lartë.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarëve dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, vlerësohet se shkalla e aftësisë së gjyqtarëve në lidhje me treguesin “Shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit me kolegët, duke përfshirë shkëmbimin e njohurive dhe përvojës profesionale me ta” është “Shumë e lartë”, dhe pikëzohet me 15 pikë.

4.B.b Shkalla e komunikimit dhe e bashkëpunimit me administratën gjyqësore.

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik nuk rezultojnë të dhëna që negative për shkallën e komunikimit dhe bashkëpunimit me administratën gjyqësore, ndërkohë që gjyqtarja dhe kryetarja e gjykatës e kanë vlerësuar këtë tregues në nivel shumë të lartë, duke parashtruar se gjyqtarja "...ka treguar në vazhdimësi aftësi shumë të lartë në komunikimin dhe bashkëpunimin me administratën gjyqësore, duke propozuar dhe nxitur për përmirësimin e praktikave administrative për rritjen e aksesit dhe transparencës në gjykatë, dhe realizimin e projekteve të ndryshme. Kjo aftësi është shumë e dukshme dhe gjatë ushtrimit të detyrës së zv.kryetares së gjykatës, gjatë diskutimeve me grupe të vogla të administratës në varësi të problematikës apo situatës. Në cdo rast gjyqtarja ka qënë shumë bashkëpunuese duke krijuar ambient pune harmonik dhe produktiv për administratën".

KONKLUZIONI

Në tërësi, nga të dhënat që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, rezultojnë se shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit me administratën gjyqësore është shumë e lartë.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, vlerësohet se shkalla e aftësisë së gjyqtarëve në treguesin “Shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit me administratën gjyqësore” është “Shumë e lartë”, dhe pikëzohet me 10 pikë.

4.C GATISHMËRIA E GJYQTARES PËR T'U ANGAZHUAR NË VEPRIMTARI TË TJERA.

4.C.a Pjesëmarrja e gjyqtares në programet e formimit vazhdues të Shkollës së Magjistraturës dhe në trajnime të tjera profesionale.

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik, rezulton se gjyqtarja {...}, gjatë periudhës së vlerësimit 01.01.2017-31.12.2019, ka marrë pjesë në Programin e Trajnimit Vazhdues të Shkollës së Magjistraturës në cilësinë e pjesëmarrëses. Konkretisht, rezulton se gjyqtarja {...} është angazhuar në aktivitete trajnuese si më poshtë:

- (i) Në cilësinë e pjesëmarrëses në Programin e Formimit Vazhdues në 24 (njëzet e katër) aktivitete trajnuese të zhvilluara në gjithë periudhën e vlerësimit (nga data 23.01.2017 deri në datë 4-5 dhjetor 2019), gjithsej 39 ditë trajnimi.

Duke iu referuar nenit 55, pika 9¹⁶² të Rregullores së Shkollës së Magjistraturës, pjesëmarrja në programimin e trajnimit vazhdues në cilësinë e ekspertit ose lehtësuesit ka vlerë edhe për efekt të përmbushjes së detyrimit për ndjekjen e programit të trajnimit vazhdues, duke u përlllogaritur 1 ditë pjesëmarrje si ekspert e barabartë me 2.5 ditë si pjesëmarrës dhe 1 ditë pjesëmarrje si lehtësues me 2 ditë si pjesëmarrës. Referuar këtij parashikimi, rezulton se gjyqtarja {...}, gjatë periudhës trevjeçare të vlerësimit ka marrë pjesë në programin e formimit vazhdues të Shkollës së Magjistraturës për 39 (tridhjetë e nëntë) ditë në të gjithë periudhën e vlerësimit.

Për periudhën e vlerësimit nuk rezulton që gjyqtarja të ketë marrë pjesë në aktivitete profesionale jashtë programit të formimit vazhdues të Shkollës së Magjistraturës.

KONKLUZIONI

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtarja ka marrë pjesë në aktivitete trajnuese, kryesisht për tema që i përkasin të drejtës civile dhe penale, gjithsej 24 aktivitete të zhvilluara për 39 ditë, kohëzgjatje e cila është brenda kufijve 15 deri në 120 ditë në të gjithë periudhën tre vjeçare.

Pjesëmarrja e gjyqtares në trajnime dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, vlerësohet se pjesëmarrja e gjyqtares në aktivitetet trajnuese të Shkollës së Magjistraturës është brenda kufijve 15-120 ditë, dhe pikëzohet me 20 pikë.

¹⁶² Në nenin 55, pika 9 të Rregullores së Shkollës së Magjistraturës parashikohet se :”Për efekt të detyrimit ligjor për pjesëmarrje në aktivitetet e Formimit Vazhdues, përlllogaritja e ditëve të gjyqtarëve dhe prokurorëve të angazhuar si ekspertë, lehtësues dhe moderatorë do të bëhet si më poshtë:

- 1 ditë pjesëmarrjeje si ekspert është e barabartë me 2.5 ditë pjesëmarrje në trajnim;
- 1 ditë pjesëmarrjeje si lehtësues është e barabartë me 2 ditë pjesëmarrje në trajnim;
- 1 ditë pjesëmarrjeje si moderator është e barabartë me 1.5 ditë pjesëmarrje në trajnim.

Ky kontribut vlen vetëm për përlllogaritjen e ditëve si pjesëmarrës në Formimin Vazhdues dhe nuk sjell efekte financiare.”.

4.C.b Disponueshmëria e gjyqtares për të udhëhequr kandidatët për gjyqtarë gjatë stazhit profesional dhe/ose për trajnimin e gjyqtarëve.

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik, nuk rezulton se gjyqtarja të jetë angazhuar në programin e formimit vazhdues së Shkollës së Magjistraturës në cilësinë e lehtësueses apo ekspertes.

Bazuar në sa parashtrohet më sipër, duke iu referuar Metodologjisë së Pikëzimit që përcakton se për pikëzimin e këtij kriteri, duke marrë parasysh që pjesëmarrja në veprimtari të tilla, jo gjithmonë është në varësi të vullnetit të gjyqtarit, të gjithë gjyqtarët do ta fillojnë vlerësimin për këtë tregues me 3 pikë dhe 2 pikë do t'u shtohen në rast vërtetimi të angazhimit në këto veprimtari, vlerësohet se për gjyqtaren {...} duke qenë se nuk rezultojnë të dhëna për angazhimin e saj në cilësinë e lehtësueses apo ekspertes në aktivitete trajnuese në Shkollën e Magjistraturës, ky tregues duhet të pikëzohet me 3 pikë.

KONKLUZIONI

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton që gjyqtarja nuk është angazhuar në aktivitete trajnuese si lehtësuese apo eksperte pranë Shkollës së Magjistraturës.

Disponueshmëria e gjyqtares dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, në lidhje me treguesin “Disponueshmëria e gjyqtares për të udhëhequr kandidatët për gjyqtarë gjatë stazhit profesional dhe/ose për trajnimin e gjyqtarëve” nuk rezulton angazhimi i gjyqtares dhe për pasojë, pikëzohet me 3 pikë.

4.C.c Pjesëmarrja e gjyqtares në veprimtari ndërinstitucionale për përmirësimin e sistemit të drejtësisë dhe në veprimtaritë për marrëdhëniet me publikun në gjykata.

Nga analiza e burimeve të vlerësimit, të pasqyruara në Raportin Analitik, rezulton se në formularin e vetëdeklarimit, gjyqtarja {...} ka deklaruar “Gjatë ushtrimit të detyrës jam angazhuar maksimalisht në veprimtari ndërinstitucionale për përmirësimin e sistemit të drejtësisë dhe në veprimtaritë për marrëdhëniet me publikun në gjykata. Konkretisht, jam angazhuar maksimalisht për implementimin e projekteve të ndryshme nga gjykata si nismën “Drejtësi pa vonesa”, projektin “Për më shumë akses në drejtësi nga gratë dhe burrat shqiptar”, projektin Forcimi i cilësisë dhe efikasitetit të drejtësisë në Shqipëri CEJII etj., në takimet me përdoruesit e gjykatës (Dhoma e Avokatisë, Shërbimi Postar, IEVP etj.) për rritjen e efikasitetit, kam dhënë kontributin në hartimin e formave standarte me qëllim rritjen e efikasitetit, aksesit në drejtësi si broshurat informuese për palët, pjesëmarrësit në gjykim, letrat e të drejtave (të cilat janë paraqitur në takimin e kryetarëve të gjykatave), formularë standarte kërkesash për tju drejtuar gjykatës, etj., jam treguar shumë bashkëpunuese me organizatat e ndryshme që ndihmojnë në përmirësimin e sistemit gjyqësor si USAID, Euralius, UNDP, OSCE, Zyra e përfaqësimit të KE në Shqipëri etj., në kuadër të projekteve të mësipërme.”

Në lidhje me këtë tregues gjyqtarja në datë 24.10.2022 nëpërmjet postës elektronike ka dërguar Urdhrin nr.380 prot., datë 16.10.2017 “Për marrjen e masave për zbatimin e Memorandumit të Bashkëpunimit “Për më shumë akses në drejtësi nga gratë dhe burrat shqiptar”, Urdhrin nr.339 prot., datë 02.05.2018 të Kryetarit të Gjykatës, Urdhrin nr.1041 prot., datë 01.11.2017 të Kryetarit të Gjykatës si dhe Urdhrin nr.422 prot., datë 12.04.2017 “Për miratimin e objektivave të brendshëm të gjykatës për menaxhimin më të mirë të kohës në gjykimin e çështjeve gjyqësore”.¹⁶³

Referuar raportit analitik, nuk evidentohen të dhëna në lidhje me këtë kriter, përveç deklarimeve të gjyqtarës dhe kryetares së gjykatës që konfirmon deklarin e gjyqtarës, pasi urdhërat e paraqitura në cilësinë e provës nuk vërtetojnë angazhimin e gjyqtarës në këto veprimtari.

Lidhur me këtë tregues, gjyqtarja ka paraqitur kundërshtime dhe ka kërkuar vlerësimin e saj me 5 pikë, duke pretenduar se nga ana e relatores nuk janë marrë të mirëqena deklarinimet e saj të dhe kryetares së gjykatës në formularin e vlerësimit, deklarinime të cilat duhet të ishin marrë të mirëqena, duke qenë se jo më kot kryetares i është dhënë një rol i rëndësishëm në formularin e vlerësimit dhe se pretendimi i kundërt është i pa bazë. Gjithashtu, gjyqtarja ka pretenduar se duke qenë se nga ana relatores nuk është bërë asnjë përpjekje për të marrë prova pranë institucioneve të tjera, ajo ka paraqitur prova për të provuar veprimtarinë e saj ndërinstitucionale. Konkretisht, gjyqtarja ka paraqitur si provë vërtetimin e lëshuar nga prezenca e OSBE në Shqipëri, me anë të cilës vërtetohet se gjyqtarja ka marrë pjesë në projektin “Për një drejtësi pa vonesa”, si dhe njoftimin e datës 04.10.2018 për nënshkrimin e memorandumit të Bashkëpunimit midis Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhe dhe Gjykatës Themelore të Gjiilanit.

Në lidhje me pretendimin e gjyqtarës për marrjen e provave kryesisht nga Këshilli pranë çdo institucioni të referuar nga ana e saj, çmon të theksojë se Ligji “Për statusin” në nenin 92 të tij ka përcaktuar detyrën e relatorit të kërkoj dhe të mbledhë informacion vetëm nga Shkolla e Magjistraturës lidhur me pjesëmarrjen e gjyqtarit në programin e formimit vazhdues, nga Inspektorit të Lartë të Drejtësisë lidhur me përfundimin e ankesave të paraqitura ndaj magjistratit si dhe nga Inspektorati i Lartë për Deklarimin dhe Kontrollin e Pasurisë dhe Konfliktit të Interesit lidhur me saktësinë dhe korrektësinë e deklarinimit të pasurisë dhe jo nga çdo institucion tjetër.

Ndërsa në lidhje me rolin që ka vlerësimi i kryer nga kryetari i gjykatës, neni 87 dhe 93 pika 3 i Ligjit “Për Statusin” përcakton se kryetari i gjykatës jep mendimin e tij bazuar në standardet e miratuara nga Këshilli, i cili ashtu si vetëvlerësimi i kryer nga gjyqtarit verifikohet në raport me informacionin e marrë nga burime të tjera të vlerësimit.

Në lidhje me aktete paraqitura nga gjyqtarja me e-mailin e datës 04.01.2023, për të treguar angazhimin e saj në veprimtari ndër-institucionale, nga Këshilli u vlerësua se këto akte provojnë pjesëmarrjen e saj në një takim të zhvilluar ndërmjet dy gjykatave me qëllim realizimin e bashkëpunimit ndërmjet tyre si dhe angazhimin e saj për zbatimin e projektit “Për një drejtësi pa vonesa”, të cilat nuk përbëjnë angazhim në veprimtari ndërinstitucionale siç përcaktohet në Rregulloren¹⁶⁴ e miratuar nga Këshilli mbi Metodologjinë e Pikëzimit.

¹⁶³ Raporti analitik, faqe 76

¹⁶⁴ Miratuar me vendimin nr.264, datë 21.11.2019 të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Konkretisht në Metodolinë e Pikëzimit parashikohet se;”Gjyqtari mund të dedikojë kohë dhe përpjekje për të përmirësuar sistemin gjyqësor në mënyra të ndryshme. Këto përfshijnë veprimtari jashtë funksionit, me ose pa pagesë, të tilla si: fjalime publike; prezantime në konferenca shkencore kombëtare dhe ndërkombëtare; pjesëmarrja në programet e edukimit të komunitetit; bashkëpunimi me Këshillin për përmirësimin e programeve të formimit vazhdues; angazhimi si ekspert në punët e Këshillit për përgatitjen e formave standarde me qëllim rritjen e efikasitetit; kontribute në hartimin e legjislacionit; aktivitete mësimdhënëse për çështje ligjore; bashkëpunimi me grupe interesash të ndryshëm me qëllim rritjen e cilësisë së gjyqësorit dhe ndërgjegjësimin e publikut për forcën e zbatimit të ligjit, si edhe çdo veprimtari tjetër e ngjashme në fushën juridike”.

Bazuar sa më sipër, duke iu referuar Metodologjisë së Pikëzimit që përcakton se për pikëzimin e këtij treguesi, duke marrë parasysh që pjesëmarrja në veprimtari të tilla jo gjithmonë është në varësi të vullnetit të gjyqtarit, të gjithë gjyqtarët do ta fillojnë vlerësimin për këtë tregues me 3 pikë dhe 2 pikë do t’u shtohen në rast vërtetimit të angazhimit në këto veprimtari, vlerësohet se për gjyqtaren {...}, ky tregues duhet të pikëzohet me 3 pikë duke qenë se nuk rezultojnë të dhëna për angazhimin e saj.

KONKLuzioni

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, nuk rezulton që Gjyqtarja të jetë angazhuar në veprimtari ndër - institucionale për përmirësimin e sistemit të drejtësi apo aktivitete të tjera.

Pjesëmarrja, kontributi i gjyqtarit dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, për treguesin “Angazhimi i gjyqtares në veprimtari ndër-institucionale për përmirësimin e drejtësisë dhe në veprimtari për marrëdhëniet me publikun në gjykata”, gjyqtarja pikëzohet me 3 pikë, pasi nuk rezulton që ajo të jetë angazhuar në veprimtari ndër-institucionale.

4.C.ç Publikimet ligjore akademike.

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik, në lidhje me angazhimin e gjyqtares në veprimtari që përfshijnë publikime ligjore akademike, nuk rezultojnë të dhëna.

KONKLuzioni

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton që gjyqtarja nuk ka realizuar publikime ligjore akademike në periudhën vlerësimit dhe për pasojë, duhet të pikëzohet me 0 pikë.

Publikimet ligjore akademike dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, për treguesin “Publikime ligjore akademike” nuk rezultojnë publikime të gjyqtares, duke e pikëzuar me 0 pikë.

Niveli i vlerësimit KRITERI AFTËSITË PERSONALE DHE ANGAZHIMI PROFESIONAL	
Pikët	Niveli i vlerësimit
91	Shkëlqyeshëm

F- NIVELI I VLERËSIMIT PËR ÇDO KRITER VLERËSIMI DHE NIVELIN E PËRGJITHSHËM TË VLERËSIMIT

Niveli e vlerësimit për çdo kriter		
Kriteri	Pikët	Niveli i vlerësimit
1. Aftësitë profesionale të gjyqtares	88	Shumë mirë
2. Aftësitë organizative të gjyqtares	100	Shkëlqyeshëm
3. Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale	93	Shkëlqyeshëm
4. Aftësitë personale dhe angazhimi profesional	91	Shkëlqyeshëm
Propozim për nivelin e përgjithshëm të vlerësimit		
Vlerësimi i përgjithshëm	372	Shumë mirë

REKOMANDIME

Bazuar në nenin 93, pika 5, shkronja “ç”, të ligjit nr.96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, duke iu referuar të dhënave të analizuar dhe vlerësuara në raport me kriteret e vlerësimit, rekomandohet që gjyqtarja {...} t’i kushtojë më shumë rëndësi pjesës arsyetuese të vendimit dhe jo asaj përshkruese, strukturimit të mendimit juridik në mënyrë që të jetë lehtësisht i kuptueshëm, të mbajë në konsideratë angazhimin e saj në aktivitete për trajnimin e gjyqtarëve, pjesëmarrjen në veprimtari ndër-institucionale, si dhe në fushën e publikimeve ligjore dhe akademike, me qëllim ndarjen e përvojës profesionale dhe dhënien e kontributit në këto fusha.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR

SHTOJCA 1
KRITERET E VLERËSIMIT, SHKALLA E AFTËSISË, PIKËZIMI DHE
NIVELI I VLERËSIMIT PËR GJYQTAREN {...}
PERIUDHA E VLERËSIMIT 1 JANAR 2017 - 31 DHJETOR 2019

1. AFTËSITË PROFESIONALE TË GJYQTARES				Pikët total	Niveli i vlerësimit	
				88	Shumë mirë	
Treguesit	Burimet	Shkalla e aftësisë	Pikët	Të dhëna për metodologjinë		
A. Njohuritë ligjore	a. Aftësia për të identifikuar natyrën e çështjes, ligjin e zbatueshëm dhe/ose konfliktin e normave	1.Dokumentet ligjore të dorëzuara nga gjyqtarja 2. Vetëvlerësimi i gjyqtares 3. Aktet e dosjeve të përzgjedhura për vlerësim	Shumë e lartë	25	Shkalla e aftësisë së gjyqtares: E dobët – 5 pikë Nën mesataren – 10 pikë Mesatare – 15 pikë Mbi mesataren – 20 pikë Shumë e lartë – 25 pikë	
	b. Aftësia për të interpretuar ligjin në zgjidhjen e çështjes	1.Dokumentet ligjore të dorëzuara nga gjyqtarja 2. Vetëvlerësimi i gjyqtares 3. Aktet e dosjeve të përzgjedhura për vlerësim	Mbi mesatare	20	Shkalla e aftësisë së gjyqtares: E dobët – 5 pikë Nën mesataren – 10 pikë Mesatare – 15 pikë Mbi mesataren – 20 pikë Shumë e lartë – 25 pikë	
B. Arsyetimi ligjor	a. Qartësia, konciziteti dhe kuptueshmëria e vendimit	1.Dokumentet ligjore të dorëzuara nga gjyqtarja 2. Vetëvlerësimi i gjyqtares 3. Aktet e dosjeve të përzgjedhura për vlerësim	Shumë e lartë	15	Shkalla e aftësisë së gjyqtares: E dobët – 3 pikë Nën mesataren – 6 pikë Mesatare – 9 pikë Mbi mesataren – 12 pikë Shumë e lartë – 15 pikë	

	b. Struktura e qëndrueshme dhe e mirë organizuar e vendimit	1. Dokumentet ligjore të dorëzuara nga gjyqtarja 2. Vetëvlerësimi i gjyqtares 3. Aktet e dosjeve të përzgjedhura për vlerësim	Mbi mesatare	8	Shkalla e aftësisë së gjyqtares: E dobët – 2 pikë Nën mesataren – 4 pikë Mesatare – 6 pikë Mbi mesataren – 8 pikë Shumë e lartë – 10 pikë
	c. Cilësia e analizës dhe argumentimit logjik	1. Dokumentet ligjore të dorëzuara nga gjyqtarja 2. Vetëvlerësimi i gjyqtares 3. Aktet e dosjeve të përzgjedhura për vlerësim	Mbi mesatare	20	Shkalla e aftësisë së gjyqtares: E dobët – 5 pikë Nën mesataren – 10 pikë Mesatare – 15 pikë Mbi mesataren – 20 pikë Shumë e lartë – 25 pikë
2. AFTËSITË ORGANIZATIVE TË GJYQTARES				Pikët total	Niveli i vlerësimit
				100	Shkëlqyeshëm
Tregues		Burimet	Shkalla e aftësisë/niveli i treguesit	Pikët	Metodologjia
A. Aftësia për të përballuar ngarkesën në punë	a. Respektimi i afateve ligjore	1. Të dhënat statistikore 2. Vetëvlerësimi i gjyqtares 3. Mendimi përfundimtar i kryetarit	0-10%	15	Jashtë afatit: Mbi 40 %- 3 pikë 31-40 % - 6 pikë 21-30 % - 9 pikë 11-20 % - 12 pikë 0-10 % - 15 pikë
	b. Plotësimi i standardeve minimale kohore	1. Të dhënat statistikore 2. Vetëvlerësimi i gjyqtares 3. Mendimi përfundimtar i	0-10%	5	Jashtë afatit: Mbi 40 %- 1 pikë 31-40 % - 2 pikë 21-30 % - 3 pikë

		kryetarit			11-20 % - 4 pikë 0-10 % - 5 pikë
	c. Koha mesatare që i dedikohet çdo çështje	1. Të dhënat statistikore 2. Vetëvlerësimi i gjyqtarës 3. Mendimi përfundimtar i kryetarit	Më e shkurtër ose e barabartë me standardin për të gjitha kategoritë e çështjeve	5	Koha mesatare: Më e gjatë se standardi për të gjitha kategoritë e çështjeve – 1 pikë Më e gjatë se standardi për shumicën e kategorive të çështjeve – 2 pikë Më e gjatë se standardi për gjysmën e kategorive të çështjeve – 3 pikë Më e shkurtër se standardi për shumicën e kategorive të çështjeve – 4 pikë Më e shkurtër ose e barabartë me standardin për të gjitha kategoritë e çështjeve – 5 pikë
	ç. Rendimenti i përfundimit të çështjeve gjyqësore	1. Të dhënat statistikore 2. Vetëvlerësimi i gjyqtarës 3. Mendimi përfundimtar i kryetarit	+99%	10	Tej standardit : Nën 81% - 2 pikë Mbi 81-87% - 4 pikë Mbi 87- 93% - 6 pikë Mbi 93-99% - 8 pikë +99% - 10 pikë
	d. Koha mesatare e arsyetimit të	1. Të dhënat statistikore	Më e shkurtër	15	Koha mesatare:

	vendimit përfundimtar gjyqësor	2. Vetëvlerësimi i gjyqtarës 3. Mendimi përfundimtar i kryetarit	se afati procedural për shumicën e kategorive të çështjeve		Më e gjatë se afati procedural për të gjitha kategoritë e çështjeve – 3 pikë Më e gjatë se afati procedural për shumicën e kategorive të çështjeve- 6 pikë Më e gjatë se afati procedural për gjysmën e kategorive të çështjeve- 9 pikë Më e shkurtër se afati procedural për shumicën e kategorive të çështjeve- 12 pikë Më e shkurtër ose e barabartë me afatin procedural për të gjitha kategoritë e çështjeve – 15 pikë
B. Aftësia e gjyqtarës për të kryer procedural gjyqësore	a. Numri mesatar i seancave gjyqësore për çdo çështje dhe kryerja e veprimeve të nevojshme procedurale për shmangien e atyre jo-produktive	1. Të dhënat statistikore/aktet e dosjeve të përzgjedhura me short 2. Vetëvlerësimi i gjyqtarës 3. Mendimi përfundimtar i kryetarit	1-3 seanca dhe/ose shkallë shumë e lartë e aftësisë	15	Numri mesatar i seancave dhe shkalla e aftësisë së gjyqtarës: Mbi 3 seanca dhe shkallë e dobët e aftësisë – 3 pikë Mbi 3 seanca dhe shkallë mesatare e aftësisë – 9 pikë 1-3 seanca dhe/ose shkallë shumë e lartë e aftësisë – 15 pikë
	b. Kryerja e veprimeve të nevojshme procedurale për organizimin e procesit gjyqësor	1. Aktet e dosjeve të përzgjedhura me short 2. Vetëvlerësimi i	Shumë e lartë	20	Shkalla e aftësisë së gjyqtarës: E dobët- 4 pikë Nën mesataren – 8 pikë

		gjqtares 3. Mendimi përfundimtar i kryetarit			Mesatare – 12 pikë Mbi mesataren – 16 pikë Shumë e lartë - 20 pikë
C. Aftësia e gjyqtares për të administruar dosjen gjyqësore	a. Rregullshmëria e dokumentacionit të dosjes	1. Aktet e dosjeve të përzgjedhura me short 2. Vetëvlerësimi i gjyqtares	Shumë e lartë	5	Shkalla e aftësisë së gjyqtares: E dobët- 1 pikë Nën mesataren – 2 pikë Mesatare – 3 pikë Mbi mesataren – 4 pikë Shumë e lartë - 5 pikë
	b. Saktësia dhe plotësia e dokumentacionit të dosjes	1. Aktet e dosjeve të përzgjedhura me short 2. Vetëvlerësimi i gjyqtares	Shumë e lartë	10	Shkalla e aftësisë së gjyqtares: E dobët- 2 pikë Nën mesataren – 4 pikë Mesatare – 6 pikë Mbi mesataren – 8 pikë Shumë e lartë - 10 pikë
3. ETIKA DHE ANGAZHIMI NDAJ VLERAVE PROFESIONALE				Pikët total	Niveli i vlerësimit
				93	Shkëlqyeshëm
Tregues		Burimi	Shkalla e aftësisë/niveli i treguesit	Pikët	Metodologjia
A. Etika në punë	a. Angazhimi dhe përgjegjshmëria në funksion	1. Informacioni i marrë nga ILD 2. Dosja personale e gjyqtares 3. Vetëvlerësimi i gjyqtares 4. Mendimi përfundimtar i kryetarit	Mbi mesataren	28	Shkalla e etikës në punë e gjyqtares: E dobët- 7 pikë Nën mesataren – 14 pikë Mesatare – 21 pikë Mbi mesataren – 28 pikë Shumë e lartë – 35 pikë

B. Integriteti i gjyqtares	a. Shmangia e shfaqjes së pahijshme, nderi dhe dinjiteti	1. Informacioni i marrë nga ILD 2. Dosja personale e gjyqtares 3. Mendimi përfundimtar i kryetarit 4. Të dhënat e raportit të ILDKPKI	Shumë e lartë	40	Shkalla e integritetit të gjyqtares : E dobët – 0 pikë Shumë e lartë – 40 pikë
C. Paanësia e gjyqtares	a. Përdorimi ose jo i gjuhës diskriminuese	1. Vendimet e përzgjedhura nga gjyqtarja për vlerësim 2. Aktet e dosjeve të përzgjedhura me short për vlerësim	Shumë e lartë	10	Aftësia për të shmangur përdorimin e gjuhës diskriminuese: E dobët- 2 pikë Nën mesataren – 4 pikë Mesatare – 6 pikë Mbi mesataren – 8 pikë Shumë e lartë- 10 pikë
	b. Numri tejet i lartë i kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e gjyqtares	1. Të dhënat statistikore 2. Vetëvlerësimi i gjyqtares 3. Mendimi përfundimtar i kryetarit	I pa konsiderueshëm	15	Numri i kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e gjyqtares: Tejet i lartë – 3 pikë I pa konsiderueshëm – 15 pikë
4. AFTËSITË PERSONALE DHE ANGAZHIMI PROFESIONAL				Pikët total	Niveli i vlerësimit
				91	Shkëlqyeshëm
Tregues	Burimi	Shkalla e aftësisë/niveli i treguesit	Pikët	Metodologjia	

A. Aftësia e komunikimit	a. Komunikimi i qartë dhe transparent	<ol style="list-style-type: none"> 1. Vetëvlerësimi i gjyqtares 2. Mendimi përfundimtar i kryetarit 3. Vendimet e përzgjedhura nga gjyqtarja për vlerësim 4. Aktet e dosjeve të përzgjedhura me short 	Shumë e lartë	25	Qartësia dhe transparenca e komunikimit: E dobët – 5 pikë Nën mesataren – 10 pikë Mesatare – 15 pikë Mbi mesataren – 20 pikë Shumë e lartë – 25 pikë
	b. Respektimi i konfidencialitetit dhe mbrojtjes së të dhënave personale	<ol style="list-style-type: none"> 1. Vetëvlerësimi i gjyqtares 2. Mendimi përfundimtar i kryetarit 3. Vendimet e përzgjedhura nga gjyqtarja për vlerësim 4. Aktet e dosjeve të përzgjedhura me short 	I lartë	15	Respektimi i konfidencialitetit: I dobët- 3 pikë Mesatar – 9 pikë I lartë – 15 pikë
B. Aftësia për të bashkëpunuar	a. Shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit me kolegët, duke përfshirë shkëmbimin e njohurive dhe përvojës profesionale me ta	<ol style="list-style-type: none"> 1. Vetëvlerësimi i gjyqtares 2. Mendimi përfundimtar i kryetarit 3. Të dhënat për verifikimin e ankesave 	Shumë e lartë	15	Shkalla e komunikimit: E dobët – 3 pikë Nën mesataren – 6 pikë Mesatare – 9 pikë Mbi mesataren – 12 pikë Shumë e lartë – 15 pikë

	b. Shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit me administratën gjyqësore	1. Vetëvlerësimi i gjyqtarës 2. Mendimi përfundimtar i kryetarit 3. Të dhënat për verifikimin e ankesave	Shumë e lartë	10	Shkalla e komunikimit: E dobët – 2 pikë Nën mesataren – 4 pikë Mesatare – 6 pikë Mbi mesataren – 8 pikë Shumë e lartë – 10 pikë
C. Gatishmëria e gjyqtarës për t'u angazhuar në veprimtari të tjera	a. Pjesëmarrja e gjyqtarës në programin e formimit vazhdues në Shkollën e Magjistraturës dhe në trajnime të tjera profesionale	1. Informacioni i marrë nga Shkolla e Magjistraturës 2. Dosja personale e gjyqtarës 3. Dokumente të dorëzuara nga gjyqtarja	5-40 ditë (Periudha 1/vjeçare)	20	Pjesëmarrja e gjyqtarës: (periudha 3/vjeçare) 15-120 ditë – 20 pikë <15 ose > 120 ditë: 4
	b. Disponueshmëria e gjyqtarës për të udhëhequr kandidatët për gjyqtarë gjatë stazhit profesional dhe/ose për trajnimin e gjyqtarëve	1. Dosja personale e gjyqtarës 2. Informacioni i marrë nga Shkolla e Magjistraturës ose institucione të tjera	Nuk ka të dhëna	3	Nuk ka të dhëna – 3 pikë Ka të dhëna – 5 pikë
	c. Pjesëmarrja e gjyqtarës në veprimtari ndër-institucionale për përmirësimin e sistemit të drejtësisë dhe në veprimtari për marrëdhëniet me publikun në gjykata	1. Vetëvlerësimi i gjyqtarës 2. Mendimi përfundimtar i kryetarit 3. Dosja personale e gjyqtarës 4. Çdo e dhënë tjetër që tregon ngritjen profesionale të gjyqtarës	Nuk ka të dhëna	3	Nuk ka të dhëna – 3 pikë Ka të dhëna – 5 pikë

	ç. Publikimet ligjore akademike	1. Dosja personale e gjyqtares 2. Çdo e dhënë tjetër që tregon ngritjen profesionale të saj	Nuk ka të dhëna	0	Nuk ka të dhëna – 0 pikë Ka të dhëna – 1 deri në 5 pikë
PIKËZIMI PËR KATËR KRITERET E VLERËSIMIT		372			
NIVELI PËRFUNDIMTAR I VLERËSIMIT TË GJYQTARES		Shumë mirë			

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR